

Janar 2017
Numri: 106
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

RRUGËT E PANEVOJSHME TË KONFLIKTUALITETIT



*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Janar 2017

VITI: XI

NUMRI: 106

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Allahu i Madhëruar, në Kur'anin Fisnik i drejtohet besimtarëve duke i urdhëruar: **"O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!"** (Al-i Imran, 102.)

Kjo, është një thirrje për të gjetur cilësinë e devotshmërisë brenda besimit. Në një farë pike, myslimani përballlet me përgjegjësinë e kontrollimit të vazhdueshëm të zemrës dhe jetës së tij.

Mund të thuhet se:

Çfarëdo të jetë pakësuar në jetën e myslimanit, aty ka ndodhur një "humbje".

Kur pyesim "çfarë humbëm?", jemi të detyruar të bëjmë një llogari të thellë edhe në planin personal, edhe në atë të umetit. Si janë zemrat tona dhe si është jeta jonë e përbërë prej veprave tona?

Kur shihet aspekti i perceptimit të kuptimit të ekzistencës në shoqërinë e in-jorancës para Islame, vërehet se ajo ishte një shoqëri plotësisht e humbur.

Ndërsa kur shohim sahabët, vërejmë se ata ishin njerëz që kishin dalë nga një jetë shoqërore e prishur, e ndryshkur, e qelbur dhe çnjerëzore dhe kishin fituar një personalitet të lartë duke u takuar me Islamin. Në sajë të Kur'anit dhe përpjekjeve ndërtuese të Rasulallahut (a.s.), ata i kompensuan humbjet e tyre në aspektin njerëzor, fituan, fituan, fituan.

Për ta, të fitoje do të thoshte të ndërtonin myslimanizmin e tyre gurë-gurë, qelizë-qelizë. Ata fitonin duke jetuar, e ndonjëherë fitonin duke vdekur (si dëshmorë). Ndërsa të humbje, do të thoshte të firoje në aspektin e Islamit.

Vallë, çfarë duhet të pakësohet në jetën e myslimanit, që të quhet i humbur dhe çfarë duhet të gjejë, që të quhet i fituar?

Ta bësh sot këtë pyetje, ka të bëjë me përpjekjen gjetjes së shkakut të mjerimit, shtypjes, humbjes dhe rënies sonë si myslimanë dhe të botës Islame. Po ashtu ka të bëjë edhe me kërkimin e mundësisë së ripërtëritjes.

Vallë, a mund të gjejmë diçka që është shkak i gjithçkaje dhe një eliksir magjik që do të na bëjë të fitojmë përsëri çdo gjë, duke na ngritur në nivelin e brezit të epokës së lumturisë në mënyrë të menjëhershme?

A e kemi vlarë mendjen si të bëhemi "umeti më i mirë", që Allahu kërkon të nxjerrë prej nesh? **"Që thërrasin në të drejtën, që urdhërojnë për mirë, e që ndalojnë nga e keqja..."**

A nuk e duam shpëtimin? **"Ata janë të shpëtuarit!"**, thotë Allahu i Madhëruar (shih. Al-i Imran, 104.)

Shpëtimi i njerëzimit është nën prijësin e atij umeti. Mirëpo, më parë, ai umet duhet ta gjejë vetë shpëtimin. Një patkua, shkatërron një kalë, një kalë një komandant, një komandat humbet një luftë, e lufta shkatërron një vend.

Në hutben e lamtumirës, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

"O besimtarë! Në të vërtetë, shejtani e ka humbur shpresën se do ta adhuroni atë në vendet tuaja. Mirëpo, ai do të kënaqet nëse ju e ndiqni atë qoftë edhe me vepra e punë që ju i konsideroni të parëndësishme. Ruajeni fenë tuaj prej tij!" (shih. Ibn Hisham. Sijre, IV, 251.)

Vallë, çfarë janë ato gjëra të parëndësishme në jetën tonë, të cilat i japin shpresë shejtanit? A nuk duhet ta shikojmë e ta kontrollojmë veten tonë?

Përmbajtja



14

Vëllazëria Islame
Prof. dr. Ismail Lutfi Çalkan



Personaliteti që siguron
shpëtimin e përjetshëm
Osman Nuri Topbash

34




18



42

Si t'i shohim sfidat si mundësi

- 5 Ku është humbja, si mund të fitojmë?
Ahmet Tashgetiren
- 8 Çfarë humbëm si umet?
Ali Riza Temel
- 12 Zgjidhja e problemeve,
vëllazëria islame
Doç. dr. Mustafa Karabaxhak
- 16 Lufta me armiqtë e fesë
Prof. dr. Sulejman Derin
- 18 Shpërbërja e personalitetit
Prof. dr. Irfan Gyndyz
- 21 Përsëndetja me selam,
fjalëkalimi i unitetit të umetit
Ahmet Basher
- 22 Përqindja e përgjegjësisë sonë
Nuredin Jëlldëz
- 24 Lajmi më i rëndësishëm
Xhafer Durmush



55

- Ibrahimi (a.s.) dhe Bejtullahu 28
M. Sami Ramazanollu
- Dhikri në ajete dhe hadithe 29
Sadik Dana
- Një Ajet - Një Hadith 30
- El-Kuddus 40
Ilir Hoxha
- "Ata" 43
Edison Çeraj
- Prej nga erdhi kjo kureshtje për hapësirën 45
Merve Shanllë
- Vdekjet nga mbipeshja janë më tepër se vdekjet nga uria 47
Mirko Univers
- Muhamed Ikbal (Pj. 2) 52
Personalitete botërore Islame
- Përfaqësimi i vazhdimësisë në art 55
Personalitete botërore Islame
- Misioni i myslimanit 56
Naim Drijaj

Planeti me ditën më të gjatë se vitin
Muaz Erdem



44

Soditja

50





Pse humbëm si mund të fitojmë?

Ahmet Tashgetiren

Vallë, çfarë duhet të pakësohet në jetën e myslimanit, që të quhet i humbur dhe çfarë duhet të gjejë, që të quhet i fituar? Ta bësh sot këtë pyetje, ka të bëjë me përpjekjen gjetjes së shkakut të mjerimit, shtypjes, humbjes dhe rënies sonë si myslimanë dhe të botës Islame. Po ashtu ka të bëjë edhe me kërkimin e mundësisë së ripërtëritjes.

Vallë, a mund të gjejmë diçka që është shkak i gjithëkaje dhe një eliksir magjik që do të na bëjë të fitojmë përsëri çdo gjë, duke na ngritur në nivelin e brezit të epokës së lumturisë në mënyrë të menjëhershme?

Termi “texhdid-i iman”, do të thotë të ripërtërish besimin. Në shumë xhami¹, sidomos në natën e së enjtes që lidhet me xhumanë, pas namazit të jacisë, imamët e xhamive së bashku me xhematet e tyre bëjnë teube dhe istigfar². Më pas bëjnë një dua, e cila njihet si “texhdid-i iman ue texhdid-i nikah”³ dhe bëhet kështu:

“Allahumme inni uridu en uxheddide’l’imane ue’nnikah’a texhdiden bi kauli la ilahe il-lallah, muhammedun rasulullah.”, kuptimi i së cilës është:

“O Allah! Unë dëshiroj të ripërtërij besimin dhe aktin e martesës, duke thënë; la ilahe il-lallah, muhammedun rasulullah”

Në fakt, kjo dëshirë, padyshim se nuk është ripërtëritje e një besimi apo nikahu të mbaruar, të humbur, të konsumuar apo që na ka braktisur. Kjo është vetëm shprehja e një dëshire dhe me këtë, myslimani e bart “besimin” dhe

1. Në xhamitë e Turqisë.

2. Shprehin pendim tek Allahu dhe kërkojnë falje prej Tij.

3. Rinovim i besimit dhe i kurorës martesore.

“nikahun” në planin e vetëdijes dhe pohimit, duke u munduar ta ruajë ekzistencën e këtyre dy “institucione”, me ekzistencën e “kelime-i teuhidit” në një mënyrë më të gjallë dhe më të theksuar.

Kjo që bëhet, nuk është sjellja e diçkaje që është zhdukur, por ripërtëritja e saj.

Sigurisht që, edhe ripërtëritja ka lidhje me shfaqjen e kësaj nevoje. Pra, do të thotë se ka ndodhur një vjetërsim, ndryshkje, mplakje, dobësim dhe erozion në karakter. Myslimani, çdo javë, kur shkon në takimin e xhumasë, e realizon në zemrën e tij një ripërtëritje të tillë.

Nga një anë, ky është njëfarë kompensimi i humbjeve. Pohimi i besimit, duhet të jetë i gjallë në mënyrë të vazhdueshme dhe ato që përmendëm më sipër, pra, mplakja, erozioni, ndryshkja dhe lodhja, shprehin pakësimin e gjallërisë në njëfarë mënyre, pra gjendjen e humbjes në fushën e besimit.

Në fakt, edhe ajo që e njohim si “teube dhe istigfar”, është diçka që myslimani i ndjeshëm e përdor për të kompensuar humbjet në veprat e tij. Madje, atje (në xhami) njerëzit me në krye imamët, fillojnë me fjalinë; “Çdo lloj gabimi, kundërshtimi, shirku e çdo gjë e gabuar që ka ndodhur, të cilat i di dhe nuk i di” dhe e mbyllin me fjalinë: “Jam penduar për të gjitha dhe synoj të mos i bëj më kurrë”.

Nga kjo pikëpamje, edhe “texhdid-i iman”, edhe “teube e istigfari”, janë një reflektim i ndjeshmërisë së myslimanit në lidhje me karakterin dhe ditarin e jetës e tij.

Një ndjeshmëri të tillë, e shohim edhe tek sahabët fisnikë, të cilët ishin brezi i parë i Islamit që ndërtoi Rasulallahu (a.s.). Për shembull, transmetohet se sahabët si Abdullah bin Reuaha dhe Abdullah Ibni Mes’udi (r.anhuma), i ftonin shpesh herë shokët e vet përreth, duke u thënë: “Ejani të besojmë një orë!”

Çfarë duhet të kuptojmë prej kësaj?

- Ejani të shohim, a e kemi në rregull besimin tonë? A e ruan ende formën e tij? A është entuziast? A është i lodhur? A ka humbje? A ka mplakje?

Në fakt, ky është edhe kuptim i porosisë: “Hasi-bu kable en tuhasebu / Llogariteni veten para se të llogariteni!”

Pra, të shihni veten tuaj dhe të mjekoni plagët.

Ndërsa në Kur’an, urdhërohet: “**Ja ejjuhledhine amenu, aminu/ O ju që keni besuar! Besoni...**” (Nisa, 136.)

Komentuesit e Kur’anit, këtë ajet e kanë kuptuar si: “O ju që besuat, bëhuni të qëndrueshëm në besim!”. Domethënë se, besimi ka edhe problemin e qëndrësës. Prandaj edhe Profeti ynë (a.s.), i është lutur Allahut, duke thënë: “Ja mukal-libe’l-kulub, thebbit kalbi ala

dinike / O Zoti im që i rrotullon zemrat! Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde!”

Gjithashtu, Allahu i Madhëruar, në Kur’anin Fisnik i drejtohet besimtarëve duke i urdhëruar: “**O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë mys-limanë!”** (Al-i Imran, 102.)

Kjo, është një thirrje për të gjetur cilësinë e devotshmërisë brenda besimit. Në një farë pike, myslimani përballet me përgjegjësinë e kontrollimit të vazhdueshëm të zemrës dhe jetës së tij.

Mund të thuhet se:

Çfarëdo të jetë pakësuar në jetën e myslimanit, aty ka ndodhur një “humbje”.

Kur pyesim “çfarë humbëm?”, jemi të detyruar të bëjmë një llogari të thellë edhe në planin personal, edhe në atë të umetit. Si janë zemrat tona dhe si është jeta jonë e përbërë prej veprave tona?

Kur shihet aspekti i perceptimit të kuptimit të ekzistencës në shoqërinë e injorancës para Islame, vërehet se ajo ishte një shoqëri plotësisht e humbur.

Ndërsa kur shohim sahabët, vërejmë se ata ishin njerëz që kishin dalë nga një jetë shoqërore e prishur, e ndryshkur, e qelbur dhe çnjerëzore dhe kishin fituar një personalitet të lartë duke u takuar me Islamin. Në sajë të Kur’anit dhe përpjekjeve ndërtuese të Rasulallahut (a.s.), ata i kompensuan humbjet e tyre në aspektin njerëzor, fituan, fituan, fituan.


Për ta, të fitoje do të thoshte të ndërtonin mysli-manizmin e tyre gurë-gurë, qelizë-qelizë. Ata fitonin duke jetuar, e ndonjëherë fitonin duke vdekur (si dëshmorë). Ndërsa të humbje, do të thoshte të firoje në aspektin e Islamit.

Vallë, çfarë duhet të pakësohet në jetën e mysli-manit, që të quhet i humbur dhe çfarë duhet të gjejë, që të quhet i fituar?

Ta bësh sot këtë pyetje, ka të bëjë me përpjekjen gjetjes së shkakut të mjerimit, shtypjes, humbjes dhe rënies sonë si myslimanë dhe të botës Islame. Po ashtu ka të bëjë edhe me kërkimin e mundësisë së ripërtëritjes.

Vallë, a mund të gjejmë diçka që është shkak i gjithçkaje dhe një eliksir magjik që do të na bëjë të fitojmë përsëri çdo gjë, duke na ngritur në nivelin e brezit të epokës së lumturisë në mënyrë të menjë-hershme?

Pyetja më e rëndësishme është:





Mbase duke ia shtuar edhe këtë pyetje, pyetjes më të rëndësishme, mund t'ia çelim derën ripërtëritjes sonë magjike:

- Sa kemi humbur prej fesë sonë?

Ejani të lexojmë edhe domethënien e këtij ajeti fisnik:

“O besimtarë! Binduni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!..” (Enfal, 24.)

Nëse e kuptojmë drejtë këtë ajet, atëherë duhet të shohim fushat e vdekura në ekzistencën tonë. Ka mundësi që aty të ketë shkëputje prej thirrjeve të Allahut dhe të Rasulallahut (a.s.).

Kushedi, mbase shpëtimi ynë është në xhihadin e vogël, e mbase edhe në xhihadin e madh. Kushedi, mbase shpëtimi ynë është në lutje.

Mbase ato që mund të shpëtojmë nga “uejl”⁴-i gjenden tek namazet, tekbirët, kijamet, e mbase edhe në sexhdet tona ku ndajmë afërsinë e Krijuesit të Madhëruar. Mbase gjendet tek përkëdhelja e kokës së një jetimi. Mbase në gëzimin që i jep zemrës së një nevojtarit. Mbase edhe tek mësimi i një fëmije që të thotë “Allah”.

Mbase është në namazin e natës, në përkujtimin e Allahut, në meditimin rreth vdekjes ose në takimin me robërit e mirë të Allahut që e jetojnë Islamin në mënyrën më të bukur.

Mbase është diçka shumë e vogël, mbase është kujdesi që tregon në heqjen e një guri që i bezdis kalimtarët në rrugë. Mbase është ta bësh buzëqeshjen karakterin thelbësor të fytyrës së myslimanit. Mbase është siç thotë edhe Muhjiddin ibn Arabiu, “*të sillesh me mirë me tokën, qiellin, ajrin dhe uji*”.

4. Uejl: Shprehje e Kur'anit, që do të thotë “mjerë” dhe që pasohet nga veprime të gabuara të dikujt. Për shembull, në suren Humeze, urdhërohet: “Uejlun likulli humezatin lumazah / Mjer për çdo tallës-shpifës”

Në një farë pike, myslimani përballet me përgjegjësinë e kontrollimit të vazhdueshëm të zemrës dhe jetës së tij.

Mund të thuhet se:

Çfarëdo të jetë pakësuar në jetën e myslimanit, aty ka ndodhur një “humbje”.

Kur pyesim “çfarë humbëm?”, jemi të detyruar të bëjmë një llogari të thellë edhe në planin personal, edhe në atë të umetit. Si janë zemrat tona dhe si është jeta jonë e përbërë prej veprave tona?

Mbase është tek pyetja “çfarë është Islami për mua?”

Mbase është në jetimin e Islamit me dashuri.

Mbase është në vënien në jetë në çdo fushë, të parimit se “Islami është jetë”.

Mbase është në hyrjen brenda kufijve të Islamit. Mbase është të mos jesh më prej njerëzve, në zemrat e të cilëve nuk ka hyrë ende Islami, duke fituar kënaqësinë e Allahut e të bëhesh prej myslimanëve, të cilëve Ai do t'u thotë: **“Bashkoku me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”** (Fexhr, 29-30.)

A e kemi vrarë mendjen si të bëhemi “umeti më i mirë”, që Allahu kërkon të nxjerrë prej nesh? **“Që thërrasin në të drejtën, që urdhërojnë për mirë, e që ndalojnë nga e keqja...”**


A nuk e duam shpëtimin? **“Ata janë të shpëtuarit!”**, thotë Allahu i Madhëruar (shih. Al-i Imran, 104.)

Shpëtimi i njerëzimit është nën prijësin e atij umeti. Mirëpo, më parë, ai umet duhet ta gjejë vetë shpëtimin. Një patkua, shkatërron një kalë, një kalë një komandant, një komandat humbet një luftë, e lufta shkatërron një vend.

Në hutben e lamtumirës, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“O besimtarë! Në të vërtetë, shejtani e ka humbur shpresën se do ta adhuroni atë në vendet tuaja. Mirëpo, ai do të kënaqet nëse ju e ndiqni atë qoftë edhe me vepra e punë që ju i konsideroni të parëndësishme. Ruajeni fenë tuaj prej tij!” (shih. Ibn Hisham. Sijre, IV, 251.)

Vallë, çfarë janë ato gjëra të parëndësishme në jetën tonë, të cilat i japin shpresë shejtanit? A nuk duhet ta shikojmë e ta kontrollojmë veten tonë?



Çfarë humbëm si umet?

— Ali Riza Temel —

Kemi humbur forcën, cilësinë dhe të qenit dëshmitarë e shembull.

Një njeriu të urtë i thanë: *“I nderuar, lutuni për umetin e Muhamedit (a.s.), që të shpëtojë.”* Ndërsa ai u përgjigj: *“Më tregoni umetin e Muhamedit (a.s.), që t’ju them se ata kanë shpëtuar.”* Sigurisht që kjo mund të duket pak e ekzagjeruar, por për fat të keq duket sikur ne e kemi humbur cilësinë që përshkruhet në Kuranin Fisnik: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin...”** (Ali Imran, 110)

Ky umet, në fillim ka qenë umeti më i mirë. Ata ndryshuan botën, por sot këto cilësi kanë humbur. Ndërkohë që më parë urdhëronim, tashmë marrim urdhra...

Ky umet ka detyrën që i ka ngarkuar Allahu: **“Të urdhërojnë për vepra të mira, e të ndalojnë nga të këqijat”**¹. Mirëpo ne si umet, gabimet të cilat duhet t’i korrigojmë, kemi filluar t’i bëjmë vetë. Gjërat për

të cilat themi “Mos i bëni!”, po i bëjmë vetë. Ndërsa gjërat për të cilat themi “Bëjini!”, nuk i bëjmë as vetë.

Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik, ka urdhëruar:

“Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzimit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...” (Bekare, 143)

Pra, këtu bëhet fjalë për udhëzimin e Profetit (a.s.). Dhe nën udhëzimin e tij edhe ne të jemi udhëzues për të gjithë njerëzimin.

Me pak fjalë, ne e kemi humbur cilësinë e udhëzimit...

Më pas kemi humbur cilësinë e të qenit dëshmitarë. Në një hadith fisnik tregohet se kur Profeti ynë (a.s.), ndodhej në Medine-i Muneuere, kishte kaluar një xhenaze, që sahabët e kujtuan me fjalë të mira. Ndërsa Rasulullahu (a.s.), tha: *“Uexhebet/u vendos”*. Më pas kaloi edhe një xhenaze tjetër, për të cilën sahabët folën keq. Por edhe kësaj here Profeti

1. shih. Al-i Imran, 110.

(a.s.), tha “Uexhebet/ u vendos”. Sahabët e pyetën: “O Rasullullah, ti për të dyja xhenazet the uexhebet/ u vendos. Çfarë u vendos?”

Profeti (a.s.), u përgjigj:

“Xhenazen e parë e kujtuat për mirë, prandaj u vendos që ai të ishte banor i Xhenetit. Ndërsa xhenazen e dytë e kujtuat për keq, prandaj u vendos që ai të ishte banor i Xhehenemit. Ju jeni dëshmitarët e Allahut në tokë. Ndërsa melekët, janë dëshmitarët e Allahut në qiell.”

Në fushën e jurisprudencës islame (Fikhut), për të qenë dëshmitar, duhet të zotërosh disa cilësi, sepse jo të gjithëve mund t’u pranohet dëshmia. Nisur nga kjo, mund të themi se cilësia e “dëshmisë” së këtij umeti, ka marrë plagë të rënda. Prandaj është e domosdoshme që kjo cilësi të rifitohet...

NE KEMI HUMBUR CILËSINË SI UMET

Profeti (a.s.), ndërtoi një umet të civilizuar dhe shembullor prej beduinëve të paditur të shkretëtirës. Ky umet shembullor u formua nën udhëheqjen e Profetit (a.s.), në shkollën e Kuranit Fisnik. Dhe në sajë të kësaj shkolle, ata fituan kualitet.

Në një hadith tjetër që shënohet nga Ebu Daudi, Profeti ynë (a.s.), ka thënë: “Do të vijë një kohë, kur umetet e tjera do të vërsulen mbi ju për t’ju grabitur, si njerëzit e uritur drejt sofrës.” Për këtë arsye, sahabët pyetën: “O Rasullullah! A do të jemi pak atëherë?” Ndërsa Profeti (a.s.), përgjigjet: “Jo nuk do të jeni pak. Përkundrazi do të jeni shumë. Mirëpo do të jeni (pa cilësi) ashtu si materialet që vë përpara vërshimi i ujërave. Allahu do t’ua heqë frikën armiqve prej jush dhe nuk do të keni asnjë vlerë tek ata.”

Njëherë e një kohë ishim shumë të fuqishëm. Po tani pse jemi dobësuar?

Nëse problemi do të ishte tek vlerat islame, edhe atëherë do të ishim të dobët. Nëse prej beduinëve u formua një shoqëri e civilizuar që i dha drejtim botës

dhe nëse kjo është bërë në sajë të Islamit dhe Kuranit, atëherë kjo mund të ndodhë gjithmonë.

Një çështje tjetër është se kur humbën vlerat që e bëjnë umetin umet, në plan të parë dolën medh’hebet, racat, xhematet apo grupet e ndryshme. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“**Ata, që fenë e vet e kanë përçarë dhe janë ndarë në grupe, e ku çdo grup është i kënaqur me atë që ka.**” (Rum, 32)

Umet, nënkupton një bllok besimi. Pra, a nuk është një bashkësi ajo që formojnë një grup njerëzish që besojnë në të njëjtin Zot, në të njëjtin Profet dhe drejtohen nga e njëjta kibël? Për fat të keq, ne e kemi humbur këtë koncept thelbësor. Dhe për rrjedhojë, në plan të parë kanë dalë, ose medh’hebi, ose raca. A nuk është umeti një çadër që përfshin të gjithë besimtarët? Mirëpo, në vend që ne të mbanim në plan të parë vetëdijen e umetit, ne nxorëm në plan të parë identitetin e grupit apo xhematit tonë. Për fat të keq, ne kemi dalë prej asaj çadre të madhe. Prandaj edhe jemi bërë copa-copa. Në namaz, drejtohem nga e njëjta kibël, por në fakt, jemi larguar jashtëzakonisht shumë prej qëllimi kryesor të të qeni një umet. Për rrjedhojë, sot po përjetojmë pasojat e dobësive tona.

Largimi ynë prej këtyre qëllimeve kryesore, ka ndodhur për shkak të dobësive tona. Dobësitë tona të brendshme, janë bashkuar me dobësitë e jashtme, gjë e cila ka nxjerrë në pah problemin e cilësisë. Me humbjen e cilësisë, u prish edhe bota jonë. Popullsia jonë u shtua, por rëndësia jonë u pakësua. Në të gjithë botën ka rreth një miliard e gjashtëqind milionë myslimanë, por ashtu siç cilësohemi edhe në hadithin e Profetit (a.s.), jemi si materialet që vë përpara vërshimi i ujit. Pozita jonë për t’i dhënë drejtim botës, për ta prirë dhe për ta urdhëruar atë, ka humbur. Komplekset përballë perëndimit, sollën shumë dobësi. Ndodhi ikja nga vetvetja dhe përçmimi i vlerave vetjake.

HUMBËM DIJETARËT DHE PRIJËSIT

Kemi humbur dijetarët dhe ekipin e prijësve, të cilët kanë qenë përgjegjës ta jetonin dhe rregullonin Islamit sipas të gjitha kohërave. Ne po paguajmë çmimin e ngushtësimit në kohë, vend dhe temë të Islamit, që është edhe feja e të gjitha kohërave, të gjithë njerëzve, të gjitha vendeve dhe të gjitha kushteve. Pra, edhe shpëtimi ynë, mund të bëhet i mundur vetëm nëse bëhet një hapje, qoftë edhe në një kohë afatgjatë.



KEMI HUMBUR NDJESHMËRINË E NAMAZIT DHE KURANIT

Në kemi humbur shumë si umet dhe gjendja e sotme e umetit, buron prej këtyre humbjeve. Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik jep përshkrimin e dy lloj brezave, duke dhënë një mesazh edhe për ditët e sotme. Në ajetin 58 të sures Merjem, përmenden emrat e shumë profetëve, duke folur për sexhdet, duatë dhe adhurimet e tyre:

“...Kur iu lexoheshin vargjet e të Gjithëmëshirshmit, binin duke bërë sexhde dhe qanin.”

Në këtë ajet të tërheq vëmendjen përshkrimi i sexhdeve të tyre me ndjeshmëri dhe të zbukuruara e kurorëzuara me lot. Mirëpo, menjëherë më pas, në ajetin 59 duket sikur jepet përshkrimi i umetit në ditët e sotme dhe gjendja në të cilën ndodhemi:

“Pas atyre erdhën brezni, që e humbën namazin dhe ndoqën epshet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh!..”

Ata e humbën namazin, humbën vetëdijen e namazit. Në disa përkthime të këtij ajeti, përdoret edhe shprehja “e braktisën”. Por ka edhe prej atyre dijetarëve që humbjen e namazit e kanë kuptuar si braktisje të tij. Pra, e zbrazen brendësinë e namazit, nuk i dhanë rëndësi dhe e humbën ndjeshmërinë e tij.

Por çfarë ndodhi kur e humbën ndjeshmërinë e namazit? Në ajetin fisnik, bëhet me të vërtetë një cilësim i mrekullueshëm. Ky cilësim, është shumë i rëndësishëm në aspektin e përshkrimit të gjendjes në të cilën ndodhet sot umeti i Muhamedit (a.s.). Çfarë

KEMI HUMBUR BOTËKUPTIMIN E UMETIT

Çështja themelore që duhet thënë pikësepari, është se myslimani duhet të ketë vetëdijen dhe perceptimin e umetit. Nëse sot ka diçka që quhet bota islame -në fakt ka-, kur e përmendim gëlltitemi disa herë... Mirëpo, këtu nuk bëhet aspak fjalë për një vetëdije të botëkuptimit të umetit. Cilësia e përgjithshme e Islamit, është fakti se ai është bashkues. Mirëpo, kur shohim botën islame, vërejmë se elementi i fesë, jo vetëm që nuk është bashkues, por përdoret si një element i nxitjes së përçarjes.

Ne jemi pjesëtarët e një feje që nuk e pranon të vërë në rrezik jetët e jomuslimanëve apo të mohuesve të fesë dhe të hakmerret pa arsye ndaj tyre. Jeta e profetit tonë (a.s.), është e mbushur me shembuj të mos cenimit të jetës së askujt pa pasur ndonjë gjendje lufte... Pra, bëhet fjalë për një Profet të dhembshur dhe mëshirues, një fe të dhembshurisë dhe mëshirës.

Mirëpo, e shihni botën islame... s’ka asnjë ditë xhumaje ku të mos shpërthejë bomba në ndonjë xhami. Dikush guxon t’i marrë jetën një numri të madh të myslimanëve përfshi edhe vetes së tij në një sulm vetëvrasës. Ai mund ta tërheqë lehtësisht siguresën e bombës duke i shkatërruar edhe xhamitë historike, të cilat konsiderohen qendra të rëndësishme islame dhe duke i marrë jetën xhematit, të cilët vijnë në këto xhami dhe nuk ia kanë idenë se çfarë do të ndodhë.

Tani, nëse e shohim nga ky këndvështrim, mund të themi se kjo fe e cila duhet të jetë bashkuese, për fat të keq, shndërrohet në një element përçarës nga vetë ne myslimanët.

Mirëpo, cili është problemi themelor? E para, është se të gjithë pretendojnë se botëkuptimit i tyre i

ndodh kur pas ndjeshmërisë së namazit humbet edhe ndjeshmërinë ndaj Kuranit, shpalljes që e lexojmë në namaz? Cili është përfundimi i kësaj? Në ajetin fisnik, urdhërohet se ata që e braktisin namazin, e humbasin vetëdijen e namazit dhe vrapojnë pas gjynaheve, dëshirave dhe kënaqësive të ndaluara të kësaj bote, do të dënohen ashpër. Pra, do të hidhen përjetësisht në zjarrin e Xhehenemit dhe po ashtu, edhe në këtë botë do të kenë stresse dhe vështirësi të mëdha.

Le të përpiqemi ta përmbledhim këtë çështje me anë të një hadithi që e trajton këtë temë:

Profeti (a.s.), thotë: *“Në lidhje me umetin tim frikësohem për dy gjëra, lënien e namazit dhe leximit të Kuranit kur të emigrojnë në vende të pasura.”*

Ky është një hadith, i cili mund të kuptohet si shpjegimi i ajetit fisnik. Nëse një besimtar e shkëput apo e humbet lidhjen me namazin, i cili është edhe lidhja e vazhdueshme dhe e pandërprerë me Allahun, u hap rrugën të gjitha fatkeqësive që do të vijnë pas kësaj. Pesë kohët e namazit, janë një adhurim që na lidh me Zotin tonë në mënyrë të pandërprerë. Kush e

humb këtë lidhje, ka humbur lidhjen me Zotin e tij, Kuranin dhe Islamin. Atij i humb ndjeshmëria dhe del i zbuluar përballë çdo rreziku. Për fat të keq, në fillim ne kemi humbur namazin dhe ndjeshmërinë ndaj tij. Kemi humbur ndjeshmërinë ndaj Kuranit dhe i kemi çrregulluar marrëdhëniet me Zotin tonë, duke i çrregulluar marrëdhëniet me parimet e fesë sonë. Ne kemi humbur parimet e Islamit në jetën tonë dhe na kanë rrethuar gjynahet dhe dëshirat e ulëta të egos. Në këtë gjendje jemi ne umeti i Muhamedit (a.s.). Allahu na e bëftë të mundur të shpëtojmë sa më shpejt nga kjo gjendje. Lidhur me zgjidhjen e këtij problemi, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Allahu u ka premtuar falje (të gjynaheve) dhe shpërblim të madh atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira.” (Maide, 9)

Pra, nëse ne pendo kemi tek Allahu, e forcojmë besimin tonë, e falim rregullisht namazin dhe vazhdojmë të bëjmë vepra të mira, Allahu i Madhëruar do të na ndihmojë, do të na e forcojë bashkimin dhe vëllazërinë tonë dhe do t'i falë përsëri umetit të Muhamedit (a.s.), fitore dhe suksese.

fesë dhe i Islamit, është më i drejti. Për rrjedhojë, ata mbrojnë idenë se të tjerët duhet të eliminohen. Këtë botëkuptim kanë ata. Ky është edhe problemi themelor.

Në fakt, të gjitha fetë kanë mënyrat e ndryshme të leximit dhe të botëkuptimit të tyre. Fenomeni i medh'hebeve, grupeve, xhemateve etj., nuk është diçka e veçantë vetëm për fenë tonë. Këtë e gjen në çdo fe. Nuk ka asnjë fe në botë, e cila përbëhet vetëm nga një medh'heb, një grup apo nga një xhemat. Këto ndryshime duhen parë si të natyrshme. Unë mendoj se mënyra e mendimit është edhe pika thelbësore që duhet ndryshuar. Për sa kohë që ne nuk e shohim si të natyrshëm këtë fenomen, do të vazhdojmë të luftojmë dhe të vrasim njëri-tjetrin.

Së dyti, ne jemi brenda një zjarri që buron nga

jashtë nesh, por që më në fund na është ngjitur edhe neve. Ekziston një zonë që njihet si Lindja e Mesme. Myslimanët që jetojnë në këtë zonë, përbëjnë 20% të myslimanëve në të gjithë botën. Mirëpo, të gjitha ngjarjet ndodhin aty ose në vendet përreth Lindjes së Mesme. Ne gjendemi në mes të lojës që luhet në Lindjen e Mesme nga fuqi ndërkombëtare. Në fakt, kjo nuk është një pikë të cilën po e evidentoj për ta hedhur fajin në një vend tjetër. Shkaktarët dhe zbatuesit e këtyre ngjarjeve janë të tjerët, por për shkak se ne e kemi humbur botëkuptimin e umetit dhe për shkak se brenda vetes sonë kemi probleme që nuk përputhen me botëkuptimin e umetit, ne i blejmë shumë lehtë nxitjet dhe provokimet që na vijnë nga jashtë dhe në vend që të luftojmë me fuqitë që janë burimi i problemit, ne përplasemi me njëri-tjetrin. Dhe kjo na largon nga të qenit një umet.





Zgjidhja e problemeve VËLLAZËRIA ISLAMË

Doç. dr. Mustafa Karabaxhak

Një nga urdhrat bazë të Islamit është që myslimanët ta shohin njëri-tjetrin si vëllezër dhe të bëjnë atë që kërkon vëllazëria. **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër!..”**¹ Pra, besimtarët nuk janë gjë tjetër përveçse vëllezër dhe për rrjedhojë, duhet të sillen si vëllezër me njëri-tjetrin. Ndërsa Profeti (a.s.), ka thënë: **“Nuk do të keni besuar (plotësisht), pa dëshiruar për vëllain tuaj atë që dëshironi për veten!”**² Po ashtu, në një hadith tjetër Profeti (a.s.), shprehet: **“Betohem në Allahun që e ka në dorë jetën time se, nëse nuk besoni, nuk do të hyni në Xhenet dhe pa e dashur njëri-tjetrin nuk do të besoni.”**³

Allahu i madhëruar e përcakton në këtë mënyrë qëndrimin e myslimanëve ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj mohuesve të fesë: **“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre...”**⁴ Ndërsa Rasulullahu (a.s.), qëndrimin e besimtarëve ndaj njëri-tjetrit, e përshkruan në këtë mënyrë: **“Besimtarët në dashuri, në mëshirë dhe në dhembshuri ndaj njëri-tjetrit, janë si shembulli i trupit, i cili kur i shqetësohet një prej organeve, edhe organet e tjera ndjejnë shqetësim dhe temperaturë.”**⁵

Nuk duhet të ndahesh kurrë prej xhematit

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat

tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj!..”⁶

Profeti ynë (a.s.), personin që ndahet prej xhematit, e ka konsideruar sikur të ketë dalë prej Islamit: **“Kush ndahet një pëllëmbë prej xhematit islam, është sikur ta ketë hequr e ta ketë hedhur veshjen islame.”**⁷ **“Kush ndahet qoftë edhe një pëllëmbë prej xhematit, është ndarë prej Islamit.”**⁸ **“Kush ndahet prej xhematit dhe nuk pranon të bindet, ai do të takohet me Allahun pa pasur asnjë vlerë tek Ai.”**⁹

NDIHMA E ALLAHUT ËSHTË NË XHEMAT

Është e domosdoshme të ruhesh prej çdo veprimi që do ta shkatërronte unitetin dhe bashkimin. Dihet se herë pas here, në mënyrë të veçantë të rinjtë, bëhen pjesë e grupeve dhe rrymave të gabuara. Me qëllim që të rinjtë të mos anojnë nga grupet dhe rrymat e gabuara, është e domosdoshme që atyre t'u jepet një edukim i mirë fetar. Në këtë pikë, një detyrë e rëndësishme bie mbi prindërit. Nëse i shohim të rinjtë e mashtruar, vërejmë se atyre u mungon një edukim i mirëfillt fetar. Madje, disa nuk ia kanë fare haberin fesë. E disa të tjerë nuk dinë më tepër se disa gjëra që i kanë mësuar përmendsh.

Një gjë është e vërtetë, se pa i njohur mirë dijet në lidhje me Kuranin, nuk mund ta kuptosh atë siç duhet. Botëkuptimi i fesë tek njerëzit e tillë, i ngjan

përshkrimin të elefantit në errësirë. U morën disa të verbër dhe iu kërkua të përshkruanin elefantin duke e prekur. Ai që e prekte elefantin nga këmbët, e përngjante me shtyllat, ai që e prekte nga veshët, thoshte se i ngjan gjetheve të palmës dhe ai që e prekte prej feçke, thoshte se i ngjan zorrës. Në të vërtetë, asgjë nuk mund të përshkruhet e plotë, nëse njeh vetëm një pjesë të saj.

Për rrjedhojë, këta të mjerë me mendje të cekët që e kuptojnë Islamin vetëm për të vrarë, nuk arrijnë ta kuptojnë kurrë se sa e çmuar është t'i shpëtosh jetën një njeriu: **“Prandaj Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve...”**¹⁰

Këtyre njerëzve që nuk kanë mundësi të lexojnë goftë edhe një libër që tregon jetën e Profetit (a.s.), duhet t'u kujtojmë edhe faktin historik se: Gjatë luftërave që u zhvilluan nga shteti islam, i cili u zgjerua me tre milion metër katrorë vetëm dhjetë vite pas vdekjes së Profetit (a.s.), numri i myslimanëve të rënë në luftë, ishte rreth 150, ndërsa numri i të vrarëve në radhët e armikut, nuk i kalonte 250.¹¹

U duhet kujtuar edhe se Resulullahu (a.s.), shkonte për ngushëllim kur vdiste ndonjë jomysliman, i gostiste ata dhe e pranonte gostitjen e tyre, sillej me respekt ndaj tyre dhe madje kur në rrugë kalonte ndonjë kortezh mortor, ai ngrihej në këmbë dhe, kur e pyesnin për shkakun e kësaj, ai përgjigjej: **“A nuk është edhe ai njeri?”**.

Nëse shohim sot botën islame, vërejmë se aty rrjedh vetëm gjak e lot dhe padrejtësitë s'kanë të sosur. Numri i myslimanëve që vdesin sot në një ditë të vetme, është shumë më tepër se numri i myslimanëve që vdiqën në të gjitha luftërat gjatë jetës së Profetit (a.s.). Kjo, sepse ndërmjet luftërave të Profetit (a.s.) dhe luftërave të sotme nuk ka asgjë të përbashkët veç emrit dhe mbi të gjitha sot luftojnë vëllezërit e fesë me njëri-tjetrin. Edhe ai që vritet, edhe ai që vret janë njerëz të mjerë e të mashtruar që besojnë të njëjtat vlera. Sipas të dhënave zyrtare, në luftërat që janë zhvilluar midis viteve 1979-2010, janë vrarë 11 milion myslimanë dhe janë gjymtuar rreth 60 milionë të tjerë. Ndërmjet viteve 1990-2009, në botën islame janë vrarë 34.906 punonjës shteti, 127.000 biznesmenë dhe 2.411 lider.

Shumica e këtyre vrasjeve ka ndodhur prej dorës së vëllezërve të fesë. Edhe i vrari pretendon se ka vdekur në emër të Allahut, edhe vrasësi pretendon se ka vrarë në emër të Allahut. Mirëpo, Profeti ynë (a.s.), ka thënë: **“Nëse dy myslimanë ngrenë shpatat kundër njëri-tjetrit, edhe i vrari, edhe vrasësi janë në Xhehenem.”**¹² Ndërsa Allahu i Madhëruar, urdhëron: **“...Mos t'ju nxisë urrejtja ndaj disa njerëzve, që ju**

penguan të vizitoni Qabënë, pra, kursesi të mos ju nxisë që t'i sulmoni! Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!..”¹³

Megjithëse besimtarët në të katër anët e botës luten për bashkimin e myslimanëve dhe ndalimin e gjakut, ende nuk është gjetur një zgjidhje, sepse lutjet po bëhen vetëm me gojë dhe nuk po vihen në jetë. Mbi të gjitha, çdo mysliman i bie çanakut më vete dhe të gjithë po garojnë me njëri-tjetrin në smirë, intolerancë, zili, mendjemadhësi dhe përçmim.

Njëherë, Profeti ynë (a.s.), tha: **“Umetit tim do t'i ngjiten sëmundjet e umeteve (të mëhershme)”**. Kur sahabët e pyetën: **“Cilat do të jenë sëmundjet e umetit?”**, ai u përgjigj: **“Teprimi, lazdrimi, mburrja dhe garimi me njëri-tjetrin në lidhje me këtë botë, largimi ndaj njëri-tjetrit dhe smira. Kështu që do të shfaqen padrejtësitë dhe anarkia.”**¹⁴ Mirëpo, Allahu ndihmon grupet që janë të bashkuar. **“Dora e Allahut, është mbi xhematin.”**¹⁵ **“Në xhemat ka mëshirë, në ndarje ka dënim.”**¹⁶

Një nga veprimet më të rëndësishme që e prish bashkimin dhe unitetin midis myslimanëve, është klanizmi si në aspektin individual, ashtu edhe në atë shoqëror.

ELEMENTI MË I RËNDËSISHËM QË E PRISH VËLLAZËRINË ISLAME, ËSHTË KLANIZMI

Një nga ndikuesit më të rëndësishëm që e prish bashkimin dhe unitetin mes myslimanëve, është klanizmi ose tribalizmi. Klanizëm, do të thotë të mbrosh klanin apo fisin tënd goftë edhe në padrejtësi, të mburresh me prejardhjen, të pretendosh epërsinë e racës tënde, t'i urresh dhe t'i përçmosh ata që nuk janë prej fisit apo klanit tënd.

“Kush ushqen ndjenja klanizmi, nuk është prej nesh; edhe ai që lufton për shkak të klanizmit nuk është prej nesh; po ashtu edhe ata që vdesin për hir të klanizmit nuk janë prej nesh.”¹⁷

Ajo që duhet të bëhet, është t'u japim fëmijëve tanë një edukim të mirë fetar, të rishikojmë vëllazërinë islame nën dritën e Kuranit dhe Sunetit, të zbatojmë urdhrat e këtyre burimeve kryesore të Islamit dhe të mos kaplohemi nga ndjenjat e kota të klanizmit.

Referencat: **1)** Huxhurat, 10. **2)** Buhari, Iman, 7; Tirmidhi, Sifetu'l-Kijame, 59. **3)** Ebu Daud, Edeb, 130,131; Tirmidhi, Menakib, 28. **4)** Fet'h, 29. **5)** Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr, 66-67. **6)** Al-i Imran, 103. **7)** Ebu Daud, Sunnet, 26; Tirmidhi, Edeb, 78. **8)** Bezzar, Musned, VII, 334, hadithi nr: 2933; Nesai, Sunenu'l-kubrà, III, 428, hadithi nr: 3649. **9)** Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 387, 406. **10)** Maide, 32. **11)** shih. Hamidullah, Muhamed, Luftrat e Profetit (a.s.), fq. 12-13. **12)** Buhari, Iman, 22, Rikak, 31, Fiten, 10; Muslim, Fiten, 14. **13)** Maide, 2. **14)** Hakim, Mustedrek, IV, 282, hadithi nr: 7390. **15)** Tirmidhi, Fiten, 7; Sujuti, Xhamiu's-sagir, II, 205. **16)** Kuzai Musnedu'sh-Shihab, I, 43, hadithi nr: 15; Sujuti, Xhamiu's-sagir, I, 145. **17)** Ebu Daud, Edeb, 111.

Vëllazëria Islame

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan



Para se të nderoheshin me Islam fiset vendase në Medinë, “Eus” dhe “Hazrexh”, kishin luftuar me njëri-tjetrin për më tepër se njëqind vite. Madje, përplasja e tyre e fundit kishte ndodhur pesë-gjashtë vjet para hixhretit/emrigrimit. Këto beteja, njiheshin me emrin “Betejat Buas”.

Në aspektin etnik, këto dy fise ishin vëllezër, por në fakt ata ishin armiq të njëri-tjetrit. Me ardhjen e Islamit në Medinë, në sajë të ndjenjave dhe parimeve të vëllazërisë islame, si cilësi e një identitetit të lartë që solli Islami, në fillim u bënë vëllezër feje me njëri-tjetrin, pastaj ndërmjet muhaxhirëve/emigrantëve, me ç’rast morën edhe emrin Ensar. Shoqëria dhe civilizimi Islam me të gjitha veçoritë dhe bukuritë e tij, u ndërtua pikërisht mbi këtë truall shoqëror, themelet e të cilit i hodhi vëllazëria islame.

Bashkimi dhe uniteti i Ensarëve, në mënyrë të veçantë brenda tyre, i shqetësoi shumë hebrenjtë e Medinës. Ata filluan të kërkonin taktika të ndryshme për të shkaktuar probleme dhe për të përçarë në një farë mënyre shoqërinë islame të Medinës, e cila ishte treguar e suksesshme në vëllazërimin islam.

Një ditë, një hebre i moshuar dhe ngatërrestar, Shas Ibn Kajs, pa një grup prej fiseve Eus dhe Hazrexh që bisedonin me dashamirësi dhe sinqeritet midis tyre, gjë që e shqetësoi pa masë atë. Për këtë arsye, ai thirri një të ri prej hebrenjve dhe i tha: “Shko hyr midis tyre dhe folu për luftërat e vjetra të “Betejave Buas”... Recitoju poezitë që kanë recituar dikur po-

etët e të dyja palëve në lidhje me njëri-tjetrin dhe nxiti ndjenjat e nacionalizmit tek ta!”

I riu hebre veproi pikërisht ashtu siç iu tha. Si rezultat i kësaj, tek ata njerëz u rishfaqën ndjenjat e krenarisë dhe epërsisë. Për rrjedhojë, ata e lanë bisedën e ëmbël dhe filluan t’i mburrëshin njëri-tjetrit. Të dyja palët filluan të shpalosnin dhe të numëronin virtytet dhe cilësitë e larta të popullit dhe fisit ty tyre. Madje, ata recituan edhe poezi në mënyrë reciproke. Më në fund, dy të rinjtë u ngritën mbi gjunjë dhe filluan të ofendoheshin, duke e sfiduar njëri-tjetrin në duel. Ndërsa të tjerët, e mbështetën këtë sfidë si të verbër. Për rrjedhojë, ata dolën jashtë Medinës në një vend të quajtur Harre, me qëllim që të luftonin. Përveç kësaj, të dyja palët u çuan fjalë edhe pjesëtarëve të tjerë të fiseve të tyre. Kur fiset Eus dhe Hazrexh u mblodhën në vendin e përmendur dhe ishin gati të përplaseshin me njëri-tjetrin, Profeti ynë (a.s.), i cili ishte lajmëruar më parë për gjendjen, arriti në kohë në vendngjarje së bashku me një grup myslimanësh të përbërë prej muhaxhirëve dhe ensarëve dhe iu drejtua të pranishmëve:

“O myslimanë! Kini frikë Allahun, Allahun!.. Ende e ushqeni kauzën e injorancës, ndërkohë që unë jam midis jush, Allahu ju ka nderuar me Islam, ju ka gostitur me Islamin, ju ka çrrënjësuar botëkuptimin e injorancës me Islamin, ju ka shpëtuar prej humnerës së mohimit



dhe ju ka bashkuar zemrat?”¹

Pas këtyre fjalëve të Rasullullahut (a.s.), pjesëtarët e të dyja fiseve e kuptuan se kjo punë ishte një hile e ngatërrestarit hebre dhe një mashtrim i shejtanit. Ata i hodhën armët dhe e përçafuan njëri-tjetrin duke qarë. Kështu, ata vazhduan të jetonin përsëri lumturinë e vëllazërisë Islame.

Kjo ndodhi, tregon qartë se, pa u ndërtuar në fillim vëllazëria islame përbrenda, është e vështirë ta jetosh këtë strukturë jashtë. Lidhur me këtë, një thirrje dhe paralajmërim i përgjithshëm i Profetit tonë (a.s.), që ka arritur deri tek ne me disa transmetime, urdhëron:

“O sahabët e mi! Mos e armiqësoni dhe mos e smironi njëri-tjetrin! Mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit dhe mos u shkëputni. O robërit e Allahut! Bëhuni vëllezër. Nuk është e lejuar që myslimani ta braktisë dhe të hidhërohet me vëllain e tij të fesë për më tepër se tri ditë.”²

Shprehjet *“O robërit e Allahut”* dhe *“vëllezër”*, të cilat janë përdorur në këtë thirrje dhe paralajmërim të Profetit tonë (a.s.), kuptohet qartë se janë përdorur si absolute dhe të përgjithshme. Në një transmetim tjetër ku përdoret shprehja *“Siç ju ka urdhëruar*

Allahu”³, shfaqet qartë para syve tanë se vëllazëria islame, është thelbi i kësaj çështjeje.

Në këtë transmetim dhe në transmetime të ndryshme të këtij hadithi, kufizimet dhe shënimet që janë radhitur si domosdoshmëri të *“vëllazërisë”*, janë të fokusuara të gjitha *“mbi bindjen e Allahut”* dhe tregojnë se çfarë niveli dhe çfarë pastërtie morale duhet të ketë umeti islam dhe struktura sociale e shoqërive.

Përveç kësaj, -në një transmetim tjetër- mënyra për të arritur *“vëllazërinë islame”*, është e lidhur me besimin e vërtetë dhe me ndjenjën e dashurisë dhe dashamirësisë ndaj myslimanëve të tjerë. Dhe, për të qenë vazhdimisht të vetëdijshëm për këtë lidhje dashurie dhe vëllazërie, është këshilluar një mënyrë shumë praktike, që është *“përhapja e selamit”*.⁴

Në civilizimin dhe kulturën Islame, ekzistojnë dy koncepte që i atribuohen Krijuesit të Madhërisë në dy çështje: *“Selami i Allahut dhe mysafiri i Allahut”*. Nëse i mendojmë dhe i vlerësojmë këto dy koncepte së bashku me këshillën: *“O robër të Allahut! Bëhuni vëllezër!”*, do të kuptohet qartë se sa ka funksionuar parimi i *“vëllazërisë islame”* në aspektin social të shoqërisë islame. Për këtë arsye, asnjë lidhje nuk del dhe nuk mund të dalë para virtytit të *“vëllazërisë islame”*.

Sjelljet që përbëjnë pengesë në realizimin e *“vëllazërisë”*, që përmendet në transmetimet e hadithit⁵, na tërheqin vëmendjen për situatat që nuk përputhen me vëllazërinë, si përçarja, copëtimi, ftohtësia, shkëputja etj., të cilat vërehen në shoqëritë myslimane, si robër të Allahut ndaj të cilëve bëhet kjo thirrje. Atëherë, çdo mysliman duhet ta ndjejë mirë në shpirt se me myslimanët e tjerë është i lidhur me një lidhje të brendshme vëllazërore dhe se këtë e ka kaktuar dhe deklaruar Allahu i Madhëruar, i Cili ka urdhëruar: ***“Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër!”***⁶

Për t'i bërë ballë çdo lloj zhvillimi pozitiv apo negativ që do të shihet me kohën në strukturën sociale të umetit islam, i cili është ndërtuar mbi themelet e vëllazërisë, është përcaktuar edhe *“parimi i restaurimit”*: *“Emri bi'l ma'ruf ue nehji ani'l-munker / Urdhërimi në punë të mira dhe ndalimi nga e keqja”*. Padyshim se qëndrimi aktiv në mënyrë të vazhdueshme i këtij parimi midis myslimanëve si domosdoshmëri e lidhjes vëllazërore, nuk është aspak element presioni, por një metodë dhe thirrje për besim, përsosje dhe pjekuri.

1. Ibn Hisham, Sijre I, 555. Transmetohet se, pas këtyre fjalëve të Rasullullahut (a.s.), Allahu zbriti ajetet 98-103 të sures Al-i Imran.

2. Buhari, Edep 57; Muslim, Birr 28.

3. shih. Muslim, Birr 30.

4. Muslim, Iman 93.

5. shih. Buhari, Edep 57-58; Muslim, Birr, 23-32.

6. Huxhurat 10.

Lufta me armiqtë E FESË



Feja jonë madhështore Islami, në marrëdhënie me myslimanët nxjerr në plan të parë dashurinë, ndërsa në marrëdhënie me jomyslimanët nxjerr drejtësinë. Është e pamundur të duash të gjithë njerëzit, por ne jemi të detyruar të sillemi me drejtësi ndaj të gjithëve. Sigurisht që kjo vlen ndaj atyre që nuk ushqejnë synime për të dëmtuar vlerat e myslimanëve dhe të Islamit. Jomyslimanët dhe miqtë e tyre hipokritë të kamufluar nën petkun e myslimanit, të cilët i shpallin luftë të hapur Islamit dhe myslimanëve, është e domosdoshme t'i kritikosh dhe të vësh në pah punët e tyre të këqija. Nisur nga kjo, Profeti ynë (a.s.), ka urdhëruar Hasan bin Sabitin (r.a.) dhe disa sahabë të tjerë poetë, që të nxjerrin në pah veprat e këqija të atyre që sulmonin Islamit dhe Profetin (a.s.). Ndërsa Imam Rabbani, në një letër drejtuar një nxënësi të tij, është shprehur:

“Miku im i dashur! Kur mohuesit kurejshë i shtuan ofendimet dhe sharjet ndaj besimtarëve myslimanë si shkak i tërbimit dhe injorancës së tyre, Rasulullahu (a.s.), urdhëroi disa poetë myslimanë, të nxjerrin në pah të keqen e mohuesve. Poeti që mori këtë urdhër, ngjitej në minber në prezencë të Rasulullahut (a.s.) dhe recitonte poezi që nxirrnin në pah të këqijat e mohuesve në mes të popullit.” (Mektubat, V. I, fq. 139.)

Kur shohim letrat e Imam Rabbanit, vërejmë se edhe ai nuk i ka kursyer fjalët e tij të rrepta ndaj armiqve të Islamit. Sot disa grupe fetare, në emër të dialogut dhe tolerancës fetare kanë hyrë në dialog me organizata vendase dhe të huaja që përpiqen të

dobësojnë Islamin. Madje, ata përdorin edhe shprehjen e Xhelaleddin Rumiut, “Eja, çfarëdo qofsh eja!”. Mirëpo, kjo nuk është asgjë tjetër veçse abuzim me thënien e këtij të madhi të tasavufit.

Po, sufistët i ftojnë të gjithë në paqe dhe harmoni. Mirëpo, kjo nuk nënkupton atë që pandehin disa, se ata mund të pranojnë çdo lloj besimi të devijuar dhe t'i konsiderojnë ato si normale. Po në të njëjtën mënyrë, është kuptuar gabim edhe një thënie tjetër: “T'i shikosh krijesat me syrin e Krijuesit.” Padyshim se kjo thënie, do të thotë të respektosh të gjitha krijesat e Allahut, përfshi edhe njeriun, duke i mëshiruar ato për hir të Krijuesit. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, në Fjalën e Tij madhështore, e dënon çdo lloj shirku, mohimi dhe dyfytirësie, duke paralajmëruar me Xhehenem në shumë ajete. Pra, kur është nevoja, shikimi i Krijuesit përfshin edhe qortimin e veprave të këqija të krijesave.

Imam Rabbani na tregon një hadith fisnik, në të cilin thuhet se ata që veprojnë kështu, do të gëzojnë ndihmën e Xhebrailit (a.s.):

Profeti ynë (a.s.), duke pasur për qëllim Hasan bin Sabitin (r.a.), tha: *“Për sa kohë që ai të vazhdojë t'i ulë mohuesit (me poezi), Ruhul-Kuds (Xhebraili) do të jetë me të.”* (Buhari, Megazi, 31. Nr. 4123.)

Ndërsa çështja më e rëndësishme së cilës i duhet kushtuar kujdes, është që ndërkohë që kritikojmë të tjerët në emër të Islamit, të qëndrojmë larg nga veprimet në emër të egos personale. Është e domosdoshme t'i përgjigjemi fjalëve me fjalë dhe jo siç

bëjnë disa grupe që thonë se veprojnë në emër të Islamit dhe vrasin e torturojnë të tjerët. Nuk kuptohet kjo nga letra e Imam Rabbanit. Në fakt, vendimi për këto lloj çështjesh i takojnë vetëm shtetit dhe i kapërcejnë kompetencat e individëve. Për rrjedhojë, edhe ndjekësit e Imam Rabbanit i janë përgjigjur mendimeve me mendime. Po kështu edhe në ditët tona, ka shumë besimtarë të fushës së letërsisë e gazetarisë, të cilët me anë të librave, artikujve dhe bisedave televizive, përpiqen t'u japin përgjigjet e merituar armiqve të Islamit dhe sulmeve të tyre të padrejta ndaj Islamit. Imam Rabbani, shprehet se kjo lloj lufte është normale dhe nuk duhet pritur që ata të cilët ndodhen në rrugën e vërtetë të pranohen pozitivisht nga të gjithë:

“Dije se qortimi dhe dënimi i krijesave është punë e njerëzve kompetentë. O Allah, na bëj prej tyre për hir të Profetit (a.s.)!”

Me këto fjalë, Imam Rabbani është shprehur se është e pamundur të shkosh mirë me të gjithë, se ata që ndodhen në rrugën e drejtë do të hasin në njëfarë mënyrë në kritikën dhe qortimet e të tjerëve dhe se një gjë e tillë, nuk duhet të jetë shkak mërzie për ta por arsye gëzimi. Për shembull, sot, disa myslimanë, duke u nisur nga qortimet dhe përçmimet e të tjerëve, ngurrojnë të zbatojnë dhe mbrojnë disa gjykime dhe rregulla të Islamit. Kjo, është si rezultat i të mos jetuarit të fesë në nivelin e dashurisë. Për shkak se mbrojtja hapur e Islamit nuk është virtyt i çdokujt, Imam Rabbani e ka mbyllur këtë letër duke u lutur për ata që nuk kanë frikë nga përçmimet e të tjerëve në rrugë të Allahut.

Një tjetër hollësi në fjalët e Imam Rabbanit, është edhe kjo: Nëse kritikën vijnë prej armiqve të fesë, kjo duhet të jetë burim gëzimi. Por, nëse kritikën dhe qortimet vijnë prej besimtarëve të devotshëm, atëherë duhen marrë seriozisht. Madje, ato duhet ta hidhërojnë besimtarin e vërtetë. E themi me keqardhje se në ditët tona, megjithëse disa grupe bëjnë gabime shumë të rënda, ata nuk pranojnë asnjë kritikë që vjen prej besimtarëve dhe i vazhdojnë me këmbëngulje gabimet e tyre.

Por cila është urtësia e vështirësive që hasen në rrugën e fesë? Vallë, a është e mundur të bëhesh fetar dhe të shërbesh në rrugën e Allahut pa vuajtur? Sipas Imam Rabbanit, kjo gjë nuk është shumë e mundur, sidomos për ata që ndodhen në rrugën e tasavufit. Kjo, sepse të gjithë besimtarët që e duan Allahun, me në krye profetët, kanë kaluar shumë vështirësi dhe vuajtje të ndryshme. Urtësinë e kësaj, Imam Rabbani

e shpjegon në këtë mënyrë:


“Miku im i dashur! Dhimbja dhe vështirësia janë prej domosdoshmërive të dashurisë. Atij që zgjedh të bëhet dervish, i duhet patjetër dhimbje dhe hidhërim... I Dashuruari (Allahu) dëshiron të ketë dikë që e do dhe që i pret plotësisht lidhjet me çdo gjë tjetër, duke mos gjetur qetësi përveçse tek Ai Vetë. Instanca e kënaqësisë këtu, është tek mos të qenit i kënaqur... Ëmbëlsia, është tek djegia... Vendimi, tek pavendosmëria... Rehatia, tek të qenit i plagosur...” (Mektubat, V. I, fq. 140.)

Sipas Imam Rabbanit, Allahu i Madhëruar, me qëllim që në zemrën e robërve që i do të mos mbetet asnjë interes apo lidhje me asgjë të kësaj bote, i bën ata të ftohen prej çdo gjëje përveç Vetes së Tij. Ai i jep vuajtje robit të Tij me anë të gjërave të kësaj bote, me qëllim që robi të strehohet tek e vetmja strehë, që është Allahu dhe të mos e lidhë zemrën e tij pas gjërave të kësaj bote.

Ndërsa lidhja më e keqe ndër gjërat e kësaj bote është t'u servilosesh armiqve të Allahut, duke shpresuar diçka prej tyre. Ja pra, ilaçi i kësaj është të mos shfaqësh miqësi ndaj tyre, por t'i ulësh ata. Për njeriun, gjëja më e vështirë është të luftojë me të ngjashmit e vet për hir të një kauze dhe përballja me kritikën dhe torturat për shkak të kësaj. Sipas Imam Rabbanit, asnjë besimtar i sigurt nuk duhet të dëshirojë të shpëtojë prej këtyre gjendjeve, sepse shpëtimi gjendet në mësimin e vetes me të qortuar dhe me t'u qortuar në rrugën e Allahut. Myslimani, ka raste që qortohet për hir të Allahut dhe ka raste që i duhet atij të qortojë dikë për hir të Allahut:

“Në këtë instancë, të kërkosh të shpëtosh, do të thotë ta hedhësh veten në telashe. T'ia dorëzosh veten plotësisht të Dashurit, do të thotë të jesh i kënaqur me çdo gjë që vjen prej Tij dhe të pranosh pa ia kthyer shpinën e pa refuzuar. Ja pra, kjo është rruga e shpëtimit. Për të arritur në rrugën e vërtetë, duhet të punosh me të gjitha forcat e tua, përndryshe tersllëqet nuk do të ndahen kurrë prej teje.”

Në tasavuf, e rëndësishme është të kërkosh prej Allahut lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër. Mirëpo, ligji i Allahut është të durosh disa vështirësi të kësaj bote që të arrish lumturinë e botës tjetër. I lutemi Allahut të Madhëruar të na e shtojë forcën në këtë çështje, me qëllim që të mos mposhtemi prej kundërshtimeve të njerëzve në rrugën e Allahut dhe të na e mësojë dashurinë për atë që e meriton dhe qortimin për atë që e ka hak. Amin!



Feja jonë madhështore Islami, në marrëdhënie me myslimanët nxjerr në plan të parë dashurinë, ndërsa në marrëdhënie me jomyslimanët nxjerr drejtësinë. Është e pamundur të duash të gjithë njerëzit, por ne jemi të detyruar të sillemi me drejtësi ndaj të gjithëve.



Shpërbërja e personalitetit

Prof. dr. Irfan Gyndyz

Njeriu kujton se pa e pastruar më parë veten, mund të pastrojë rrethin e tij dhe mjedisin. Ai mendon se pa shpëtuar botën e tij të brendshme, mund të shpëtojë shoqërinë dhe njerëzimin. Duhet ditur se me fjalë është e lehtë të pastrosh egon dhe të purifikosh veten, por në praktikë, është e vështirë dhe është një punë që kërkon mund, vullnet, durim, qëndresë dhe një përpjekje të madhe. Nuk duhet harruar as fakti se në këtë udhëtim, rruga është e rrëshqitshme dhe udhëtarët gjenden përballë rrezikut të rrëshqitjes së këmbës. Për rrjedhojë, në këtë rrugë duhet të kapesh fort me thonj, të derdhësh djersë dhe të këmbëngulësh shumë.

Aspekti subjektiv i njeriut është “uni”, ndërsa aspekti objektiv është “identiteti”. Përputhja dhe harmonia e unit me identitetin, quhet “karakter”. Një personalitet i pastër prej çdo lloj kompleksi dhe kapriçoje, është ai që shkel fort mbi truallin e rrëshqitshëm dhe vazhdon të ecë i vendosur dhe pa u ndikuar prej çorientimit dhe shpërbërjes së persona-

litetit. Është ai që ndikon dhe nuk ndikohet, që tërheq, jo që tërhiqet, që përcakton, jo që përcaktohet, që ngjyros, jo që ngjyroset, që i jep drejtim erës, e jo që drejtohet andej nga fryn era dhe që vazhdon të ecë gjithmonë në vijën e rrugës së drejtë.

Një njeri me personalitet, është ai që zotëron mendjen dhe zemrën e vet. Është njeriu që mendon me mendjen e vet, që ndjen me zemrën e vet, që mund të pyesë e të mbrohet dhe në të njëjtën kohë, di të llogaritë. Për rrjedhojë, ai nuk është një njeri hije apo kopje, por njeri unik. Është ai që arrin ta ndërtojë mirë harmoninë dhe ekuacionin trup, zemër dhe mendje. Është ai që vepron sipas vlerave dhe jo sipas situatave dhe ndjenjave. Parimi i tij është mesazhi, jo personi. Për të, përcaktues është parimi dhe jo fenomeni, ndërsa në qendër është e vërteta dhe jo komenti. Ai zotëron unitetin e parimeve që i japin përparësi vlerave dhe jo interesit, fitimit, suksesit apo kësaj bote. Ja pra, ai person që i ka përvetësuar të gjitha këto, është i aftë, i matur dhe i nderuar.

Ai është njeriu “që kërkohet”, “që pritet” dhe “që i ndihet mungesa”.

Kur tërhiqen nga skena individët e gjithanshëm, vendi u mbetet egoistëve dhe personave pa përvojë. Njeriu i cili nuk mund të shpëtojë dot prej burgut të zi të egos, nuk mund të prodhojë as vlera dhe nuk mund të mbajë në këmbë as ekzistencën e vet. Në ditët tona, dështimi më i hidhur i shoqërisë që endet në paqartësi, shfaqet në formën e humbjes së personalitetit dhe krizës së identitetit. Sot është edukuar një brez, të cilit i është marrë nga dora shija për t'u veshur, që nuk vishen siç duan vetë, por janë bërë robër të modës dhe stilistëve, e që sillen të ndikuar nga presioni i opinionit.

Rruga e drejtë, të cilën Profeti ynë (a.s.), është urdhëruar të ndjekë: **“Bëhu i drejtë ashtu siç je urdhëruar (jo si të dojë qejfi)”**, na tregon vijën e jetës mbi të cilën ne duhet të ecim me shumë kujdes. Përçarja jonë në mendje dhe mendime, hallakatja jonë morale, rrëshqitja e këmbëve tona, planet tona për suksese dhe për të ardhmen, interesat tona afatshkurtra, dobësitë tona dhe robëria jonë ndaj dëshirave e qejfeve, janë shkaqet kryesore të devijimit tonë nga rruga e drejtë. Ne jemi të detyruar të qartësojmë qëndrimin tonë përballë të gjitha këtyre rreziqeve dhe ta fiksojmë kompasin tek Kurani dhe Suneti.

Myslimani, nuk duhet ta përcaktojë orientimin e tij sipas zhvillimeve konjunkturale, por sipas parimeve dhe kriterëve të pandryshueshme të Islamit. Orientimi, nuk është një faktor që ndryshon sipas zhvillimeve të përditshme apo sezonale.

Ne duhet të gjejmë rrugën për të jetuar si subjekte që eliminojnë të keqen dhe ngjallin të mirën me një ndjesi origjinale Islame. Fakti që jemi objekt i përpjekjeve për të na rrëmbyer prej vetes dhe për të na larguar prej vlerave tona dhe i cili drejtohet me mjeshtëri prej shfrytëzimit kulturor, duke na shpërndarë si gjethet në erë, pa vullnet dhe pa reagim, është një humbje shumë e madhe. Megjithatë parimet islame janë të qarta sa mund t'i kuptojnë të gjithë, disa prej nesh, në vend që të ruajnë orientimin duke marrë për bazë parimet në çdo situatë,


bëhen të paqëndrueshëm dhe ndryshojnë pozicionin e tyre sipas erërave që fryjnë. Dhe kjo, është shumë shqetësuese.

Zoti ynë flet për një grup që bën zhurmë kur lexohet Kurani. Ata bëjnë zhurmë me qëllim që mesazhi i Kuranit të mos dëgjohet dhe dëgjuesit të mos e kuptojnë atë. Po ashtu edhe sot, të rinjtë çirren e bërtasin që të mos njihen me mesazhin e Kuranit. Këto janë zhurma artificiale dhe false. Lojërat në kompjuter dhe në internet, që i kanë robëruar të rinjtë dhe çmenduria e rrjeteve sociale, i kanë shkëputur njerëzit prej realitetit. Lojërat e kumarit, telenovelat, fanatizmi i futbollit, etj., janë lodrat më të mëdha që kanë vjedhur identitetin tonë dhe na bëjnë të merremi me punë të padobishme. Profeti ynë (a.s.), ka

thënë: *“Nëse njeriu e ruan veten prej punëve dhe fjalëve të padobishme, kjo është prej bukurisë së moralit të tij.”* Me këto fjalë, ai na ka paralajmëruar se duhet të ruhem prej lojërave mashtruese dhe vjedhëse të kohës. Sot të rinjtë janë hipnotizuar me kulturën perëndimore me anë të televizionit, të shkollës dhe të rrugës dhe kanë rënë në vorbullën e vlerave të kota.

Nëse shohim qëndrimet ndaj individit në mësimet dhe ideologjitë joislame, vërejmë se njeriu ndodhet përballë rrezikut, ose të kushtëzimit, ose të lazdrit. Individit i kohëve moderne është kapluar nga një dehje, një

lazdrim dhe një helmim i forcës që mbështetet në mendjen, dijen, fuqinë, pushtetin dhe materien. Ndërsa njeriu i kohëve më të hershme ka jetuar nën presionin e kushtëzimit ndaj tabuve, totemeve dhe traditave... Qoftë koha moderne që ka idhujtarizuar individin, qoftë koha më e hershme që e ka skllavëruar atë, të dyja i kanë bërë padrejtësi njeriut. Ato kanë sforcuar dhe kanë prishur natyrën njerëzore. Procesi i bërjes së njeriut njeri dhe i mbetjes si i tillë, shtyhet vazhdimisht. Gjynahu më i madh i kësaj kohe, është edukimi i masave pa ndjenja, pa vlera, pa shqetësime, pa qëllime, pa shpirt, pa identitet dhe pak karakter. Masat pa qëllim dhe pa ndjenja, po përpëliten vazhdimisht në vorbullën e të pakuptimitës. Shoqëritë që kanë humbur identitetin, përveçse një turme të thatë, nuk mund të bartin veçori dhe esencë. Ata që nuk ia kanë arritur të fitojnë karakter,



nuk mund të shpëtojnë nga të qenit të rëndomtë dhe të hallakatur.

Qëndrueshmëri, do të thotë të jesh i vendosur, të mbash fjalën, të jesh besnik dhe të tregosh vullnet të fortë për të mos u kthyer më nga një vendim i marrë pas një mendimi të matur. Teprimi në qëndrueshmëri, kthehet në inat, ndërsa mungesa e saj është pavendosmëri. Njeriu, vendosmërinë duhet ta përdorë në çështje të ligjshme, të dobishme dhe hallall. Për rrjedhojë, nuk mund të tregosh qëndrueshmëri në punët e dëmshme dhe haram që ka ndaluar Allahu. Profeti (a.s.), ka thënë: *“Zemra e birit të Ademit, turbullohet më shpejt se një kazan që zien.”* Ndërsa në një hadith tjetër, shprehet se: *“Zemra, është quajtur kështu për shkak se ajo ndryshon dhe dredhon. Zemra është si qimja në trungun e pemës, të cilën era e lëviz shumë lehtë.”* Këto hadithe, tregojnë qartë se, pavendosmëria, devijimet dhe çorientimet, më parë ndodhin në zemër. Këtë fakt, e tregon më bukur kjo dua e Profetit tonë (a.s.): *“O Zoti im që i rrotullon dhe i kthen zemrat. Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde, në adhurim dhe në bindjen ndaj Teje. Mos më lër në dorë të vetes sime qoftë edhe sa një hapje mbyllje e syrit, madje edhe më pak se ajo!”*

Fjala *“istikamet”*, do të thotë i saktë, i rregullt, i ekuilibruar, i qëndrueshëm dhe i vendosur. Ajo përdoret për të shprehur drejtësinë, ndershmërinë, bindjen, besnikërinë etj. Ndërsa si koncept fetar, fjala *“istikamet”*, në përgjithësi përkufizohet në këtë mënyrë: *“Bërja e një jete në përputhje me gjykimet fetare dhe morale, ruajtja prej çdolloj teprimi, bindja ndaj Allahut dhe ndjekja e Sunetit të Profetit (a.s.).”*

Fjala *istikamet*, përdoret edhe në lidhje me rrugën si një vijë e drejtë dhe për rrjedhojë, rruga e vërtetë dhe e drejtë, është quajtur *“siratul mustakim”*. Kjo, përkufizohet edhe si: *“Përparim në rrugën e drejtë pa devijuar dhe pa u hallakatur”, “Të bësh një jetë me një besim të sigurtë e të vendosur në rrugën e së vërtetës dhe mirësisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të ekuilibruar”, “Të qëndrosh larg çdolloj besimi jo Islam, mendimeve, sjelljeve, bid’ateve dhe trillimeve fetare në kundërshtim me Sunetin, duke jetuar sipas ligjeve të Kuranit dhe Sunetit.”*

Pa u njohur kuptimi i fjalëve, kaum, kijam, ikame dhe kajjum, nuk gjendet *istikameti* dhe pa u njohur *istikameti*, nuk mund të jesh *mustakim*. Në Kuranin fisnik, e njëjta fjalë përdoret edhe si emër edhe si folje: *“Bëhu i drejtë, ashtu siç je urdhëruar!”*, *“Na udhëzo në rrugën e drejtë”*, *“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë*

të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.”

Ikame, do të thotë ta bësh diçka në mënyrën më të përsosur duke i dhënë hakun. Për rrjedhojë, qëllimi i shprehjes, *“ikameti i namazit”*, nuk nënkupton ta kryesh atë vetëm formalisht, por ta falesh duke i plotësuar të gjitha kushtet e tij dhe të kapësh gjendjen e përkushtimit. Në ajetin e mësipërm, shprehja, *“ata që thonë Zoti ynë është Allahu”*, ka të bëjë me besimin dhe aprovimin, ndërsa shprehja *“ata që janë në rrugë të drejtë”*, ka të bëjë me punët e mira dhe të dobishme.

Individët dhe shoqëritë që e humbin *istikametin*, u ngajjnë gjërave që humbin ekuilibrin, bien në tokë dhe thyhen, duke u bërë copë e thërrime. Sa qartë dhe sa bukur e shpjegon Profeti (a.s.), këtë hallakatje të umetit: *“O umeti im! Ju ngjani me fluturat që vijnë rrotull si të çmendura përreth zjarrit. Fluturat vijnë rrotull zjarrit derisa humbin ekuilibrin, bien në të dhe digjen. Po ashtu edhe ju vini rrotull rrethit të rrezikut që kanë thurur dëshirat dhe epshet e egos suaj. Ndërsa unë përpiqem t’ju kap dhe t’ju largoj prej këtij rrethi të rrezikut”*. Urdhri i Allahut: *“Mos iu afroni zinasë (amoralitetit!)”*, nënkupton jo vetëm qëndrimin larg fenomenit të zinasë, por edhe qëndrimin larg ambientit ku bëhet ajo.

Ata që nuk mund ta kapin perspektivën islame në kriteret e jetës, hallakaten shpejt. Ata nuk mund ta ruajnë vijën e drejtë gjatë disa zhvillimeve komplekse dhe të kryqëzuara. Sot, pragmatizmi është kthyer në subjektin më të spikatur të jetës.

Qëllimi ynë duhet të jetë mbizotërimi i Kuranit dhe i Sunetit në jetën tonë. Po ashtu, qëllimi është edhe që individit dhe shoqëria të bëjnë një jetë në një botë të thurur prej shpalljes hyjnore dhe të ndërtojnë një karakter dhe shoqëri me të cilën do të kënaqet Allahu i Madhëruar. Në këtë pikë, zbatohet modeli i përmirësimit dhe i revolucionit. Ata që besojnë se i përkasin Islamit, duhen përmirësuar me shpallje, ndërsa ata që përvetësojnë vlera jo islame, duhen revolucionarizuar me shpallje. Kriteri i mendimit, teorisë, praktikës dhe parimeve, nuk duhet të jetë gjë tjetër përveç Kuranit dhe Sunetit. Nëse humbin këto, jetës nuk i mbetet asnjë kuptim.

Kjo nuk është koha për të devijuar dhe për t’u hallakatur, por koha e *istikametit*, stabilitetit, qëndrueshmërisë dhe këmbënguljes.



PËRSHËNDETJA ME SELAM

fjalëkalimi i unitetit të umetit

Ahmet Basher

Profeti ynë (a.s.), ka thënë: “Pa besuar nuk mund të hyni në Xhenet dhe pa e dashur njëri-tjetrin nuk mund të besoni. A t’ju tregoj diçka që, nëse e bëni, do të bëhet shkak i dashurisë ndaj njëri-tjetrit? Përhapeni selamin midis jush!” (Muslim, Iman, 93.)

“Selam”, është një prej emrave të Allahut të Madhëruar. Kjo fjalë përfshin kuptimet: Të jesh larg punëve të turpshme dhe fatkeqësive, të jesh në paqe dhe shpëtim. Një besimtar që i jep selam dikujt, konsiderohet se është lutur për të duke përmendur emrin e bukur të Allahut. Pra, ai thotë: “Të uroj një jetë në paqe, në shpëtim, në qetësi dhe në siguri, larg prej punëve të turpshme dhe fatkeqësive!”

Ne myslimanët duhet të jetojmë çdo moment me vetëdijen se jemi nën kontrollin e Allahut. Për rrjedhojë, edhe “selami”, është si kujdesi dhe disiplina e një ushtari që bën roje. Selami është fjalëkalimi që përdorim ne kur i afrohem një vëllai.

Selami është lutja e parë dhe e fundit që bëjmë, edhe kur takohemi me vëllezërit tanë myslimanë, edhe kur ndahemi prej tyre, duke qenë vazhdimisht të vetëdijsëm në çdo frymëmarrje se në këtë botë kemi ardhur për t’u sprovuar.

Selami, është një fjalë magjike të cilën e përdorim për të njohur vëllezërit tanë myslimanë në vende ku nuk e njohim gjuhën dhe për të reflektuar besim dhe siguri tek ta.

Selami, është përshëndetje e lehtë dhe e thjeshtë, që e bën të fitojë shpërblime edhe atë që e jep, edhe atë që e merr. Në të kaluarën ka pasur njerëz të tillë të devotshëm, të cilët kanë dalë nga shtëpia pa pasur asnjë punë, vetëm e vetëm për të fituar shpërblime duke u dhënë selam disa personave.

Selami është një fjalë e mrekullueshme që bashkon të ndarët dhe pajton të zemëruarit.

Ashtu siç na lajmëron edhe Profeti ynë (a.s.), nëse selami përhapet, do të shtohet edhe dashuria midis vëllezërve myslimanë dhe besimi ynë do të arrijë përsosmërinë. Nëse besimi ynë përsoset dhe na shtohet urtësia, do të përfundojnë edhe ndarjet e panevojshme mes umetit të Muhamedit (a.s.) dhe do të arrihet lehtësisht bashkimi i tyre.

Selami duhet të jepet sipas mënyrës së duhur, duke thënë “Es-selamu alejkum / Paqja e Allahut qoftë mbi ju!” me ëmbëlsi dhe mundësisht me buzëqeshje. Po ashtu edhe myslimani që e merr selamin, mundësisht duhet t’a kthejë edhe më bukur, duke thënë, “Ue alejkum selam, ue rahmetullahi, ue berekatutu / Paqja e Allahut, mëshira dhe begatia e Tij qofshin edhe mbi ju!”

Shumë fjalë të huaja të kulturave të ndryshme, të cilat i dëgjojmë, i shohim apo i lexojmë në televizion, gazeta, revista dhe internet, nuk mund ta zëvendësojnë kurrë “selamin”. Madje, as fjalët “mirëdita apo mirupafshim”, nuk mund ta zëvendësojnë kurrë dëshirën dhe lutjen e shprehur me anë të “selamit”. Gjithashtu, edhe lëvizjet e duarve, krahëve, syve, vetullave etj., të cilat ndonjëherë konsiderohen si veprime respekti, nuk mund ta zëvendësojnë emrin e Allahut dhe në të njëjtën kohë kuptimin e lutjes që ka selami.

Përshëndetja me selam, bëhet sipas një edukate të caktuar. Kështu që i vogli duhet t’i japë i pari selam të madhit, ai që është hipur, atij që është në këmbë, ai që ecën, atij që është ulur, pakica shumicës etj. Profeti ynë (a.s.), na ka përgëzuar se, nëse bëjmë kështu: “Do të shtohet begatia jonë dhe e familjes sonë.”

Me pak fjalë, selami do të garantojë vëllazërinë tonë, vëllazëria besimin tonë dhe besimi Xhenetin tonë!

Përqindja e përgjegjesisë sonë

— Nuredin Jëlldëz —

Është një e vërtetë e qartë se në lidhje me njerëzinë tonë, nuk mund të marrim përgjegjësi me aq sa ndikohemi nga lajmet në çështjet me burim prej fesë sonë. Po ashtu, as pesha ekonomike apo barra politike që është mbi ne nuk mund ta përcaktojë përqindjen e përgjegjesisë sonë. Pjesa jonë e përgjegjesisë, nuk mund t'u lihet as kuadrove politikë ndaj të cilëve anon zemra jonë.

Jemi njerëz dhe për shkak se jemi njerëz, jetojmë si myslimanë. Për sa kohë që të qenit njeri dhe të jetuarit si mysliman të jetë karakteri ynë thelbësor, edhe kriteri ynë i vlerësimit, duhet të jetë humanizmi dhe myslimanizmi. Përgjegjësia dhe shqetësimi ynë ndaj të gjitha zbatimeve negative mbi njerëzimin dhe të ardhmen e njerëzimit, duhet të jetë sa njerëzia jonë. Po ashtu, nëse shqetësimet tona në lidhje me të gjitha zbatimet negative mbi myslimanizmin, me projektet që e kanë bërë të pashpresë të sotmen dhe të ardhmen, me zjarret dhe vërshimet, nuk janë aq sa myslimanizmi ynë, ne nuk mund të pretendojmë për një myslimanizëm të mbushur përbrenda. Nëse shqetësimi ynë buron prej myslimanizmit tonë, atëherë edhe përqindjen e shqetësimit tonë, do ta përcaktojë

përqindja e myslimanizmit tonë. Kështu, ne kemi përgjegjësi, aq sa ndiejmë edhe shqetësim.

Mbase midis këtyre rreshtave duhet të ngucim edhe një të vërtetë tjetër. Edhe pse ajo është e rëndë aq sa na djeg shpirtin, ajo e vërtetë është se fjalët e bukura në lidhje me përgjegjësinë tonë, nuk do të kenë aspak dobi kur të vijë puna për llogaritjen e përgjegjesisë sonë reale tek Allahu i Madhëruar. Fjalët dhe qëndrimet tona, të cilat nuk e kapërcejnë cilësinë e një teksti letrar dhe që qëndrojnë veç në letër kur bie fjala për të sotmen dhe të ardhmen e umetit, nuk do të jenë aspak në cilësinë e një paraje të pranueshme në ditën e gjykimit.

Pasuria, dija, kultura, rëndësia, fuqia e fjalës, kapacitetit fizik, familja, statusi shoqëror etj., përbëjnë personalitetin tonë të formuar prej identitetit islam. Për rrjedhojë, edhe gjatë dhënies së llogarisë do të



përballeme me këto. Periudha në të cilën jetojmë, duhet të ketë një dallim midis periudhës së Mekës dhe periudhës së Medinës. Nëse në besim e konsiderojmë veten në periudhën e Mekës, atëherë në praktikë, si mund të bëjmë sikur e po jetojmë Islamin pas çlirimit të Mekës?

Fushat e përgjegjesisë sonë fillojnë me egon tonë, gjë që është një e vërtetë e pakundërshtueshme. Padyshim se në radhë të parë jemi përgjegjës për veten tonë. Më pas vijnë pjesëtarët e familjes sonë. Pas kësaj, vjen umeti ynë dhe vlerat e tij, në mes të të cilit qëndrojmë si një pikë në qendër të rrethit. Ne jemi përgjegjës për çdo gjë të umetit tonë, që prej një fëmije që luan mbi tokën e tij, e deri tek një satelit që është vendosur në qiellin e tij. Kjo përqindje përgjegjësie, mund të jetë e ndryshme tek të gjithë.

Në fillim, kapaciteti i pretendimit tonë për besim, do të përcaktojë se për çfarë dhe sa përgjegjës do të jemi. Më pas, do të përcaktojmë fushën e llogarisë në bazë të mirësive që na ka falur Allahu i Madhëruar. Nuk duhet harruar se, edhe profesioni ynë do të ketë ndikimin e vet. Nuk mund të mendojmë se imami i një xhamie dhe myslimanët që falen në atë xhami, nuk do të llogariten në lidhje me cilësinë e namazit që falet në atë xhami. Duhet të llogaritim edhe cilësinë e namazit brenda xhamisë, por edhe mungesën e atyre që janë jashtë xhamisë dhe nuk marrin pjesë në namaz. Të falësh namaz në një xhami, do të thotë

të njihesh si frekuentuesi i asaj xhamie dhe të interesohesh me shtimin e numrit të atyre me të cilët do të ndahet ajo xhami. Një mysliman i ngarkuar me detyrën e imamit të xhamisë, ka përgjegjësi të shkallës së parë. Për rrjedhojë, edhe të gjithë ata që falin namaz në atë xhami, ndajnë midis vete përgjegjësinë në shkallët e tjera vijuese. Ndërkohë që ndjejmë diçka të bukur kur ndajmë sevapin e faljes së namazit me xhemat në një xhami, nuk mund të mos e ndjejmë edhe shqetësimin për ata të cilët janë të privuar me vite të tëra prej atyre sevapeve.

Një shembull tjetër, mund të jepet edhe në lidhje me Ramazanin dhe iftarin. Kur japim një iftar në Ramazan, si rezultat i kuptimit të gjendjes së të varfërve, padyshim se është e domosdoshme dhe e begatë të ndajmë edhe ushqime dhe sadaka. Mirëpo, kjo nuk është e mjaftueshme nga aspekti i përgjegjesisë. Nëse kuptimi i gjendjes së të varfërve prej iftarit të Ramazanit do të kishte një cilësi letrare, atëherë, si myslimanë kemi edhe përgjegjësinë e zhvillimit të projekteve për ta larguar plotësisht gjendjen e varfërisë prej umetit islam. Po, ne nuk mund të presim që çdo mysliman të zhvillojë një projekt të tillë dhe ta praktikojë. Duke filluar që prej atyre të cilët merren me politikë, liderët e shoqërive civile Islame, shkrimtarët, dijetarët, të pasurit, autoritetet dhe ata që kanë parë qoftë edhe një mirësi prej mirësive të Allahut, janë të detyruar të mendojnë se sa përqindje përgjegjësie kanë dhe të bëjnë atë që duhet bërë.


Kjo, do të thotë të jesh umet. Për këtë jemi umet.

Ashtu siç qëndrojmë në saf gjatë namazit, jemi të detyruar që edhe jetën ta jetojmë me rregullin e safit. Nuk mund të mjaftohemi me sadaka që do të justifikojnë përgjegjësinë tonë. Nuk mund të rrimë duke dhënë sadaka në vend që të gjejmë zgjidhje dhe të zhvillojmë projekte për të larguar varfërinë. Asnjë meny iftari, sado pjesëmarrës të ketë, nuk mund të ndikojë dhe të përhapet më tepër se sa një projekt që do të zhdukë urinë dhe mjerimin e umetit.

Këtë thotë e vërteta. Gjendja e umetit na e kujton këtë përgjegjësi që prej shumë vitesh, madje që prej shekujsh.

Ne mund të jemi një person i një umetit të madh dhe pjesa jonë mund të jetë një në një miliardë. Por sado i madh të jetë numri, përsëri emri ynë gjendet në listën e përgjegjësve.





Lajmi më i RËNDËSISHËM

Xhafer Durmush

Në fjalor fjala “lajm” do të thotë: “Informacion që përçohet në mendjen e njeriut nga jashtë. Ndodhi e re, fjalë e përçarur gojë më gojë”.

Këtu do të trajtojmë dy ajete fisnike prej Kuranit si burimi i dijes, të cilat janë shembull në lidhje me lajmet për të shkuarën dhe të ardhmen. I pari prej këtyre ajeteve ndodhet në suren Nisa, ku urdhërohet:

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!” (Nisa, 69)

Këtu duhet të tërheqim vëmendjen se në mënyrë të veçantë, ky ajet fisnik ka sjellë një lajm që i intereson gjithsecilit. Kjo, sepse për ata që bëjnë një jetë brenda kornizës së bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), duke e peshuar çdo punë dhe çdo orientim të tyre në “peshoren e kënaqësisë hyjnore”, në këtë ajet jepet myzhdeja se Allahu do t’u japë mirësi në Xhenet dhe se do të jenë së bashku me profetët, të sinqertët, dëshmorët dhe njerëzit e drejtë. Ata që ndjekin moralin e Profetit (a.s.) dhe robërve të devotshëm të Allahut, duke ecur në gjurmët e tyre, në botën tjetër do të jenë bashkë me ata të cilët i kanë marrë si shembull. Kjo ka vetëm një kusht gjithëpërfshirës, që është: “Bindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.)”

Me të vërtetë që ky ajet, është një myzhde e madhe që u jep shpresë zemrave të besimtarëve. Është një

synim i lartë që nuk mund të krahasohet me asnjë vlerë të kësaj bote dhe një fitim i përjetshëm për të cilin ia vlen të durosh të gjitha vështirësitë. Ky ajet është me kuptim të gjerë dhe gjithëpërfshirës, sepse ai nënkupton se, “çdo besimtar i devotshëm është prej familjes së Muhamedit (a.s.)”. Dhe, të gjithë kanë mundësi të barabarta për të arritur ose për t’i humbur plotësisht këto pozita të larta që lajmërohen në ajet...

Ajeti i dytë për të cilin folëm më sipër, ndodhet në suren Al-i Imran, ku urdhërohet: **“Vërtet, ata që e shkëmbejnë premtimin dhe betimin e tyre ndaj Allahut me një vlerë të vogël, nuk do të kenë asnjë të mirë në jetën e ardhshme. Allahu nuk do t’u flasë atyre, as nuk do t’i shikojë në Ditën e Kiametit dhe as nuk do t’i pastrojë prej gjynaheve...”** (Al-i Imran, 77)

Domethënë se ata që e shesin për pak gjë premtimin që i kemi dhënë Allahut në botën e shpirttrave dhe që këmbëngulin në mohim dhe gjynahe, në Ditën e Gjykimit, Allahu nuk do të interesohet fare për ta, nuk do t’i pastrojë nga gjynahet dhe nuk do t’i shohë fytyrat e tyre me mëshirë.

Po ashtu, edhe ky ajet fisnik, duhet të shihet si një lajm që u intereson të gjithëve, në aspektin e meritimit të dënimit apo të shpëtitimit.

Tani, kur i mendojmë këto dy ajete të marra së bashku, kuptojmë se tabloja e së ardhmes që na shfaqet në Fjalën e Allahut, bëhet më e qartë. Nga një anë, ndërkohë që ata të cilët jetojnë brenda kornizës së bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.),

bashkohen me ata që Allahu u ka dhënë mirësi, nga ana tjetër, ata të cilët nuk i afrohen bindjes, do të bien larg mëshirës së Allahut sipas largësisë që kanë ata me Të.

Atëherë, ata të cilët kanë mendje dhe logjikë, duhet të përpiqen të arrijnë pozitat e larta për të cilat bëhet fjalë në ajetin e parë dhe të ruhen prej përfundimit të keq që përmendet në ajetin e dytë. Cilado prej pikave të mësipërme të bëhet, ajo do të ndodhë sipas zgjedhjes dhe përpjekjes personale.

Mendoni: Ndodheni në një mbledhje të rëndësishme midis njerëzve që do të marrin vendime të rëndësishme në një ditë historike. Kryetari i mbledhjes dhe i plotfuqishmi i atij vendi nuk merret fare me ju. Madje, juve ju deklarojnë person të padëshiruar...

Asnjë njeri që zotëron cilësinë e dallimit të së mirës nga e keqja, nuk mund ta pranojë diçka të tillë, qoftë edhe në çështjet e kësaj bote. Pra, si mund ta pranojë ai një rrezik të tillë që do të bëhet shkak i humbjes së përjetshme? Cila pozitë apo cili përfitim mund ta çojë atë në një zgjedhje të tillë? Ose mund të pyesim edhe kështu: A mund të krahasohet lumturia e paqes që na jepet në tablonë e ajetit të parë me dënimin dhe poshtërimin që përshkruhet në ajetin e dytë?

Përfshirja e shembujve mësimdhënës prej popujve të shkuar midis lajmeve në Kuranin Fisnik, është për të treguar se nevojat themelore nuk ndryshojnë me kalimin e kohës dhe se dobësitë dhe dëshirat janë po të njëjtat. Nisur nga kjo, njeriu duhet ta ketë gjithmonë parasysh fundin e hidhur të humbësve dhe shpërblimin që do të marrin të mirët, duke u përpjekur ta rregullojë jetën e tij.

Fakti se këto lajme janë në lidhje me ngjarjet që do të ndodhin në të ardhmen, i ruajnë ato gjithmonë aktuale e të freskëta për të na tërhequr vëmendjen, gjë e cila kërkon një vëmendje edhe më të veçantë. Kjo, sepse ende nuk është paraqitur mundësia për t'u përpjekur në arritjen e rezultatit të dëshiruar dhe ato që mund të bëhen për t'u ruajtur prej rreziqeve të atyre që do të ndodhin patjetër, ende nuk janë konsumuar. Mund të thuhet se të gjitha lajmet në Kuran janë tabela paralajmërimi, që këshillojnë vlerësimin e çdo çasti në mënyrën më të mirë për t'u përgatitur për të ardhmen, duke pasur parasysh të shkuarën.

Nisur nga kjo, ajetet që kanë të bëjnë me temën tonë, na njoftojnë për lajmet më të rëndësishme që janë duke u afruar, duke i kujtuar njeriut se do të përballet patjetër me njërën prej dy mundësive. Qëllimi ynë është që në këtë kohë, kur radhitja e rëndësisë së gjërave në mendjen tonë është çorientuar, të rikujtojmë se edhe fitimi, edhe humbja janë të pakthyeshme.


Ç'DO TË THOTË "JEUMU'D-DIN / DITA E GJYKIMIT"?

Pyetjen e titullit të shkrimit, e bën Allahu i Madhëruar: **"E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Dita e Gjykimit? Edhe njëherë: Kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Dita e Gjykimit?"** (Infitar, 17-18) Ndërsa në ajetin tjetër në vijim, Allahu i Madhëruar, urdhëron: **"Ajo është Dita, kur askush nuk do të ketë fuqi për të bërë gjë për ndonjë tjetër dhe, kur pushteti do të jetë vetëm i Allahut."** (Infitar, 19) Këtu, njoftohemi se "Jeumu'd-Din", është dita e shpërblimeve për çdo gjë që është bërë në këtë botë.

Mund të themi se Allahu i Madhëruar dëshiron që të mos harrohet fakti se çdo gjë regjistrohet dhe për çdo gjë që veprohet, e mirë apo e keqe qoftë, do të jepet llogari. Allahu na e kujton në mënyrë të përsëritur se, në Ditën e Gjykimit, të mirët do të hyjnë në mirësitë e Xhenetit, ndërsa të këqijtë do të dënohen me zjarrin e Xhehenemit.

Do të vijë një ditë, kur nuk do të bëjë dobi as pasuria dhe as fëmijët. Njeriu do të ketë dobi vetëm prej besimit dhe veprave të sinqerta. Dhe atë ditë, nuk do të flasë dhe nuk do të ndërmjetësojë askush përveç atyre që u jep leje Allahu. Zoti ynë, dëshiron që çdo moment i jetës të jetohej me këtë vetëdije. Ashtu siç theksohet edhe në komentimin e Kuranit, "të vërtetat që njohin dijetarët, njerëzit e thjeshtë do t'i mësojnë vetëm Ditën e Gjykimit".

Për të qenë prej atyre që kur t'u jepet libri nga e djathta në atë ditë të madhe, do të thonë: **"Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari."** (Hakka, 19), duhet t'i mbajmë të gjalla në mendjen tonë pyetjet që na janë vënë përpara në ajetet fisnike. Në fakt, falënderimi që bëjmë ndaj **"Sundesit të Ditës së Gjykimit"**, dyzetë herë në ditë në sajë të sures Fatiha, duhet të konsiderohet një mirësi e madhe prej Allahut të Madhëruar.



Konfliktualiteti

një rrugë e panevojshme

— Nuredin Nazarko —

Nga vetë natyrshmëria e rendit natyror të gjërave, qeniet njerëzore, edhe pse janë pjesë e të njëjtit lloj, nuk mund të jenë të njëjta përsa i përket, përjetimeve, ndjesive, perceptimeve, analizave, gjykimeve dhe konkludimeve mbi realitetin që i rrethon. Kjo ndryshueshmëri është esenciale për t'i mundësuar njeriut, pranimin e kufizueshmërisë së tij nga njëra anë, si dhe kushtëzimin e bashkëpunimit me të tjerë syresh të llojit të vet. Pa qenë kaq të ndryshëm nga njëri - tjetri, nuk do ta kishim të mundur të krijojmë lidhje e raporte me shokë dhe miq. Pa qenë kaq të ndryshëm nga njëri - tjetri, nuk do të kishim mundësi të realizonim vetveten, nuk do të kishim mundësi të tregojmë vlerat apo antivlerat që jetojnë apo nuk jetojnë brenda nesh, apo që përpëliten për të jetuar brenda nesh. Pa qenë kaq të ndryshëm, nuk do ta ndienim nevojën për të jetuar në shoqëri apo në bashkësi, nuk do ta ndienim nevojën për të bashkëpunuar për të mira dhe për të bashkëpunuar për të goditur dhe shmangur të keqen që endet brenda nesh, si premisë bazike për të goditur edhe të keqen jashtë nesh.

Meqenëse ndryshueshmëria ndërmjet qenieve njerëzore qenka thellësisht natyrore dhe prej këndeje e pazhbëshme, kjo do të thotë se përsa të ketë jetë mbi sipërfaqen e tokës, nuk do të ketë as unanimitet

mendimesh. Ky është realiteti dhe ky realitet gjen zbatim edhe brenda atyre që zgjedhin të kenë të njëjtën përkatësi. Të zgjedhësh të jetosh nën hijen e parimeve të epërme, duke braktisur nxehtësinë përcëlluese të dyerve të hapura ndaj vërshimit të dëshirave, është çështje personale, por në çastin kur edhe të tjerë zgjedhin të bëjnë të njëjtën zgjedhje, atëherë lind si domosdoshmëri bashkëpunimi dhe bashkëveprimi mes pjesëtarëve të së njëjtës përkatësi, për të realizuar të njëjtin qëllim, mbizotërimin e së mirës ndaj së keqes.

Kundërvënia midis së mirës dhe së keqes do të jetë vazhdimisht prezente në këtë botë, sepse pa këtë kundërvënie nuk realizohet as domosdoshmëria e bashkëpunimit. Në qoftë se bashkëpunimi dhe bashkëveprimi për të qenë në anën e së mirës është domosdoshmëri, atëherë ecja në çdo rrugë që çon drejt realizimit të bashkëpunimit kthehet në domosdoshmëri.

Në qoftë se bashkëpunimi dhe bashkëveprimi për të qenë në anën e së mirës është domosdoshmëri, atëherë edhe largimi nga çdo



rrugë që çon në minimin e bashkëpunimit kthehet në domosdoshmëri. Kjo duhet mbajtur mirë parasysh në çdo lloj gjendje që të ndodhemi, sepse sikundër e thamë ndryshueshmëria në mendime është diçka krejt e zakonshme. Të mendosh ndryshe, të kesh një vizion ndryshe nga dikush që ndan të njëjtën përkatësi me ty, nuk nënkupton që palët t'i kundërvihen njëra-tjetrës me pretendimin se ky apo ai nuk ndan të njëjtat mendime me mua, nuk vepron në të njëjtën mënyrë me mua dhe si rrjedhim konkludojmë se bashkëpunimi duhet zbehur në rastin më të mirë, e në rastin më të keq bashkëpunimi duhet minuar.

Por pse mbërrijmë deri në këtë konkludim, që realisht është thyerje e domosdoshmërisë së bashkëpunimit? Përfundimi në të tilla rrugina, që na largojnë paqshëm nga domosdoshmëria e bashkëpunimit, është rrjedhojë e bindjes që ndërton njeriu brenda vetes se është i vetmi, ai apo grupimi i tij, që ka kuptuar domethënien reale të parimeve të epërme, ndërsa kuptimi i të tjerëve jashtë tij apo grupit të tij është i mangët, i deformuar dhe në rastin më të keq i devijuar. Duke i besuar për të vërteta kësilloj konkludimesh, edhe të vepruarit më pas i nënshtrohet asaj çfarë beson njeriu për të vërtetë.

Si rrjedhim, akuzohet e sulmohet çdokush tjetër që nuk mendon e vepron sipas atyre që besojnë se kuptimi i njëmendtë i parimeve të epërme është ekskluzivitet i tyre. Vetë parimet, kuptimësinë e tyre të thellë nuk e kanë mbyllur brenda ekskluzivitetit të një grupi të caktuar, madje prej thellësisë së kuptimësisë së tyre do të vazhdojnë të nxirren perla, prej gjithëkujt që zhytet në thellësinë e tyre, me sinqeritet, vullnet e dashuri të pastër e të pandotur.

Vetëm duke iu përmbajtur, sinqeritetit, vullnetit dhe dashurisë së pastër ndaj parimeve të epërme, do të ndërtojmë atë çfarë duhet ndërtuar dhe jo thjesht godina ku secili i gëzohet grupi-

mit të vet, do të ndërtojmë godinën e bashkëpunimit ndërmjet njëri – tjetrit duke pastruar zemrat nga rivaliteti egocentrik, përderisa ajo që na bashkon është shumë më madhore se ajo çfarë mund të na ndajë. Por që të mbërrijmë në këtë pikë duhet të tejkalojmë egocentrizmin dhe egocentrizmi nuk mund të tejkalohet vetëm se me dashuri të thellë për të vërtetën dhe zemërgjerësi për njëri – tjetrin. Nuk tejkalohet egocentrizmi me dashuri të përciptë për të vërtetën e as me zemërngushtësi për njëri – tjetrin.

Pavarësisht se gjërat janë të qarta si qelibar, realiteti është kokëfortë dhe, edhe pse nuk duam që çështjet të jenë kështu siç janë në sferën e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit për mbizotërim të së mirës, hendeku që duhet kapërcyer në këtë drejtim është i madh, por ky kapërcim nuk mund të bëhet nëpërmjet katapultave, por vetëm duke e mbushur këtë hendek me dashuri.

Konfliktualiteti që nxitet nga kjo ndryshueshmëri kuptimesh dhe perceptimesh mes atyre që ndajnë të njëjtën përkatësi, nuk i shërben aspak qëllimit fisnik dhe madhor, që në mënyrë paradoksale, përdoret për të justifikuar pikërisht këtë konfliktualitet. Situatat konfliktuale nuk mund t'i shërbejnë kurrësesi mbizotërimit të së mirës, përkundrazi energjia e së mirës do të shterëj në debate dhe veprime shterpë, duke i dhënë mundësi së keqes të zaptojë me metastazat e saj hendekët mes grupimeve të krijuara për shkak të konfliktualitetit të panevojshëm midis tyre. Kjo do ta vështirësonte gjendjen, por jo se gjendja do të ishte e pashpresë dhe pa rrugëdalje, sepse triumfi i së mirës nuk është i lidhur me suksesin apo dështimin e njeriut në realizimin apo mosrealizimin e saj.

Në qoftë se një brez nuk e meriton triumfin e së mirës, as e mira vetë nuk dëshiron të realizohet nga ata që nuk e meritojnë. E megjithatë ne na takon të realizojmë detyrën tonë, duke bashkuar fuqitë me të gjithë ata që duan që e mira të mbizotërojë, që nesër të mos qajmë si gratë për atë që nuk e realizuam si burrat, në hapësirën kohore që na u dha.



Ibrahimi (a.s.) dhe Bejtullahu

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa urdhërimi, të cilat ai i plotësoi, Allahu i tha: “Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!” - “Po pasardhësit e mi?” - pyeti ai. Allahu tha: “Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët.

Kujtoni kur Ne e bëmë Qabenë vendgrumbullimi dhe sigurie për njerëzit, duke thënë “Bëjeni vendin e Ibrahimit si vend-faljeje!” Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: “Pastrojani Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrinë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përlulur”.

Kur Ibrahim u lut: “Zoti Im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoji me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në jetën tjetër!” - Allahu tha: “Atë që nuk beson, për pak kohë do ta bëj që të kënaqet e pastaj do ta hedh në dënimin e zjarrit.” Eh, sa vendbanim i keq që është ai!

Kur Ibrahim dhe Ismaili ngritën themelet e Qabes, u lutën: “O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka! O Zoti ynë! Na bëj të përlulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlulur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!

O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t’u lexojë shpalljet e Tua, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë (rregullat e fesë) e t’i pastrojë (nga gjynahet)! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti!” Fesë së Ibrahimit i shmanget vetëm ai që e nënçmon vetveten. Ne e zgjodhëm atë në këtë botë, kurse në botën tjetër ai do të jetë ndër të mirët. Kur

Zoti i tij i tha: “Përlulu!” - ai u përgjigj: “Ju përlula Zotit të gjithësisë!” (Bekare, 124-131)

Allahu i Madhëruar i shpalli Ibrahimit dhe i tha: **“Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!”** Pra, “në sajë të këtyre virtyteve që ke, do të të marrin për prijës dhe njerëzit e mirë do të ndjekin!” Për rrjedhojë, Ibrahim (a.s.), jo vetëm që ishte profeti i kohës së vet, por është edhe prijësi/imami i të gjithë njerëzve deri në Ditën e Kiametit. Këtë premtim që Allahu i Madhëruar e ka shprehur në këto ajete fisnike, e ka çuar në vend duke e urdhëruar edhe Profetin tonë (a.s.): **“...Paso me sinqeritet fenë e Ibrahimit, që nuk ka qenë prej idhujtarëve”.**

(Nahl, 123) Për këtë arsye, të gjithë ndjekësit e feve hyjnore, e njohin Ibrahimin (a.s.), si profet të madh.

Ndërsa ata që e njohin ashtu siç duhet dhe e ndjekin me sinqeritet, janë pjesëtarët e umetit të Muhamedit (a.s.), të cilët në fund të çdo namazi që falin, thonë:


“O Allahu im, bekoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e bekoje Ibrahimin dhe familjen e tij, Ti je i Falënderuar dhe i Lartësuar”

Sipas një transmetimi, një natë, Ibrahim (a.s.), pa në ëndërr një kopsht. Në gjethet e pemëve të atij kopshti, ishte shkruar:

La ilahe il-lallah Muhamedun resulallah

Kur e pyeti Xhebrailin (a.s.), se çfarë ishte kjo, ai i tregoi në lidhje me Muhamedin (a.s.). Pas kësaj, Ibrahim (a.s.), bëri këtë dua:

“O Allah! Vendose përkujtimin ndaj meje në gjuhën e umetit të Muhamedit (a.s.)”. Duaja e tij u pranua dhe për rrjedhojë, emri i tij përkujtohet në çdo namaz pas tahijjattit gjatë salavateve së bashku me emrin e Profetit tonë (a.s.).



Dhikri në ajete dhe hadithe

Ajetet fisnike, që na njoftojnë për rëndësinë e dhikrit (përmendjes së Allahut):

“Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t’ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke M’u bindur) e mos i mohoni dhuntitë e Mia (me mosbindje!)” (Bekare, 152)

“...Përmende shumë Zotin tënd dhe adhuroje Atë në mbrëmje dhe në mëngjes.” (Ali Imran, 41)

“...Ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë...” (Ali Imran, 191)

“Përmende Zotin tënd me vete, i përulur dhe me frikë – jo me zë të lartë, në mëngjes dhe mbrëmje, dhe mos u bëj nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje!” (A’raf, 205)

“O besimtarë, kur të ndesheni me ndonjë forcë armike, qëndroni të patundur dhe përmendni shumë Allahun që të fitoni.” (Enfal, 45)

“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Ra’d, 28)

“...Fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe!..” (An-kebut, 45)

“O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!” (Ahzab, 41-42)

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.” (Munafikun, 9)

“Prandaj, përmende emrin e Zotit tënd dhe për-kushtoj krejtësisht Atij!” (Muzzemmil, 8)

“I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!” (A’la, 14-15)

Hadithet kudsi:

“O biri Ademit! Më përmend me gjuhë, që Unë të të përmend me kënaqësinë Time.”

“Më përmend në zemrën tënde, që Unë të të përmend në takimin Tim. Më përmend me përulje, që Unë të të përmend duke të ngritur.”

“O biri Ademit! Me përmendjen Time, do të arrish mirësi të shumta, do të gëzohesh me Mua dhe do të rehatohet shpirti.”

“O biri Ademit! Kush më do dhe më kërkon, më gjen. Kush më gjen, më shërben Mua. Kush më shërben, më përmend Mua. Dhe kush më përmend Mua, unë e përmend atë dhe bëhem i dashuri i tij.”

Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Kush e do përmendjen e Allahut, edhe Allahu e do atë.”

“Shejtani largohet prej zemrës së atij që përmend Allahun dhe hyn në zemrën e atij që nuk e përmend.”

“Nuk ka asnjë adhurim më të madh se përmendja e Allahut.”

“Kush e fal namazin e sahabut me xhemat, bën dhikër derisa të lindë dielli dhe më pas fal dy rekat namaz, ai shpërblehet me sevapin e një haxhi.”

“Kush përmend Allahun midis indiferentëve, është si ai që lufton me heroizëm midis atyre që ikin nga lufta.”

Një ndodhi mësimdhënëse:

Një ditë, Ebu Hurejre (r.a.), hyri në treg dhe tha:

“Juve po ju shoh këtu! Por trashëgimia e Profetit po ndahet në xhami.” Për këtë arsye, populli e la punën në treg dhe vrapoi për në xhami. Mirëpo, kur njerëzit nuk panë gjë aty, i thanë Ebu Hurejres (r.a.):

“Ne nuk pamë të ndahet asgjë në xhami.” Ndërsa Ebu Hurejre (r.a.), u tha:

“Çfarë patë?”

“Pamë vetëm një grup që po përmendte Allahun!”

Ebu Hurejre (r.a.), vazhdoi:

“Ja pra, ajo është trashëgimia e Profetit!”





“Vërtet, djalli me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit.”

(Maide, 91)

Njeriu i ditëve tona, ka mbetur larg Zotit të vet me mëshirë dhe butësi të pafundme dhe po bën një jetë të çuditshme, fundi i së cilës nuk dihet se kur do të jetë. Ai e ka humbur dëshirën për jetën pas vdekjes dhe ndjenjën për pafundësi.

Ç’është gjithë kjo përpjekje në këtë jetë? A do të zhduket gjithçka që ka bërë njeriu në këtë botë? Për fat të keq, njeriu i sotëm nuk dëshiron t’ia bëjë vetes këto pyetje.

Cili është rezultati? Si përfundim, jeta e po e humb thellësinë dhe madhësinë e saj. Ajo nuk është më një luftë për virtyte, por po kthehet në një garë për të kënaqur ndjenjat djallëzore. Në këtë mënyrë, njeriu lodhet dhe bie i rraskapitur duke ardhur vërdallë në një rreth vicioz. Si përfundim, me anë të anti-depresantëve mundohet të shtypë llokoçitjet brenda vetes, ndërsa me anë të drogës dhe alkoolit përpiqet të mashtrojë veten. Përdorimi i lëndëve dehëse në të gjithë botën sa vjen e po shtohet. Këtu kanë filluar të përzihen edhe nxënësit e shkollave nëntëvjeçare.

Sot, në krahasim me të shkuarën, po kuptohet edhe më mirë roli i madh që ka kujdesi në çështjet që Islami i ka shpallur si të ndaluara për t’u mbrojtur nga dëmet e mëdha të këtyre elementeve negative. Në këtë aspekt, ndalesa ndaj pijeve alkoolike dhe lëndëve të tjera dehëse brenda këtij kuadri, përbën shembullin më të mirë në këtë çështje.


Tashmë, në ditët tona, përfshi edhe ata që janë të varur, askush nuk mund t’i mohojë dëmet serioze që shkaktojnë lëndët dehëse për familjen, shoqërinë dhe shëndetin e njeriut. Në ditët tona po e kuptojmë edhe më mirë hadithin që Profeti ynë (a.s.), e ka thënë para katërmbëdhjetë shekujsh: “Pija (alkoolike) është nëna e të gjitha të këqijave!” (Nesai, Eshribe 44.) Po ashtu, në ajetin 91 të sures Maide, bëhet e ditur se pija (alkoolike) shton urrejtjen dhe armiqësinë midis njerëzve dhe pengon nga namazi dhe përkujtimi i Allahut. Të gjitha këto po i kuptojmë edhe më mirë në kohën tonë.

Në bazë të një studimi të kryer nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, ku kanë marrë pjesë 30 shtete, ka dalë se në 85% të vrasjeve, 50% të përdhunimeve, 50% të rasteve të dhunës, 60% të aksidenteve rrugore dhe 70% të rasteve të dhunës ndaj grave, shkaktori kryesor ka qenë elementi i alkoolit. Çdo vit, rreth dy milion e gjysmë njerëz humbasin jetën për shkaqe të lidhura me alkoolin. Alkooli është shkaktori i tretë themelor i vrasjeve dhe plagosjeve në të gjithë botën, të cilat mund të parandalohen. Dëmet materiale që shkaktohen prej alkoolit, janë më tepër se të ardhurat që vijnë prej tij. Gjithashtu, mossuksesi në arsim, prirjet kriminale dhe problemet shëndetësore të lidhura me alkoolin por rriten në mënyrë paralele me përdorimin e alkoolit.

Dijetarët Islamë i kanë analizuar hadithet e Profetit (a.s.) dhe kanë dalë në përfundimin se Islami synon të mbrojë pesë vlera themelore, të cilat janë: Feja, pasuria, jeta, mendja dhe nderi. Sigurimi i lumturisë në këtë botë dhe në tjetrën, varet nga mbrojtja e pasurisë materiale dhe shpirtërore të njeriut. Po ashtu, edhe për sigurinë e paqes dhe qetësisë sociale, mbrojtja e këtyre vlerave themelore është shumë e rëndësishme. Nëse e analizojmë ndalesën e alkoolit nga aspekti i këtyre vlerave themelore, është e mundur të bëjmë këto evidentime:

Nëse njeriu humbet mendjen, humbet edhe shëndetin. Mirëpo, Islami nuk e lejon përçmimin e njeriut dhe talljen me nderin e tij. Për rrjedhojë, kuptohet se kjo është edhe një nga urtësitë e ndalesës së alkoolit, sepse në rast të përdorimit të alkoolit ose të drogës, mendja dhe vullneti i njeriut dobësohen deri në maksimum. Në këtë mënyrë, njeriu bie në atë gjendje sa të përçmohet nga njerëzit që e rrethojnë. Ja pra, mund të themi se kjo është edhe urtësia kryesore që qëndron pas ndalimit të lëndëve dehëse.

Nga ana tjetër, vazhdimi në mënyrë të rregullt i jetës fetare të njeriut, varet nga gjendja e tij shëndetësore. Përndryshe, përgjegjësitë e tij fetare dhe



shoqërore do të pësojnë mangësi serioze. Prandaj, ruajtja prej varësisë ndaj alkoolit dhe drogës është shumë e rëndësishme, sepse këto lloj varësish shkaktojnë një sërë sëmundjesh trupore dhe psikologjike. Shkurtimisht, ndalimi i lëndëve dehëse, përfshin urtësinë e ruajtjes së shëndetit të njeriut, e për rrjedhojë edhe të jetës së fetare e shoqërore.

Një çështje tjetër është edhe ndalimi i lëndëve dehëse në mënyrë të qartë me anë të ajeteve dhe haditheve. Ky është besimi absolut i myslimanëve. Për rrjedhojë, nëse një mysliman është i dhënë pas pijeve alkoolike, kjo bëhet shkak që ai të veprojë me moskokëçarje edhe ndaj urdhrave të tjera hyjnore. E thënë ndryshe, ndjenja e devotshmërisë së këtij robi merr plagë të rënda, sepse ai fillon të neglizhohet edhe adhurimet e tjera, si namazin, haxhin etj. Pra, shkelja e kësaj ndalesë e pengon jetën fetare në drejtime të ndryshme.

Gjithashtu, personat që janë të varur nga droga, për shkak se humbasin ekuilibrin e mendjes dhe të vullnetit, ata e humbin forcën rezistuese ndaj haramëve dhe bien shumë lehtë në veset negative si amoraliteti, kumari etj. Kjo tregon se përdorimi i alkoolit dhe drogave nuk duhet konsideruar vetëm si shkelje e një prej ndalesave të Allahut, sepse shkelja e kësaj ndalesë nxjerr jetën fetare nga shinat dhe bëhet shkak i veprimt të shumë haramëve të tjera. Po ashtu, ajo bëhet shkak i neglizhencës së shumë detyrave fetare dhe shoqërore, që prej adhurimeve e moralit, e deri tek përgjegjësitë familjare e shoqërore.

Nga një aspekt tjetër, varësia ndaj drogës, është një nga shkaqet më kryesore që shkaktojnë qetësinë në familje, sepse në familjet ku përdorimi i alkoolit dhe drogës është i zakonshëm, edhe dhuna në familje është më e madhe. Jeta për pjesëtarët e tjerë

të familjes bëhet e padurueshme dhe kthehet në një lëmsh vuajtjesh. Struktura psikologjike e bashkëshortëve dhe fëmijëve çrregullohet dhe ardhmëria e tyre nxihet. Pra, familja e cila duhet të jetë një fole mëshire, për shkak të varësisë ndaj drogës, kthehet në një fole vuajtjesh.

Të rinjtë e varur nga droga që shohim përditë rrugëve, na drithërojnë zemrat. Këta janë njerëz që kanë humbur familjen, respektin dhe ç'është më e rëndësishmja, ata kanë humbur shpresën. Për rrjedhojë, ata mund të bëhen shkak i çdo lloj të keqeje dhe problemi. Nëse analizohet e shkuara e këtyre të rinjve, vihet re se në të shumtën e rasteve këta vijnë prej familjeve që përdorin shumë alkoolin dhe drogën. E për fat të keq, këta kanë marrë një trashëgimi të keqe prej familjeve të tyre.

Lidhja me gjithë shpirt pas urdhrave hyjnore, është metoda më e mirë në mbrojtjen ndaj varësisë së drogës. Po ashtu, Islami ofron një sistem të mrekullueshëm vlerash edhe për ata që duan të kurohen prej këtyre sëmundjeve dhe t'i kthehen përsëri jetës normale. Mjafton që njeriu të hyjë në sarajin e paqes dhe haresë së Islamit me një pendesë/teube të sinqertë.

Islami ofron mënyrën për t'u kapur pas jetës, e madje edhe për t'u përpjekur me gjithë shpirt për të arritur mirësi të pafundme në këtë jetë. Para së gjithash, Islami e thërret njeriun të njohë Zotin e vet dhe të lidhet pas Tij. Ky është një sihariq i pashoq që Islami mund t'i japë njeriut, sepse dera e të gjitha mirësive hapet vetëm me besimin dhe lidhjen pas Allahut. Po ashtu, edhe të gjitha shpresat fillojnë duke iu dorëzuar me gjithë shpirt Allahut të Madhëruar, i Cili është mëshirues i pakufishëm.



Profeti (a.s.), ka thënë:

“Prindërit janë një nga dyert më madhështore që bëhen shkak për hyrjen e njeriut në xhenet. Në daç lëre, në daç mbaje atë derë!”

(Tirmidhi, Birr, 3)

Nëna dhe babai... Dy njerëz të mrekullueshëm që janë bërë shkak i ardhjes sonë në këtë botë... Prindërit që kanë bashkuar jetët e tyre dhe kanë formuar një fole familjare që prej kohës së Ademit (a.s.) dhe Havasë, e kanë konsideruar si një përgjegjësi ndaj Zotit të tyre rritjen dhe edukimin e brezave të rinj në ngrohtësinë e familjes. Ata përballojnë çdo vështirësi dhe marrin parasysh çdo sakrificë për të edukuar në përputhje me kënaqësinë e Allahut vogëlushët e tyre që u janë lënë amanet prej Tij. Ata lumturohen me lumturinë e fëmijëve të tyre dhe hidhërohen me hidhërimin e tyre. Nëna dhe babai të cilët janë pranë fëmijëve sa herë që ata kanë nevojë, vjen një ditë, kur plaken dhe kanë nevojë për kujdesje dhe interes. Për rrjedhojë, ata presin që fëmijët e tyre, tashmë të rritur e të zotë për veten, të jenë pranë tyre. Në këtë periudhë, ata kanë nevojë më shumë se kurrë për buzëqeshjen dhe mirëkuptimin e fëmijëve të tyre.

Kur vitet rrjedhin dhe vjen pleqëria, periudha e pashmangshme dhe më e dobët e jetës, shtohet edhe rëndësia e marrëdhënieve tona me prindërit tanë. Një ditë, kur Profeti ynë i dashur (a.s.), ndodhej së bashku me sahabët e tij në një vend, thotë: “*U zvarrittë me hundë përdhe! U zvarrittë me hundë përdhe! U zvarrittë me hundë përdhe!*” Sahabët, të cilët u bën kureshtarë të dinë se kush është ky person për të cilin Profeti (a.s.), po flet me mospëlqim, pyetën: “Kush o i Dërguar i Allahut?” Pas kësaj, Profeti (a.s.), përgjigjet: “*Ai që nuk hyn në xhenet kur njëri, ose të dy prindërit e tij plaken pranë tij!*” (Muslim, Birr, 9.)

Në fakt, kjo shprehje drithëruese e mbushur me qortim, në të njëjtën kohë është një vërejtje e rëndësishme që na kujton përgjegjësinë tonë ndaj prindërve, të cilën askush prej nesh nuk duhet ta lërë pas dore. Kjo, sepse kënaqësia e Zotit tonë, është e lidhur me kënaqësinë e prindërve tanë, ndërsa zemërimi i Tij, është i lidhur me zemërimin e tyre.¹ Gjithashtu, në një hadith tjetër ku tregohet se mirësia ndaj prindër-

ve është një nga mënyrat më të lehta që mund ta çojnë njeriun në xhenet, Profeti ynë (a.s.), thotë: “*Prindërit janë një nga dyert më madhështore që bëhen shkak për hyrjen e njeriut në xhenet. Në daç lëre, në daç mbaje atë derë!*” (Tirmidhi, Birr, 3.). Pra, edhe vlerësimi, edhe humbja e kësaj mundësie, është në dorë të njeriut.

Zoti ynë, i Cili prej nesh kërkon vetëm ta adhurojmë Atë, na urdhëron në mënyrë të prerë që të sillem mirë me prindërit tanë: “**Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë pranë teje, mos u thuaj atyre as “of!”, e mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti. Lësho para tyre krahet e përujles prej mëshirës dhe thuaj: «O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!»**” (Isra, 23-24.)

Tek Allahu, mirësia ndaj prindërve është një sjellje që ka vlerën e namazit të falur në kohën e vet.² Ndërsa pabindshmëria ndaj prindërve dhe keqtrajtimi i tyre, është një gjynah po aq i madh sa edhe shirku ndaj Allahut.³

Në periudhën e pleqërisë së prindërve, kur përgjegjësitë kthehen në të kundërtën, neglizhenca e fëmijëve ndaj prindërve dhe keqtrajtimi ndaj tyre, nuk është e pëlqyeshme për Allahun dhe të Dërguarin e tij (a.s.). Kjo, sepse prindërit, që janë edhe shembulli më i bukur i dashurisë pa kusht dhe sakrificës pa interes, kur rrisin fëmijët e tyre, qofshin këta të vetëdijshëm apo jo, i vënë gjoksin çdolloj vështirësie me të cilën përballen. Nuk ka asnjë vuajtje më të madhe se ajo që përjeton një nënë gjatë shtatzënisë dhe lindjes së fëmijës së saj⁴, asnjë mund më të madh se ai i një babai që punon natë e ditë për të siguruar jetën e familjes së vet duke e pritur shpërblimin ve-

2. shih. Buhari, Teuhid, 48.

3. shih. Buhari, Edeb, 6.

4. shih. Ahkaf, 15.

1. shih. Tirmidhi, Birr, 3.



tëm prej Allahut⁵ dhe asnjë përpjekje më të madhe se ajo që bën një njeri i cili lufton më të gjitha të këqijat dhe pengesat që mund t'i prishin qetësinë dhe paqen familjes së vet. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), shprehet se asnjë fëmijë nuk mund ta lajë borxhin që kanë ndaj prindërve të vet.⁶

Ndërkohë që në vegjëli as që mund ta imagjinojmë një jetë pa prindërit tanë, kur rritemi dhe kuptojmë se jemi të aftë të qëndrojmë në këmbët tona, ndonjëherë biem në gabimin e të menduarit se jemi të vetëmjaftueshëm. Në raste të tilla, njerëzit që neglizhojmë më tepër, janë prindërit tanë. Mirëpo, në çfarëdo moshe të jemi dhe sado që mund të kemi ndërtuar një fole të re familjare dhe të kemi marrë përsipër përgjegjësinë ndaj bashkëshortes dhe fëmijëve tanë, nuk ka asnjë shkak që mund të na detyrojë të neglizhojmë detyrat

ndaj prindërve tanë dhe t'i braktisim ata. Gjithashtu, sado të mira të jenë kushtet e azileve të pleqve, asnjë kujdestar nuk mund ta bëjë një prind të ndjejë interesin dhe ngrohtësinë që ai pret prej fëmijës së vet. Prindërit tanë presin vetëm diçka prej nesh në këtë jetë. Ajo, është që ne të bëhemi fëmijë të mirë për ta. Dhe koha më e përshtatshme për ta vërtetuar këtë, është periudha e pleqërisë kur ata kanë më shumë nevojë për dashuri, mëshirë dhe mirëkuptim.

Prindërit tanë kanë sakrifikuar dhe kanë përballuar vështirësi të shumta për lumturinë e fëmijëve të tyre që i ruanin si drita e syrit. Për këtë arsye, është e natyrshme që ata të meritojnë një buzëqeshje të ngrohtë, respekt, interesim dhe çdo gjë të mirë në kohën e vjeshtës të jetës së tyre. Ndërsa për fëmijët, kjo është koha më e çmuar për të përfituar prej lutjeve të prindërve, të cilat janë prej lutjeve që Allahu i Madhëruar nuk i kthen kurrë mbrapsht.

5. shih. Buhari, Iman, 41.

6. shih. Muslim, Itk, 25.



PERSONALITETI QË SIGURON SHPËTIMIN E PËRJETSHËM

PËR SHPËTIMIN E PËRJETSHËM

Allahu në ajetin: **“Besimtarët kanë shpëtuar”** të sures Muminun sqaron cilësinë kryesore të personit të shpëtuar.

Pra kushti i domosdoshëm i shpëtimit është besimi.

Shpëtimi nënkupton suksesin ndaj sprovave të kësaj bote.

Si ta arrijnë besimtarët shpëtimin?

Ajetet në vazhdim i japin përgjigje kësaj pyetjeje duke përcaktuar parimet e personalitetit të myslimanit.

NJË NAMAZ GJITHË PËRKUSHTIM

Në dhjetë ajetet e para të sures muminun, e cila jep sihariqin për shpëtimin e përhershëm të besimtarëve numërohen pesë cilësi. Këto pesë cilësi janë parime dhe kritere të pandashme nga personaliteti i myslimanit. Cilësia e parë është namazi i kryer me përkushtim e përlulësi.

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre.” (Muminun, 1-2)

Ata që përmes namazit fitojnë dashurinë e Allahut, mbrohen nga e keqja dhe imoraliteti, kryejnë namazin shpirtërisht dhe fizikisht. Ata që bien në sexhde dhe i përgjigjen përzemërsisht urdhrut të Allahut: **“Bëj sexhde dhe afrohu.”** (Alak, 19)

Këta janë ata që arrijnë të shpëtojnë përfundimisht...

Falja e namazit me përkushtim dhe harmoni me trupin dhe shpirtin është kusht i domosdoshëm për

shpëtimin e përlulshëm. Një besimtar duhet që patjetër të falë namazin dhe të qëndrojë para pranisë hyjnore ashtu siç i ka hije asaj.

Ashtu si abdesti është kusht i jashtëm për namazin edhe ndjeshmëria se gjatë namazit gjendesh në komunikim me Allahun është kusht i shpirtëror i namazit. Pejgamberi (a.s.), me këtë përkushtim, përlulësi dhe dashuri e kryente namazin e Tij.

Profeti (a.s.), thotë:

“Namazi është drita e syrit tim.” (Nesai, Isharetun-Nisa, 1)

Në kohën e Profetit (a.s.), një njeri erdhi në xhami dhe filloi të falë namazin nxitimthi. Kur e pa Pejgamberi (a.s.), i tha:

“Çohu dhe fale përlulësi, sepse nuk e ke kryer namazin!” Besimtari e përlulësi namazin, por Profeti përlulësi i tha:

“Kthehu dhe fal namazin, sepse ti nuk e ke falur atë.”

Të tretën herë njeriu i tha Profetit (a.s.), se nuk dinte të falej siç duhej. Profeti (a.s.), i mësoi atij namazin e vërlulësi. (Tirmidhi, Salat, 110)

Namazi nuk duhet kryer me nxitim, sepse Profeti (a.s.), në një hadith thotë:

“Hajdutëria më e keqe është hajdutëria e namazit.” (Muvatta, Kasrus-salat, 72)

Falja e namazit më vërlulësi se gjendesh para dëgjuesës hyjnore dhe plotësimi i kushteve të jashtme dhe të brendshme është parimi më i rëndësishëm individual dhe fetar i personalitetit të myslimanit.

Ndjenja e qëndrimit para Allahut e fton besimta-



rin të angazhohet në punë të mirë në çdo moment. Prandaj kushti i dytë i shpëtimit është:

VEPRA E DOBISHME

“Ata të cilët shmangen nga fjalët dhe veprat e kota.” (Muminun, 3)

Për myslimanin nuk ekziston koncepti i kohës së lirë. Ai çdo çast të jetës së tij, e cila është kapitali më i madh i njeriut në këtë botë, duhet të angazhohet me një punë të mirë. Besimtari duhet të përpiqet të shpëtojë nga humbja që përshkruan dekreti hyjnor:

“Pasha kohën, me të vërtetë, njeriu është në humbje.” (Asr, 1-2) Besimtari duhet të jetë vazhdimisht i angazhuar me punë të mira. Allahu kërkon që të mos ketë kohë bosh në jetën e besimtarit.

“Kur të mbarosh një punë menjëherë kalo në një punë tjetër dhe drejtoju Allahut.” (Inshirah,7) Sipas ajetit besimtari nuk duhet të kalojë asnjë moment pa kryer një vepër të mirë. Prandaj besimtari nuk duhet ta lejojë veten që t'i ikë asnjë moment pa vepra të mira dhe adhurim. Jeta është mirësia më e madhe përmes së cilës mund të fitojmë lumturinë e përvetshme dhe na është dhënë vetëm një herë, pa të drejtë kthimi.

Profeti (a.s.), i ka edukuar shokët e tij në mënyrën më të përsosur duke e lënë edukatën e tyre si trashëgim për ymetin e tij. Profeti (a.s.), një ditë, mbas namazit të sabahut u kthye nga shokët duke i pyetur:

A është kush agjërueshëm sot?

- O i Dërguari i Allahut! Mbrëmë nuk e bëra nijetin për të agjëruar sot, prandaj nuk jam agjërueshëm - përgjigj Umeri (r.a.).

Kurse Ebu Bekri (r.a.), tha:

- Unë e bëra nijet mbrëmë për të agjëruar dhe sot jam agjërueshëm.

Pyetja e lartpërmendur e Profetit (a.s.), ishte in-

dividuale. Ai pas kësaj filloi të bëjë disa pyetje që kishin lidhje me veprimtarinë shoqërore.

- A ka vizituar kush ndonjë të sëmurë sot?

- Ne ende nuk kemi dalë nga xhamia, o i Dërguari i Allahut si mund të kishim vizituar të sëmurë - tha Umeri (r.a.).

Kurse Ebu Bekri (r.a.), tha:

- Dëgjova se Abdurrahman ibn Auf ishte sëmurë dhe rrugës për në xhami i bëra një vizitë duke u lutur për shërimin e tij sa më të shpejtë.

Profeti (a.s.), vazhdoi me një pyetje tjetër:

- A ka ndihmuar kush prej jush ndonjë sot?

- Ne tani sapo falëm namazin dhe akoma nuk kemi dalë nga xhamia, o i Dërguari i Allahut.

Kurse Ebu Bekri tha:

- Në hyrje të xhamisë na doli një i vobekët, i cili kërkoi diçka për të ngrënë, unë ia mora djalit tim Abdurrahmanit buken që kishte në dorë dhe ia dhashë atij.

Mbas kësaj Profeti (a.s.), tha:

- Të përgëztoj me Xhenet ty, o Ebu Bekër!

Umeri (r.a.), mori frymë thellë dhe tha:

Ah Xhenet!

Profeti (a.s.), duke i fituar zemrën Umerit tha:

- Allahu e mëshiroftë Umerin, Allahu e mëshiroftë Umerin! Sa herë që dëshiron të bëjë një të mirë, gjithmonë ia kalon Ebu Bekri.” (Hejthemi, III, 163-164)

Nga ky hadith kuptojmë që dashuria e Pejgamberit (a.s.), për ymetin është aq e madhe, sa që ai nuk dëshiron që në ymetin e tij të ekzistojë shpërdorimi i kohës. Ai dëshiron që ymeti i tij në çdo moment të jetë në kërkim të dashurisë së Allahut. Besimtari duhet të jetë gjithmonë në gjendje ihsani.

Nëse njeriu nuk angazhohet me vepra dhe punë të dobishme, ai do të bjerë në vorbullën e veprave të padobishme dhe punëve të kota. Angazhimet e kota janë bërë sot pengesë e madhe për rininë, e cila është



zhytur në punë të cilat nuk japin dobi as për Dynjanë as për Ahiretin.

Profeti (a.s.), ka kërkuar mbrojtje nga Allahu edhe nga padobia e një mirësie të madhe, siç është dituria. Nëse njeriu kërkon vazhdimisht dhe me sinqeritet dashurinë e Allahut, atij do t'i hapen dyert e mirësisë dhe vështirësitë do t'i shndërrohen në lehtësime.

“Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi! Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi!” (Inshirah, 5-6)

Allahu kërkon prej nesh të jemi të dashur, të dhembshëm dhe të mirësjellshëm me të varfrit dhe jetimët. Nga kjo pikëpamje, një nga verprimtaritë e besimtarit gjatë jetës së tij duhet të jetë edhe ndihma ekonomike ndaj nevojtarëve.

BAMIRËSIA

Në suren Muminun pas kushtit të një namazi të mbushur me jetë dhe largimit prej punëve të kota kushti i tretë është:

“Të jesh aktiv në dhënien e zeqatit.” (Muminun, 4)

Ajeti kuranor thekson faktin se nuk mjafton thjesht të japësh zeqatin, por duhet të kërkos, të jesh i kujdesshëm, t'i japësh të drejtën e tij edhe të varfrit në mënyrën më të mirë. Me zeqatin, sadakanë dhe veprimtaritë e tjera bamirëse duhet të tregojmë kujdes, seriozitet, përkushtim po aq sa tregojmë kur kryejmë një punë tonën private.

Allahu në një ajet tjetër kuranor thotë:

“Lëmosha u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.” (Bekare, 273)

Allahu në këtë ajet kërkon prej nesh t'u bëjmë një skanim shpirtëror zemrave, në mënyrë që të arrijmë të dallojmë nevojtarët, të cilët për shkak të sedrës dhe krenarisë nuk e shfaqin nevojën dhe vështirësinë në të cilën ndodhen. Në fakt ata lënë një amantet për të pasurit. Ja si thuhet në ajetin vijues:

“Të caktohet një pjesë e pasurisë për lypësin dhe për nevojtarin.” (Mearixh, 24-25)

Sipas ajetit, të varfrit dhe nevojtarët janë ortakë në

pasurinë e të pasurve. Ortaku duhet të kryejë detyrën që i takon përballë ortakut. Plotësimi me përkushtim i kushteve të kësaj ortakërie është një nga kushtet për të arritur shpëtimin e përhershëm. Ndërsa përm-bushim një cilësi morale nuk duhet të neglizhohmë të tjerat. Cilësitë morale kanë një rëndësi të veçantë, sidomos në periudhën e fundit.

NDERSHMËRIA

Kushti i katërt i shpëtimit është:

“Ruajtja e nderit të tyre.” (Muminun, 5)

Nderi është tërësia e vetive morale të njeriut, të cilat e bëjnë të dallueshëm njeriun nga krijesat e tjera. Humbja e nderit është humbje e dinjitetit dhe rënia në një nivel më të ulët se krijesat e tjera.

Nderi dhe pastërtia morale janë ndër vetitë më të rëndësishme të qenies njerëzore. Krenaria, dinjiteti dhe vlera të tjera morale janë të varura prej ndershmërisë. Profeti (a.s.), i cili është model për bashkësinë islame në lutjet e tij nderin e përfshinte vazhdimisht si cilësi të vyer të besimtarit.

“O Zot! Kërkoj prej Teje udhëzim, devotshmëri, moral të pastër dhe zemër të delirë.” (Muslim, dhikr, 72)

Për një jetë të ndershme, martesë është e domosdoshme, përmes saj arrihet një gjendje shpirtërore ideale dhe zbuten dëshirat epushore.

Çerdhja e lumtur familjare e njeriut filloi në Xhenet. Prandaj çerdhja familjare në këtë botë duhet të jetë një parajsë.

Një nga emrat e bukur të Allahut është “El-Vedud” që do të thotë Ai është burimi i vërtetë i dashurisë. Allahu në Kuran na jep dy shembuj idealë të ndershmërisë; njëri i takon Jusufit u, i cili për hir të ndershmërisë zgjodhi burgun, kurse tjetri është shembulli i Merjemes së cilës i përmendet emri 34 herë në Kuran.

Nderi si një nga cilësitë dalluese të besimtarit ka një vlerë të veçantë tek Allahu.

Për rrjedhojë, elementet më të rëndësishme të personalitetit të myslimanit janë: nderi, turpi dhe edukata.

Në fakt edhe qëllimi i fesë është kultivimi tek njeriu i virtyteve të vyera si mëshira, dashamirësia, mirësjellja, modestia, solidariteti etj.

Kushti tjetër i shpëtimit është:

**Veprimi
më i rëndësishëm
që duhet të bëjnë
myslimanët
është përfaqësimi dinjitoz
i personalitetit islam.**

MBAJTJA E AMANETIT DHE BESNIKËRIA

Allahu midis cilësive të tjera përmend edhe cilësi shoqërore:

“Ata të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra.” (Muminun, 8)

Besimtari përveç përkushtimit në ibadet, seriozitetit në jetë, bamirësisë dhe ndershmërisë në jetën e tij, duhet të zotërojë edhe cilësinë e besnikërisë, respektimin e marrëveshjeve, mbajtjen e fjalës, ruajtjen e amanetit. Të gjitha këto janë cilësi të pandashme të besimtarit.

Cilësitë dhe virtytet morale përbëjnë personalitetin e myslimanit.

Dy amanetet më të rëndësishme për të cilat besimtari duhet të kujdeset janë amanetet e të Dërguarit të Allahut r. Në një hadith Profeti (a.s.), thotë:

“Po ju lë dy gjëra dhe për sa kohë do të kapeni fort pas tyre, nuk do të devijoni. Njëri është Libri i Allahut, Kurani, kurse tjetra është rruga ime...” (Muvatta, Kader, 3)

Karakterit është shumë i rëndësishëm, sepse në fund të fundit njerëzit mahnitën dhe admirojnë karakterin e njeriut. Njerëzit ndjekin dhe mbështeten pas njerëzve me karakter dhe personalitet.

Ebu Sufjani në luftën e Uhdit ishte komandant i ushtrisë pagane. Ai Umerin e njihte prej kohësh dhe ishte i vetëdijshëm për trimërinë dhe drejtësinë e tij. Në betejë ishin të dy ballë për ballë. Kur ushtria islame u rrethua u përhap fjala se Profeti (a.s.), ra dëshmor.

Ebu Sufjani u kthye nga myslimanët duke thirrur:

“Umer, thonë që Muhamedi vdiq, a është e vërtetë? Unë më shumë se sa njerëzve të mi të besoj ty.

Ishte karakteri dhe personaliteti i Umerit që e bëri Ebu Sufjanin t'i besonte më shumë fjalës së tij se sa fjalës së njerëzve të vet.

JA PERSONALITETI I MYSLIMANIT

Osman Pasha, heroi i Plevnes në Bulgari mbeti gjashtë muaj i rrethuar, u përpoq të çante rrethimin nuk arriti dhe ra rob lufte. Kur u mblodh komuniteti i krishterë tha:

“Unë për t’ju mbrojtur kam marrë xhizje prej jush, tani që nuk mund t’ju mbroj xhizjen po ua kthej”.

Shekuj më parë e njëjta drejtësi është treguar edhe me popullin e Humusit.

Ky është personaliteti i modeluar sipas kriterëve dhe mënyrës së edukimit profetik.

Xhabiri t, tregon:

Profeti (a.s.), mbajti një fjalim të gjatë. Fjalimin e mbaroi me këto fjalë, të cilat përmbledhnin personalitetin e myslimanit.

“Unë jam më afër besimtarit se sa është ai me veten e tij. Nëse vdes dikush, pasuria që lë pas u takon trashëgimtarëve, por nëse pas lë borxh, atëherë ai borxh më përket mua për ta shlyer. Nëse lë pas jetim, mbrojtja dhe kujdesi ndaj tyre është detyra ime.” (Muslim, Xhuma, 43)

Ky pra është një personalitet që shërben si udhëzues për njerëzimin.

Rumi poeti i famshëm thotë: “Thirri mendjes dhe mos përfito vetëm nga aspekti i jashtëm i namazit, por përpiku të përfitosh edhe nga aspekti i brendshëm. Mos bëj si ai zogu që ulet e ngre kokën për të mbledhur thërrmija, pa qenë i vetëdijshëm për madhësinë e Allahut”.

TË HUAJT E MAHNITUR

Ja çfarë thotë një i huaj për të:

“Në botë asnjë mbret me kurorë nuk ka pasur presigjin, respektin dhe nderimin e Muhamedit, i cili arnonte rrobat e veta.”

Profeti përmes personalitetit shembullor mahnit edhe një të huaj.

Neve si myslimanë na bie detyra të manifestojmë një personalitet që i ka hije ymetit të tij.

Të parët tanë përmes personalitetit dhe karakterit që morën prej Profetit (a.s.) arritën të sundojnë për shekuj me radhë një perandori prej 24 milion km².

Fjala: “Nëse në lumin Vistul janë kuajt e Turqve, atëherë ka drejtësi, siguri dhe ndershmëri”, është shndërruar në fjalë të urtë.

Cilësia e fundit që Allahu përmend në ajetet e para të sures Muminun është përsëri namazi:

“Ata të cilët kryejnë rregullisht namazin.” (Muminun, 9)

Përkushtimi dhe vazhdimësia e namazit janë sekretet e shpëtimit të përhershëm. Cilësitë e tjera radhiten midis dy ajeteve të namazit. Kjo tregon se cilësitë e tjera janë të lidhura me namazin. Përmeshja e cilësive të tjera është në raport të drejtë me përmeshjen e namazit.

Atyre që brumosen me këto cilësi Allahu u premtonte Xhenetin Firdeus.

“Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët, që do ta trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht.” (Muminun, 10-11)

Umeri (r.a.), thotë se Profeti (a.s.), pas zbritjes së këtyre ajeteve u kthye nga Kibla dhe bëri këtë lutje:

“O Zot! Mos na pakëso por na shto, mos na përcmo por na ndero, mos na privo, na jep mirësi, na mundëso të suundojmë dhe jo të sundohemi. Ji i kënaqur me ne dhe na bëj edhe ne të kënaqur me ty.”

Pastaj Profeti (a.s.), u kthye nga shokët dhe tha:

“Më janë shpallur dhjetë ajete, të cilëve kush i jep hakun do të hyjë në Xhenet.” (Tirmidhi, Tefsir, 23:1)

Profeti (a.s.), kërkonte me gjithë qenien e tij që ymeti të manifestonte cilësitë më të larta dhe në këmbim të kësaj, gjithë gëzim, u premtonte Xhenetin, shpëtimin e përhershëm. Profeti (a.s.), ishte vetë një shembull i përsosur.

PERSONALITET IDEAL

Udhëzuesi i personalitetit islam është Kurani. Personi që ia ka ofruar më së miri këtë personalitet njerëzimit me jetën, moralin dhe sjelljet e tij është Profeti (a.s.).

Allahu betohet për jetën e Profetit (a.s.).

“Betohem për jetën tënde.”
(Hixhr, 72)

Allahu i cili nuk është betuar për asnjë njeri dhe profet, betohet për jetën e Muhamedit r. Ky është një argument i qartë se ai është shembulli ideal për ymetin në të gjitha aspektet e jetës.

Asnjëri prej nesh nuk është i aftë të tregojë për virtytet e Profetit (a.s.). Kur një ditë komandanti i shquar, Halid ibn Velid shkoi te një fis arab, kryetari i fisit i kërkoi t'i përshkruante portretin dhe karakterin e Profetit (a.s.). Halidi iu përgjigj:

“Kjo është e pamundur, fjalët nuk mjaftojnë për këtë, por mund të them vetëm kaq:

Vlera e të Dërguarit buron nga Dërguesi dhe meqë Dërguesi është Krijuesi i gjithësisë, merre vetë me mend tani madhështinë e bukurisë së tij, në mundsh!”

Sa mundet mendja jonë e kufizuar ta kuptojë atë dhe sa është në gjendje gjuha jonë të flasë për të!

Por sa të dobët jemi ne, aq bujar dhe i mëshirshëm është Profeti (a.s.). Ai na ka treguar për veten e tij në mënyrën më të bukur. Përshtypja e parë që krijonte një person në kontaktin e parë me të ishte:

MËSHIRË DHE BUZËQESHJE

Ebu Derda, megjithëse në një moment të vështirë

po fliste duke buzëqeshur. Kur e pyetën gjithë kuriozitet tha:

“Përse flet gjithmonë duke buzëqeshur?”

“Sepse e kam parë gjithmonë duke buzëqeshur Profetin r.

Buzëqeshja është shenjë e dashurisë. Është shprehje e dashurisë për hir të Allahut. Dhembshuria e Profetit (a.s.), për krijesat është e jashtëzakonshme, dhembshuria e tij shkon deri tek dega e një peme. Ai nuk dëshiron thyerjen e një dege peme të njomë, kërkonte të mos shqetësonin qenin që po ushqente të vegjëlit e tij.

Profeti (a.s.), tregonte mëshirë edhe për të vdekurit. Disa ditë para se të ndërronte jetë shkoi në varreza dhe bëri lutje për ta. Sa mëshirë gjithëpërfshirëse është kjo!

Pasi bisedoi për disa momente me sahabët tha:

“Sa dëshiroj të shikoj vëllezërit e mi, më ka marrë malli shumë për ta.”

Sahabët e pyetën: “A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o Resullullah?”

“Ju jeni shokët e mi, kurse vëllezërit e mi janë ata që nuk kanë ardhur ende.”

“Si do t'i njohësh ata që nuk kanë ardhur ende, o i Dërguari Allahut?”

Profeti (a.s.), u përgjigj:

“Mendon një njeri që ka një kalë me ballë dhe këmbë të bardha. Ky njeri a mund të ketë vështirësi për ta njohur kalin e tij midis një tufe kuajsh të zinj?”

“Sigurisht që mund ta njohë menjëherë kalin e tij”, - thanë sahabët.

“Ata pra, - tha Profeti (a.s.)- për shkak të abdestit do të vijnë me fytyra të ndritura, me duar e këmbë të ndritshme. Unë do t'i pres ata në Havuz për t'i gostitur. Kurse disa do të dëbohen prej Havuzit, pors i një deve e huaj që dëbohet prej tufës.

Unë do t'i ftoj të kthehen, por mua do të më thuhet:

-Ata e ndryshuan gjendjen pas teje, (duke mos ndjekur rrugën tënde), atëherë edhe unë do të them të qëndrojnë larg, të qëndrojnë larg.” (Muslim, Taharet, 39)

Profeti (a.s.), pastaj kaloi në Xhami, mblodhi sahabët dhe tha:

“Kujt i kam marrë pasuri, le të vijë të marrë pasurinë time. Kë kam goditur le të vijë të më godasë.”

***Ndershmëria
konsiston në çlirimin
nga çdo ndjenjë epshi
dhe dëshirë e ulët. Cilësia
më e spikatur që e dallon
njeriun nga krijesat
e tjera është nderi.***

Profeti (a.s.), këtu dëshiron të na japë një mesazh të rëndësishëm, sepse Ai ishte i mbrojtur nga mëkatet, nuk mund të mendohet që ai të bëjë padrejtësi.

Por Profeti (a.s.), përmes këtyre mesazheve edukon- te ymetin e tij. Besimtarët sipas shprehjes kuranore, janë dëshmitarët e Allahut në tokë.

DËSHMITARËT E ALLAHUT

Allahu i drejtohet ymetit të Muhamedit r kështu në Kuran:

“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzitet dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju.” (Bekare, 143)

Këtë kërkon Allahu prej nesh në mënyrë që Profeti (a.s.), në Ditën Gjykimit të jetë dëshmitar për ne.

Myslimani është person me karakter dhe personalitet të lartë. Ai këtë personalitet dhe karakter duhet t’ia paraqesë dhe t’ia ofrojë gjithë njerëzimit. Vetëm në këtë mënyrë njeriu mund të bëhet përfaqësues i denjë i Allahut në tokë. Një karakter dhe personalitet i tillë arrihet duke ndjekur rrugën dhe moralin profetik.

Nëse u hedhim një sy të parëve tanë, të cilët qenë mbruajtur me moralin profetik dhe sakrifkuan çdo gjë për përhapjen e tij në botë do të vërejmë se kishin formuar një shoqëri ideale. Në një shoqëri të tillë nuk mund të gjeje: fëmijë të braktisur, të varfër dhe të moshuar të lënë pas dore.

Ajo ishte një shoqëri ku nuk mund të gjeje fëmijë dhe të moshuar të braktisur.

Të parët tanë patën themeluar 26300 institucione bamirësie, të cilat përfshinin edhe mjekimin e zogjve të plagosur. Sa horizont i gjerë shërbimi! Ky është përkufizimi i njeriut sipas Islamit. Rrugët ishin të mirëmbajtura, dora e ndihmës ishte shtrirë deri atje ku imagjinata ndeshte vështirësi. Ishte krijuar një vakëf që çonte ujë nga shami në Meke dhe Medine, në mënyrë që haxhilerët të pinin nga uji i shamit. Ky ujë nuk dërgohej me makinë, tren apo avion, por me deve.

Sa horizont i gjerë shërbimi!

Ky ishte njeriu që ndërtoi feja islame.

Ajo që duhet të bëjnë myslimanët sot është ndjekja e rrugës profetike për të ndërtuar një personalitet të lartë dhe të nderuar. Gjyshërit tanë në këtë mënyrë çliruan zemrat e njerëzve. Sulltan Fatihu 10 vjet mbas ngadhënjimit mbi Stamboll ngadhënjëu mbi

Bosnje. Asnjë boshnjak nuk u vra, sepse shpata ishte thjeshtë një copë hekuri për të flakur padrejtësitë. Shpata, nëse përdoret gabim, shkakton terror. Xhihadi në Islam nënkupton çlirimin e zemrave. Boshnjakët u bënë myslimanë nga drejtësia dhe mëshira që tregoi ushtria osmane. Morali i ushtrisë i bëri ata të ktheheshin në mënyrë masive në myslimanë. Edhe Abisinia kështu u bë myslimane. Tregtarët që ikën në Indonezi nuk e rritën çmimin, megjithëse kishte mungesë malli në treg.

Kur mbretit i mbërriti lajmi, e shprehu kështu admirimin për myslimanët:

SA FE TË BUKUR PASKENI JU!

Një personalitet të tillë nuk ka mundur ta shprehë asnjë pedagog, asnjë psikolog, asnjë mësues që është edukuar dhe selitur me parime e mësim të tjera të ndryshme nga ato islame. Një personalitet i tillë nuk mund të arrihet përmes filozofisë dhe arsyes, një personalitet i tillë është i mundur vetëm duke ndjekur gjurmët e Muhamedit r.

Në lidhje me këtë pikë, çështja më e rëndësishme është njohja si duhet e Profetit (a.s.). Është shumë e rëndësishme njohja e jetës, rrugës, personalitetit dhe karakterit të Profetit (a.s.).

Afrimi tek Ai është i mundur vetëm duke ndjekur rrugën e tij dhe duke u ngjyrosur me moralin e Tij. Devijimi nga rruga e Tij, çon në humbjen e përhershme.

Shkëputja një nga një prej Sunetit të Profetit (a.s.), i ngjan zbrërthimit të fijeve të litarit deri në këputje. Litari është i fortë për sa kohë është një tërësi e vetme, por nëse fijet zbrërthehen njëra pas tjetrës, atëherë e humbet forcën. Braktisja e një suneti sjell braktisjen në seri të tij deri në shkëputjen plotësisht prej tij. Shkëputja plotësisht prej tij, sjell humbjen në këtë botë dhe botën tjetër.

Prandaj Suneti i Profetit (a.s.), duhet ndjekur në tërësinë e tij. Ne nuk duhet të harrojmë se jemi dëshmitarët e Allahut të zgjedhur për të përfaqësuar moralin dhe personalitetin islam në tokë.

E lusim Allahun të na bëjë përfaqësues të denjë të moralit profetik. E lusim Atë të na zbukurojë me cilësitë që përshkruhen në suren Merjem. Lusim Allahun që pasardhësit tanë të zbukurohen me bukuritë e moralit profetik.

Amin!..



El-Kuddus

Ilir Hoxha

Kuptimi leksikor i emrit Kuddus, është “*i pastër, i shenjtë*”. Ky emër buron nga rrënja “*kuds*” dhe shpreh cilësinë hyjnore “*Kuddus*”, duke na njoftuar se Zoti ynë është i pastër nga çdo lloj e mete apo mangësie. Në krahasim me emrat e tjerë, ky emër kalon më rrallë në Kuran¹. Ai na njofton se Allahu i Madhëruar është i pastër prej çdo gjëje që mund të jetë opozitë e autoritetit të Tij, është një nga cilësitë më të rëndësishme të Uluhijetit/Hyjnitetit të Tij.

Sipas Gazaliut, ky emër nuk na njofton vetëm se Allahu është larg nga çdo e metë që mund t’i atribuohet, por Ai është i pastër dhe larg çdo lloj cilësie të krijuar që mund të vijë në mend. Po ashtu, edhe përbërja e Tij nuk mund të imagjinohet nga asnjë mendje. Gjykimi përfundimtar që mund të japë mendja në lidhje me Zotin, përbërja e të Cilit është e pamundur të njihet me kallëpet e mendjes, është e vërteta se Ai nuk i ngjan asgjëje. Ai nuk mund të kufizohet në asnjë mënyrë, që të mund të hyjë në imagjinatën njerëzore! Për këtë arsye, është thënë: “*Sido që ta mendosh Allahun, Ai është përtej asaj*”. “*Asgjë nuk është si Ai*”² Kjo cilësi që shpreh largësinë e pafundme prej çdo lloj të mete, mund të përdoret vetëm për Allahun. Është e pamundur që kjo cilësi t’i atribuohet një njeriu, qoftë edhe në formë metaforike, për shkak se kjo do të sillte në mendje se tek ai njeri mund të gjenden disa fuqi apo cilësi mbinatyrore.

Sado të mirë të jenë njerëzit dhe sado të përsosur të duken, përsëri ata nuk mund të jenë kurrë të pastër nga gabimet dhe të metat. Në fakt, kjo i bën ata njerëz. Edhe nëse njeriu arrin gradën e përsosmërisë,

kjo nuk do të thotë se ai është një qenie mbinjerëzore, por tregon se edhe pse ai bart në vete të gjitha cilësitë njerëzore, ka arritur të realizojë moralin që Allahu i Madhëruar pret prej tij.

Përfshi profetët, as ata që pranohen si besnikë, dëshmorë e të devotshëm tek Allahu³, madje as evliatë për të cilët njerëzit kanë konsiderata të larta dhe asnjë prej melekëve⁴, nuk bartin cilësinë e të qenit “mbinatyrorë dhe përtej saj”, në kuptimin e emrit Kuddus. Ashtu siç shpallet edhe në Kuran, të gjithë profetët i kanë paralajmëruar popujt e tyre në lidhje me çështjen atribuimit të shenjtërisë të tjerëve përveç Allahut dhe adhurimit të tyre. Në fakt, ky është besimi monoteist, që është edhe parimi themelor i misionit të profetëve. Mirëpo, prirja për të shenjtëruar fenomenet natyrore, personat, vendet dhe kohën, të cilat gjenden në fetë para Islamit, në sajë të ndikimit të kulturës së huaj, me kalimin e kohës është vërejtur edhe ndër myslimanët. Për shembull, siç është pranimit si të pagabueshëm dhe të pakritikueshëm i dijetarëve kryesorë të medh’hebeve/ekoleve të itikadit/besimit dhe fikhut/jurisprudencës islame, përdorimi i shprehjeve që u atribuon shenjtëri prijësve të tarikateve që kanë ndërruar jetë, kërkimi i ndihmës prej tyre, ndërtimi i vend-adhurimeve në varret e tyre dhe të tjera të ngjashme me këto...


Shembulli më i mirë se, deri ku mund të arrijë puna kur dikush pretendon shenjtëri për dikë apo për diçka, bazuar në mendime personale jashtë shpalljes së Allahut, është në rrugën që ka ndjekur Krishterimi gjatë historisë. Në fakt, njeriut nuk i është dhënë

1. shih. Hashr, 23; Xhumua, 1.

2. shih. Shura, 11.

3. shih. Nisa, 69.

4. shih. Nisa, 172; Junus, 62-64.



kurrë e drejta për të vendosur se çfarë do të jetë e shenjtë apo jo. Kur njerëzit fusin hundët në këtë përgjegjësi hyjnore dhe fillojnë të krijojnë shenjtëritë e veta, fillon të mbizotërojë edhe idhujtaria.

Nga ana tjetër, fakti që përveç Allahut, në vetvetë asgjë tjetër nuk është e shenjtë, nuk e pengon Allahun që të konsiderojë si të shenjtë një krijesë. Ashtu si edhe në të gjithë emrat e Tij, edhe emri i Zotit tonë “Kuddus”, manifestohet në botën e krijesave me dëshirën e Tij. Allahu është “Kuddus/ i Shenjtë” dhe mund t’i japë shenjtëri kujt të dëshirojë Ai. Këto krijesa në të cilat manifestohet shenjtëria, për shkak se të kujtojnë fuqishëm Allahun, kanë arritur të pasqyrojnë një realitet përtej vetes së tyre. Për shembull, sipas komentuesit të Kuranit, Elmallëllë, shprehja “ruhu’l-kudus/shpirti i shenjtë”, që përdoret në katër ajete të ndryshme⁵, ka për qëllim shpirtin që nuk ka mundësi të njolloset me asnjë lloj njolle, që është i sigurt, i shenjtë dhe i pastër. Ky shpirt, është Xhebraili (a.s.). Përmendja e Xhebrailit (a.s.), me këtë gradë, bëhet për të treguar vlerën e Kuranit dhe për të theksuar se ai është zbritur nga Kuddus, me anë të një shpirti të shenjtë që nuk ka asnjë njollë papastërtie.

Gjithashtu, për të theksuar se vijnë prej të njëjtit burim me Kuranin dhe për t’i ndarë ato prej thënieve të Resulullahut (a.s.), një pjese të haditheve u është shtuar shprehja “kudsi”. Ndërsa kushtet e domosdoshme të ekzistencës njerëzore, që Krijuesi ynë ka kërkuar prej nesh t’i ruajmë dhe që për t’i ruajtur ato ka zbritur edhe sheriatin, janë quajtur “mukadesat/ gjëra të shenjta”.

Për sa kohë që nuk ndërhyr keqpërdorimi i njeriut, edhe e vërteta e pastërtisë së përgjithshme që ndodhet në mënyrë të natyrshe në gjithësi, është manifestim i emrit Kuddus të Allahut të Madhëruar. Po ashtu, edhe “vendet” ndahen në të shenjtë dhe në jo të shenjtë. Emrat e vendeve që burojnë prej rrënjës “kuds”, e cila shpreh pastërtinë, i kanë marrë këto emra për shkak se janë vende ku bëhet pastrimi prej gjynaheve dhe papastërtive shpirtërore. Qabeja, është

në krye të këtyre vendeve.⁶ Po ashtu, për shkak se është larg prej vështirësive dhe problemeve të kësaj bote, edhe Xheneti është quajtur “haziretu’l-kuds/ zona e shenjtë”.

Njeriu i cili e pranon se Allahu është i pastër prej të gjitha të metave dhe gjërave negative, e di mirë se tek Ai nuk zë vend e keqja. Besimi se çdo gjë që vjen prej Tij është mirësi e pastër, është një botëkuptim që e ndërron plotësisht pikëpamjen e njeriut për jetën. Në këtë mënyrë, neve na lehtësohet të shohim pjesën e gabimeve tona në problemet me të cilat përballemi. Gjithashtu, myslimani i cili beson siç duhet këtë emër, e di shumë mirë se askush tjetër përveç Allahut nuk mund të jetë i patëmeta dhe për rrjedhojë, nuk ngre asgjë dhe askënd aq sa ta adhurojë. Në sajë të kësaj, ai e ruan nga poshtërimi personalitetin e vet, që është mirësi e Allahut, duke mos u bërë rob i njerëzve si vetja e tij.

Kushejri, me një qasje mistike, mendon se robit, i cili merr pjesë prej begatisë së emrit Kuddus, do t’i pastrohet besimi, adhurimi dhe zemra prej çdolloj gabimi. Për hir të Allahut, ai do ta mbajë veten larg prej ndjekjes së dëshirave të ulëta të egos, do ta ruajë pasurinë e tij prej dyshimit e haramit dhe do ta mbajë pastër kohën e vet prej papastërtisë së mosbindjes ndaj Allahut.

Pastrimi i besimit, arrihet duke u mbështetur tek e sakta dhe e sigurtja dhe duke e mbrojtur nga dyshimi dhe ngurrimi. Pastërtia e adhurimit arrihet me singëritet, ndërsa pastërtia e zemrës, me eliminimin e veseve të këqija. Bërja e një jete të pastër dhe pastrimi i robit duke vazhduar me teube prej gabimeve njerëzore, është kusht i domosdoshëm për mbajtjen pastër të mendjes dhe të zemrës.

Të këqijat brenda nesh që kanë mbetur pa u pastruar, na tërheqin gjithmonë e më poshtë, duke na ftuar vazhdimisht drejt vetes. Përpjekja për të bërë një jetë sa më të pastër që është e mundur, gjithmonë është më e lehtë se sa të përpiqesh për t’u pastruar prej njollave të gjynaheve.

5. shih. Bekare, 87; Maide, 110; Nahl, 102.

6. shih. Bekare, 125; Al-i Imran, 96; Maide, 97.



Sit'i shohim sfidat si mundësi

Mos mendoni se mund të mësoni duke qëndruar në hapësirën tuaj të rehatisë

Në jetën e përditshme, ne mund të hasemi shpesh me vendime të rëndësishme, si për shembull ndërmarrja e një sfide të re; siç është aplikimi për punë apo fillimi i një kursi të ri. Hyrja drejt sfidave të tilla është pjesë e rëndësishme e rritjes dhe zhvillimit si person. Sa më shumë që t'i testojmë limitet dhe aftësitë tona, aq më shumë do të mësojmë rreth vetes. Sfidat e reja janë mundësi për ne.

Megjithatë, ne nuk e shohim gjithmonë kështu.

E meta e kësaj është që, kur i futemi një sfide, ne duhet të përballemi me mundësinë e dështimit. Kështu, në vend që të shohim shanset që na ofrohen, ne fokusohemi tek mendimi se si do të jetë të dështosh.

Si rezultat, nisja e një sfide të re mund të jetë e frikshme. Frika e dështimit mund të jetë shumë e vështirë për t'u duruar. Në këtë mënyrë, ne i shmangemi sfidës dhe vazhdojmë të njëjtën rrugë në të cilën ishim. I bëjmë disa shfajësime vetes në mënyrë që të mund të rrimë në zonën tonë të rehatisë.

Por e vërteta është se duke qëndruar gjithnjë në gjendje qetësie, larg frikës, nuk të sjell gjithmonë rehati. Duke shmangur sfidat, ne nuk jemi në gjendje të njohim siç duhet veten. Ndjehemi të zhgënjyer sikur po bëjmë një jetë që nuk është e përshtatshme për ne. Jemi të dërrmuar nga paret, ankthi dhe

ndjesia e vazhdueshme që gjërat nuk po shkojnë ashtu siç duhet.

Ka raste në të cilat do të donim të hiqim dorë nga sfidat për arsye realisht të duhura. Por, problemi fillon kur ne nuk e kuptojmë që po përpiqemi thjesht të gjejmë justifikime. Trembemi nga ajo që mund të thonë njerëzit, por ndoshta edhe nga ajo që mund të zbulojmë rreth vetes. Kështu, e bindim veten që kjo nuk është koha e përshtatshme ose mundësia e duhur, por faktikisht është frika ajo që po flet brenda nesh.

Për të pasur një jetë të mirëfilltë, kemi nevojë të bëhemi pjesë e sfidave të reja, të cilat na zgjerojnë dhe na japin më tepër mundësi për të qenë vetvetja. Kjo nuk do të thotë që personat me karakter të fortë nuk ndjenë të njëjtën frikë, por ato kanë vullnetin të përballen me frikën e tyre.

Njerëzit me karakter nuk lejojnë që rruga e tyre të udhëhiqet nga mendimet e të tjerëve. Ata janë të hapur ndaj eksperiencave të reja dhe i mbajnë gjallë sfidat e njohjes së vetvetes, por ata e dinë që, kjo është si të kapërcësh një lumë nëpërmjet gurëve që lëvizin, ku ekziston gjithmonë mundësia për t'u lagur.

Nuk është çështja si të kalojmë një jetë gjatë së cilës nuk do të ndjejmë kurrë frikë, por si të ecim përpara pavarësisht frikës që kemi. A jemi në gjendje ta kthejmë frikën në entuziazëm, të angazhohemi me sfida dhe të mësojmë prej tyre?





"ATA"

Edison Çeraj

Sa më larg mediave, aq më i qartë do jesh se çfarë po ndodh; sa më shumë të informohesh përmes tyre, aq më konfuz do jesh.

Vetëm një Zot e di me siguri se çfarë po ndodh në Siri.

Nga ana tjetër, raportime, imazhe apo video të caktuara, që na vijnë nga "amatorë"¹ vendas apo të huaj, tregojnë sheshit për krime ngjethëse, më saktë për një kasaphanë.

Çfarë mund të bësh përballë një padrejtësie kur nuk ke forcë ta ndalosh apo të ndihmosh atë mbi të cilin ushtrohet padrejtësia? Nuk ke çfarë bën, është një përgjigje. Të durosh, është një tjetër. Të lutesh, tingëllon tjetra. Në fakt, mund t'i bësh të trija këto, sikundër mund të mos bësh asnjërën. Por, më shumë se çdo gjë je i detyruar të vuash ligështimin përbrenda – këtë nuk e shmang dot²; këtë do e "bësh" patjetër. Është një ligështim që t'i këput gjunjët. Po t'i binte shkëmbit do e bënte pluhur. Njeriu e mban. Njeriu mban. Njeriu vazhdon të mbajë. Njeriu del nga vetja. (Ku shkon?) Çmendet. Përsëri njeri mbetet. "Jonormal". Ndërsa ata që bëjnë sikur nuk shohin se çfarë po ndodh, ata janë përfaqësuesit e "normales".

Si është e mundur një heshtje kaq e përsosur për masakrat e përbindshme që po ndodhin çdo ditë në atë vend? Apo ngaqë ata janë "ata"?! Si kemi mbërritur deri në këtë pikë? Çfarë rruge kemi ndjekur? Si kemi rënë dakord që të jemi kaq të njësuar, kaq të njëzëshëm? Kjo e jona është koha më problematike për kujtesën. Teknologjia nuk është përgjigje; domethënë, ajo nuk është shkaku – është pasoja.

Gjithnjë e më shumë njerëz duan të marrin pjesë te e nesërmja, ose tek e ardhmja, pa e vrarë mendjen për të djeshmen, aq më pak për të shkuarën. Mos e vrit mendjen!

Më e pakta gjë që tregon kjo gjëmë është se miti (i "opinionit publik") është më real se realja (dëshmitë konkrete, imazhet dhe raportimet). Si është e mundur që të gjitha qeveritë, të paktën ato të vendeve të njohura, kanë bërë një sy qorr e një vesh shurdh për atë

që po ndodh në Siri? Duke e bërë këtë jo vetëm për rastin në fjalë, tashmë kjo "taktikë" është shndërruar në *modus operandi*. Një verbëri kolektive si te romani *Verbëri*. Ne shohim vetëm me sy, dhe kështu njeriu bëhet *homo videns*.

Ndërsa më e shumta që tregon kjo, është se njeriu brenda nesh po tërhiqet, e vendin e tij po e zë ngadhënjyeshëm qytetari, madje qytetari i botës, me idealin e korrektes të mbërthyer në ndërgjegje. Edhe një fije ndërgjegje. Pa ndërgjegje. Dhe kështu ndërgjegje kolektive. Më pas të gjithë bashkëfajtorë. Të gjithë bashkëvuajtës.

Qytetar i cilës botë? Thjesht i botës së *status quo*-së. Ai qytetar që në vend të gjakut ka *cola*.

Një pandjeshmëri torturuese vërshon pa barriera. Është bash ajo kohë që Profeti e shënjon duke thënë që njeriu do donte të ishte nën dhë, e jo mbi të. Në njëfarë mënyre njeriu nën dhë është, se sipër ndodhet stoik qytetari. Dhe kjo është mënyra më tragjike e mundshme. Përsëri: si është e mundur që po heshtim kaq mizorisht për maskrat mbi të pafajshmit në Siri, ku një pjesë e madhe janë foshnja e fëmijë? Sepse po e masakrojmë çdo ditë njeriun brenda nesh. Çfarë faji kanë ata njerëz? Çfarë faji kanë ata fëmijë?

Ajo që po u ndodh atyre njerëzve atje, mund të na ndodhë edhe ne një ditë nëse na kap plani. Është krejt e mundur përderisa ata besojnë se jeta e njeriut duhet t'i nënshtrohet një plani. Ata besojnë se njeriu ka në dorë çdo gjë, dhe kështu ata planifikojnë. Planifikojnë se si duhet të jetë e se si duhet të jetojë njeriu. Ata planifikojnë edhe numrin e popullsisë. Apo jo? Ata shpikin edhe sëmundje nëpër laboratorë. Apo jo? Ata shpikin edhe traditën, edhe lashtësinë. Apo jo? Ata shpikin një botë paralele. Një kopje.

Është koha ku njeriu vdes pa e ditur arsyen. Është koha e projekteve për jetën (e të tjerëve).

Llogaritë janë të gjitha sasiore, të ftohta si boshi, të mprehta si teknologjia.

Siria është dëshmia më e hidhur e fytyrës kufomë të qytetarisë sonë anonime³. Kufomat jemi ne, jo ata. Viktima jemi ne, jo ata. Të pajetë jemi ne, jo ata.

1. Ja diçka që nuk shkon. Çdo gjë nis me fjalën, edhe manipulimi.

2. Nuk po flasim për ata superman-e që arrijnë ta shmangin.

3. Narkozë e përgjithshme.

PLANETI ME DITËN MË TË GJATË SE VITIN



Një natë, Profeti ynë (a.s.), u ngrit, mori abdest për bukuri dhe qëndroi në namaz. Po qante... Qau aq shumë sa që rroba, mjekra e bekuar dhe vendi i sexhdes u lagën nga lotët. Ndërkohë që ishte në këtë gjendje, erdhi Bilali (r.a.), për ta thirrur për namaz. Sapo e pa duke qarë, tha:

“O Resulullah! Përse qani, kur Allahu i Madhëruar ju ka falur të gjitha gjynahet e kaluara dhe të ardhme? Resulullahu (a.s.), u përgjigj:

“A të mos bëhem një rob që e falënderon shumë Allahun? Beto hem në Allahun se këtë natë më kanë zbritur ajete të tilla, që turp i qoftë atij që i lexon dhe nuk mediton mbi to!” Më pas Profeti (a.s.), lexoi këto ajete:

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.” (Al-i Imran, 190-191) (Ibn Hibban, II, 386.)

A ke meditar ndonjëherë për ardhjen njëra pas tjetrës të ditës dhe natës? Apo mos jemi bërë pjesë e atyre për të cilët Profeti (a.s.), ka thënë “Turp ju qoftë!”? Në sajë të atyre që do të tregojmë pas pak, do të përpiqemi të mos jemi prej tyre, qoftë edhe për një moment.

Me aq sa kemi mësuar në lëndën e gjeografisë

nëpër shkolla, dimë se formimi i natës dhe i ditës, është si rezultat i rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet (shpejtësia e rrotullimit të Tokës rreth vetes = 1674 km/orë). Për këtë arsye, pozicioni i Diellit në qiell ndryshon vazhdimisht dhe në bazë të kësaj bëhet edhe përcaktimi i kohës. Dhe përcaktimi i kohës është një koncept shumë i rëndësishëm për ne njerëzit, sepse të gjitha punët tona janë të lidhura me orët.

Lëvizja e rregullt e Diellit në qiell, reflektohet edhe në përcaktimin e kohës. Por çfarë do të ndodhte sikur Dielli të mos lindte prej Lindjes dhe të mos lëvizte në mënyrë të rregullt? Pra, çfarë do të ndodhte sikur të mos lindte prej Lindjes, të ngrihej në qiell, të ulej dhe të perëndonte nga Perëndimi? Po sikur Dielli të lindte dhe, sapo të bëhej gati të perëndoje, të lëvizte mbrapsht e të ngrihej përsëri në qiell? Punët tona do të bëheshin lëmsh apo jo?


Ky fenomen mund të na duket shumë komik, ose mund të mendojmë se një fenomen i tillë ndodh vetëm në filmat fantastiko-shkencorë. Mirëpo, ekziston një planet që e përjeton vazhdimisht këtë fenomen. Ai nuk është shumë larg nesh... vetëm 150 milion kilometra (përafërsisht). Po, në fakt bëhet fjalë për Merkurin, i cili është planeti më i afërt me Diellin dhe më i vogli në sistemin tonë Diellor. Përse Dielli vepron kaq çuditshëm në qiejt e Merkurit?

Koha që Merkurit i duhet për të realizuar një rrotullim të plotë rreth vetes, është 58 ditë. Ndërsa koha që i duhet për të kryer një rrotullim të plotë rreth

Diellit, është 88 ditë. Për rrjedhojë, lëvizja e dukshme e Diellit në qiejt e Mërkurit, është shumë e ngadaltë në krahasim me Tokën.

Kur planeti më i vogël i Sistemit tonë Diellor, Mërkuri, afrohet në disa pjesë gjatë rrugës që ndjek përreth Diellit, Dielli qëndron pothuajse pa lëvizur fare në qiellin e Mërkurit dhe fillon të lëvizë në anë të kundërt, pra jo më prej lindjes në perëndim, por prej perëndimit drejt lindjes. Pas një farë kohe, Dielli ndalon përsëri dhe vazhdon të lëvizë përsëri në qiellin e Mërkurit prej aty ku e kishte lënë. Misteri i këtij fenomeni, fshihet në orbitën ekstremisht eliptike të Mërkurit.

Një veçori tjetër e këtij planeti të mbushur me surpriza, është se një ditë e tij, është më e gjatë se sa një vit i tij. Koha që kalon midis dy lindjeve të diellit në këtë planet, është 176 ditë. Dhe, siç mund ta kujtoni prej asaj që thamë pak më parë, një vit i



Mërkurit është 88 ditë. Pra, një ditë e Mërkurit, llogaritet me dy vite të tij dhe kjo bëhet shkak që ne ta quajmë atë “planeti me ditën më të gjatë se vitin”.

Për shkak se Mërkuri është planeti më i afërt me Diellin, është shumë e vështirë të vëzhgohet, por jo e pamundur. Në mesin e muajit Korrik dhe në një natë pa re, është e mundur që Mërkuri të shihet me sy të zhveshur në horizontin e perëndimit. Madje, nëse shikoni me një teleskop të vogël, do të arrini të shihni edhe fazat e tij që i ngjajnë atyre të Hënës.

Tani imagjinoni sikur këto fenomene që ndodhin në Mërkur të ndodhin edhe në Tokë. Më pas, meditoni mbi gjendjen e njeriut përballë këtyre fenomeneve. Pasi të keni dalë prej këtij meditimi të thellë, kjo pyetje e Allahut të Madhëruar, i hap rrugën një meditimi tjetër: **“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!”** (Rahman, 13)

Prej nga erdhi

KJO KURESHTJE PËR HAPËSIRËN?

Merve Shanllë

Që kur ka filluar të ekzistojë, njeriu ka ndjerë nevojën për të komunikuar dhe për t’u informuar. Për këtë arsye ai ka zhvilluar metoda të ndryshme sipas kohës së vet. Ndonjëherë ka përdorur tymin, ndonjëherë pëllumbat dhe, me kalimin e shekujve ai ka zhvilluar edhe më tepër metodat e komunikimit dhe informacionit. Ndërsa në kohën që jetojmë, teknologjia më e avancuar në këtë fushë përfaqësohet nga “satelitët”. Sistemet satelitore në fushën e informacionit për nga aspekti i tyre gjithëpërfshirës dhe

koston që kanë, në fillim janë përdorur për qëllime mbrojtëse dhe ushtarake. Në fakt, prej këtej vjen edhe kureshtja për hapësirën.

Lufta e Ftohtë, që filloi në vitet 50’, u bë shkak i një tensioni të madh midis Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Më 1955-ën, sapo Amerika bëri të ditur qëllimin e saj për të dërguar satelitin e parë pas dy vjetësh në Vitin Ndërkombëtar të Gjeofizikës, Bashkimi Sovjetik u fokusua në çështjet hapësinore dhe për rrjedhojë hodhi në orbitë Sputnikun, satelitin e parë artificial

në botë. Me këtë veprim, rivalitetit me Amerikën, Sovjetikët i shtuan edhe garën hapësinore.

Në 4 Tetor 1957, Amerika, e cila mendonte se siguria kombëtare ishte në rrezik, në mënyrë të papritur e kthen NACA-n që kishte filluar programet e saj me avionë, në NASA, duke e orientuar atë në çështjet hapësinore. Në vitin 1961, presidenti i asaj kohe John F. Kennedy, kishte mbajtur shumë fjalime në lidhje me çështjen e domosdoshmërisë së dërgimit të njerëzve në Hënë dhe të përshpejtimit të projekteve hapësinore. Për rrjedhojë, me mendimin se, “nëse Sovjetët do të dërgonin ndonjë mjet në hapësirë, ata mund t’i vëzhgojnë amerikanët prej atje, mund t’i përgjohin, e madje edhe mund t’i godisin”, ai kishte ndarë për çështjet hapësinore një pjesë të mirë të buxhetit të vendit.

Ndërsa Rusia, në muajin Prill të atij viti, dërgoi në hapësirë astronautin Juri Gagarin, duke realizuar kështu fluturimin e parë hapësinor të njeriut (mjeti hapësinor Vostok-1). Pas këtij hapi, në vitin 1969, Amerika iu përgjigj Rosisë duke dërguar në Hënë astronautët e saj Neil Armstrong dhe kolegun e tij Edwin Buzz Aldrin, të cilët shkelën të parët truallin e Hënës (mjeti hapësinor Apollo 11.) Zbritja në Hënë, i kushtoi Amerikës 150 miliard dollarë, shumë kjo që ishte më e madhe se sa ajo që u përdor për sistemin e autostradave që Amerika ndërtoi në të gjithë vendin fund e krye. Përfitimi i Amerikës prej këtij investimi, ishte se ajo i garantoi asaj pozitën e liderit botëror në teknologjinë ushtarake dhe civile. Kurse sateliti i parë aktiv me kuptimin e vërtetë të fjalës, është

hedhur në orbitë nga NASA më 1968-ën në kuadër të projektit Score (Explorer-1).

Studimet dhe zhvillimet që u bënë gjatë periudhës që prej Sputnikut e deri tek Apollo 11, u bënë shkak që në vitet në vijim, në jetën tonë të futeshin shumë prej aparateve teknologjike, si komunikimi pa tela (celularët, interneti etj.), xhamat e pathyeshëm për syze, aparatet e vogla me bateri etj., patenta e të cilave i takon NASA-s.

Shkurtimisht, edhe pse kjo garë nuk filloi edhe aq në mënyrë të pafajshme, një pjesë e mirë e teknologjisë në kohën tonë, janë zhvilluar në sajë të projekteve hapësinore. Vendi që përparon në shkencë dhe teknologji, sundon botën. Mirëpo, nëse kjo nuk ka asnjë kuptim nëse ai nuk ka lidhje me Allahun... Kjo, sepse pa menduar se nga vjen gjithë kjo dije dhe si bëhet ajo, nuk mund të arrihet tek dija kryesore, që është dija hyjnore. Mund të ngjitesh në Ekzosferë, në shtresën ku ndodhen satelitët, mund të shkohet edhe në hënë, por më tutje është vështirë. Njeriu mbetet në kufijtë e mendjes së tij... Sot mund të dërgohen satelitët në shtresat e atmosferës dhe të sigurohet komunikimi me botën. Por lidhja jonë me botën tjetër, është në përpjesëtim të drejtë me shtresat e egos që na duhet të përshkojmë. Sa më i fuqishëm të jetë motori, aq më lehtë kalohen edhe shtresat. Nëse besimi ynë për të bërë një mjet, nuk është aq i fortë sa qëllimi i realizimit të Sputnikut, nuk mund të na çojë as në Hënë dhe as në Diellin e të Vërtetit...





VDEKJET NGA MBIPESHA JANË MË TEPËR SE VDEKJET NGA URIA

Nëse mendojmë pak mbi shprehjen “vdekje nga uria”, secilit prej nesh do t’i vinte menjëherë para syve fotoja e famshme e fotografit të New York Times, Kevin Karter, i cili më 1993 fotografoi një vajzë të vogël të rraskapitur nga uria, së cilës i rrinte tek koka një shpend grabitqar që ushqehet me kërma... Por, për çudi të fatit, një vit pasi bëri ato foto, Kevin Karter vetëvritet, duke lënë pas këtë shënim: “Jam në depresion... s’kam as telefon dhe as para për të paguar qiranë e për të mbuluar shpenzimet e fëmijëve të mi... Para!!! Vdekjet, vuajtjet dhe dhimbjet që fotografova gjatë gjithë jetës, nuk më hiqen qoftë edhe për një moment nga mendja... Pamjet e fëmijëve të plagosur dhe atyre që vdiqën nga uria...” (Scott MacLeod, “The Life and Death of Kevin Carter”, Time Magazine, 1994)

Në fakt, ky tregim duket si një tablo e Picassos, por e viteve 90’ dhe shumë më e hidhur, sepse vdekjet që ndodhnin prej urisë në ato vite, nuk ishin për shkak të mungesës së një ushqimi që mbizotëronte në botë. Përkundrazi, pas atyre viteve numri i popullsisë tejmase të shëndoshë, ia kishte arritur numrit të popullsisë që jetonte nën kufirin e urisë. (1.1 miliardë. Worldwatch Institute) Ndërsa në ditët tona,

sipas statistikave në kohë reale të disa portaleve si “worldometers.info”, popullsia tejmase e shëndoshë, është shtuar në rreth 1 miliardë e 630 milionë, ndërkohë që popullsia që çdo natë bie në shtrat e uritur dhe nuk mund të gjejë ushqim për fëmijët e vet, është ulur në rreth 762 milionë. Pra, ndërkohë që njerëzit e uritur, janë ende të uritur, popullsia në mbipeshë po shtohet dita ditës.

Nuk ka mungesë ushqimesh, por padrejtësi në ndarje...

Studimet e fundit, tregojnë se prej 1 miliardë e 630 milionë njerëzve që vlerësohen si mbipeshë, rreth 660 milionë prej tyre janë të sëmurë “obezë”. Po sipas statistikave, çdo vit vdesin 3 milion prej kësaj popullsie obeze, pra tre herë më shumë seç vdesin prej urisë. (The Global Burden of Disease study, The Lancet, 2010)

Lidhur me këtë, mund të themi hapur se vetëm një gjë e shkakton këtë fenomen të çuditshëm. Dhe ajo është padrejtësia në përdorimin e burimeve të jetës në të gjithë botën... Megjithëse bota është e rrumbullakët, ajo është ndarë në parcala dhe është rrethuar me gardhe nën etiketën “shtet”. Gjithashtu,

kësaj i shtohet edhe mungesa e parimit të ndarjes në mendjet e njerëzve të sotëm. Ndarja në mënyrë jo të drejtë dhe të paekuilibruar të burimeve të jetesës në këtë botë me mbi 7 miliardë banorë, nuk shkakton vetëm vdekjen e njerëzve të uritur, por bëhet shkak i vdekjes edhe të popullsisë së “pangopur”, që janë mbipeshë...

Mirëpo, ky problem nuk ka prekur vetëm të rriturit, por shihet si tepër shqetësues dhe për miliona fëmijë që jetojnë si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në ato në zhvillim. Sipas të dhënave të vitit 2013, kërkuesit analizuan shkallën e ndryshimit të peshës në rajone dhe shtete të ndryshme në të gjithë botën. Rajonet e Afrikës së Veriut, Lindjes së Mesme dhe Amerikës Latine kanë parë rritjen më të madhe të mbipeshës dhe obezitetit krahasuar me Evropën (rreth 58 për qind).

Ndërkohë, Amerika e Veriut mban akoma përqindjen më të madhe të mbipeshës të rriturit që është 70 për qind, ndërsa Australia dhe Azia, po ashtu edhe jugu i Amerikës Latine nuk janë shumë pas, 63 për qind.

Gjendja nuk është shumë më ndryshe as në vendin tonë. Sipas disa statistikave të viteve të fundit, ka rezultuar se në vendin tonë, rreth 53% e burrave dhe 39% e grave nga 15 deri në 49 vjeç vuajnë nga obeziteti. Specialistët vërejnë me shqetësim se me hapa të shpejtë po rritet edhe numri i fëmijëve mbipeshë nga 0 deri në 5 vjeç. Aktualisht 22 % e tyre janë mbipeshë. Megjithëse në vendin tonë po rritet dita ditës numri i popullsisë që jeton nën kufirin minimal të jetesës, ende nuk njihen raste të vdekjes nga uria. E megjithatë, duket se do të kemi më tepër vdekje të lidhura me sëmundjet e obezitetit, sesa nga ato të urisë...

Pa trokitur në derë THATËSIRA

Çdo dua dhe namaz ka kohën e vet. Ashtu sikur eklipsi hënor tregon se ka ardhur koha e namazit të husufit, ashtu edhe mungesa e gjatë e shiut, tregon se ka ardhur koha e duasë së shiut. Mirëpo, qëllimi dhe dëshira, më tepër se rënia e shiut, duhet të jetë

kryerja e adhurimit duke pranuar dobësinë dhe nevojën ndaj Allahut si pasojë e mungesës së ujit. Ne jemi mësuar aq shumë me ekzistencën e ujit që mbush çdo ditë gotën tonë dhe që është krijuar si manifestim i cilësisë “Latif/i Butë”, të Allahut, sa që

pandehim se ai do të jetë gjithmonë pranë nesh dhe ne nuk do ta ndjejmë kurrë nevojën për të. Por kjo, zgjat deri atëherë kur retë e mbajnë shiun, ndërsa toka e thith të gjithin... Muajt e nxehtë e të thatë, na bëjnë të ndjejmë se tashmë ka ardhur koha për duanë e shiut. Mbi të gjitha, studimet e fundit tregojnë se thatësira do ta rrisë ndikimin e saj me kalimin e kohës për shkak të ndryshimit të klimës. Por, me sa duket, ne nuk do ta kuptojmë se pula jonë ka ngordhur, derisa të na mbarohen vezët që kemi në shportë...

Përftimi i ujit të pijshëm prej ujit të detit

Para dyqind vjetësh, një detar i njohur, Samuel Taylor Coleridge, ka thënë: “Kemi ujë në çdo anë, por nuk pihet asnjë pikë...” Dhe, me të vërtetë që, prej të gjithë ujit që ndodhet mbi tokë, vetëm 1% e tij është i pijshëm. Mirëpo, në sajë të teknologjisë që është zhvilluar gjatë këtyre dy shekujve pas thënies së Samuelit, tashmë mund të përftohet ujë i pijshëm edhe prej detit. Ky zhvillim, mund të bëhet shpëtimi i shumë vendeve të botës që vuajnë për ujë... Madje, në brigjet e disa vendeve turistike, kanë filluar të ndërtohen stacione që përdorin këtë teknologji nëpër hotele, gjë e cila së shpejti do të jetë një zgjidhje ideale për vendet bregdetare. Përveç kësaj, është provuar se si kostoja, ashtu edhe cilësia e këtij uji, është shumë më e mirë se e ujit që vjen në çezmat e shtëpive tona.

Nëse arrijmë të mbjellim re, mund të korrим shi!

Fenomeni që po hasim shpesh kohëve të fundit, është se sado që retë e mbulojnë qiellin, ato nuk lëshojnë ujë mbi tokë. Mirëpo, tashmë është e mundur të lëshohet shi prej reve në sajë të metodave shkencore që po zhvillohen, duke ndryshuar vlerat

e nxehtësisë dhe presionit, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në këtë ekuilibër. Modifikimi i kushteve klimaterike me anë të metodës së “mbjelljes së reve” (cloud seeding), mund të realizohet brenda disa kushteve të caktuara duke bërë të mundur rënien e shiut në mënyrë manuale. Një shembull i kësaj metode është edhe eksperimenti që u bë në Kinë, në provincën Yunnan, ku nuk binte shi prej 10 vitesh. Në këtë eksperiment janë lëshuar 1000 raketa të cilat u përdorën për të mbjellë retë. Si rezultat i këtij eksperimenti, në atë zonë ra 10mm shi. Ndërsa në metodën e zhvilluar në Kubë, është përdorur një përzjerje e përbërë prej jodit të argjendit, akullit të thatë (dioksidi i karbonit i ngurtë) dhe kripës, e cila është lëshuar mbi re me anë të një rakete ose prej aeroplanëve, me qëllim që të futet në re. Në këtë mënyrë, është arritur të shtohet dendësia e avujve, duke përfutur shi artificial.

Me lagështirën që ndodhet në ajër, mund të pini një gotë ujë...

Kjo metodë e cila mund të përdoret në zonat ku niveli i lagështirës është shumë i lartë, e veçanërisht në muajt e verës, mund të na freskojë mjaftueshëm gjatë ditëve të thatësirës. Në sajë të një aparatit të prodhuar në Amerikë (Hendrx), është e mundur të rritet dendësia e avujve të ajrit dhe të kthehen në ujë të pijshëm. Kjo pajisje mund të përdoret në mënyrë të veçantë në zonat bregdetare, ku niveli i lagështirës është më i lartë. Madje, përveç prodhimit të ujit të pijshëm, kjo pajisje ndihmon edhe në pastrimin e ajrit. Edhe pse në fillim çmimet e këtyre pajisjeve mund të na duken pak të shtrenjta, në kohët e thatësirave, ato do të jenë metodat më të përdorura për të përfutur ujin e pijshëm.

Soditja

“Të zbritëm ty Kuranin që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, në mënyrë që ata të reflektojnë.” (Nahl, 44)

Imam Hereviu soditjen e përkufizon si angazhim të mendjes për të arritur atë që dëshiron. Ai e trajton reflektimin në tre këndvështrime.

Soditja e vërtetë islame mund të burojë vetëm nga një zemër e cila beson në Zotin dhe nga një mendje që i nënshtrohet Atij dhe Atributeve të Tij të larta.

Soditja e krijimit të qiejve dhe tokës, si dhe e gjithë asaj që përfshihet në të, është një praktikë e cila nuk mund të pengohet nga ndryshimet në kohë, hapësirë ose në natyrën e gjërave. Ajo është një formë e lirë dhe e pakufizuar e adhurimit. Po ashtu një proces kognitiv dhe emocional që gjallëron zemrën dhe ndriçon perceptimin. Nga kjo pikëpamje soditja është një aktivitet mendor dhe shpirtëror i pakufizuar, megjithatë, ndonëse është një formë e lirë adhurimi ka një ndalim, siç është soditja e vetë

Qenies Hyjnore. Jo vetëm që është e ndaluar, por është edhe e pamundur.

Faktorët që ndikojnë në thellësinë e soditjes.

Faktori i parë që ndikon në thellësinë e soditjes dhe meditimit para së gjithash është niveli i besimit të individëve dhe niveli i afërsisë së tyre me Zotin. Sa më i fortë të jetë besimi aq më i lehtë është meditiimi dhe reflektimi mbi krijesat e Zotit. Soditja kalon nëpër disa faza të ndryshme: Faza fillestare perceptivive- kognitive, faza e vetëdijesimit për saktësinë dhe mrekullinë e krijimit dhe faza kur vetëdijesimi i tillë për krijesat kalon në vetëdijesim ndaj Krijuesit.

Faktori i dytë që ndikon në thellësinë e meditimit është personaliteti dhe aftësia e tyre e brendshme për t’u përqendruar pa u lodhur ose pa u bërë monoton. Ky faktor ka lidhje më shumë me natyrën e sistemit nervor.

Faktori i tretë që përcakton thellësinë e meditimit është faktori psikologjik. Meditimi kërkon një shë-

*Soditja e krijimit të qiejve dhe tokës,
si dhe e gjithë asaj që përfshihet në të,
është një praktikë e cila nuk mund të pengohet nga ndryshimet në kohë,
hapësirë ose në natyrën e gjërave. Ajo është një formë e lirë
dhe e pakufizuar e adhurimit. Po ashtu një proces kognitiv
dhe emocional që gjallëron zemrën dhe ndriçon perceptimin.*

ndet të mirë psikologjik dhe fizik. Personat që vuajnë nga sëmundje të ndryshme fizike dhe psikologjike nuk mund të arrijnë një nivel të lartë soditjeje.

Faktori i katërt është kultura dhe edukimi. Mënyra e edukimit ka ndikim shumë të madh në zhvillimin e aftësive medituese. Sa më shumë ta nxisë sistemi dhe mjedisi kulturor soditjen, aq më e thellë do të jetë ajo.

Faktor tjetër është njohuria rreth objektit mbi të cilin do të realizohet meditimi. Një person i zakonshëm mund të meditojë mbi qiellin dhe bukuritë e tij, por një person që është astronom do të meditojë mbi të me një sy krejt tjetër.


Një faktor tjetër që ndikon ndjeshëm në mënyrën e meditimit është shoqërimi me njerëz pozitiv.

Kur plotësohen të gjitha kushtet, soditja mbulon aspektet kognitive dhe emocionale dhe bëhet më e thellë dhe më transcendentë për nga devotshmëria dhe përkujtimi e madhërimi i Zotit, ata arrijnë në një nivel ku e perceptojnë fuqinë e Zotit, urtësinë, mëshirën dhe të gjitha cilësitë e Tij të tjera në çdo gjë që e shohin dhe dëgjojnë. Duke e përshkruar këtë gjendje Ibn Kajjimi thotë: “Soditja e thellë dhe e vazhdueshme e adhuruesit do të hapë për të një portë hyjnore nëpër të cilën ai do të shikojë lart drejt Atij më të Lartit dhe Supremit, sikur ta shikojë vërtet Atë mbi qiejt e Tij

duke qëndruar në Fronin e Tij, duke i parë krijesat e Tij, duke dëgjuar zërat e tyre dhe duke i njohur qëllimet e tyre të fshehta. Atëherë para adhuruesit hapet porta e amshimit dhe përmes saj ai vetëdijësohet se të gjitha ndryshimet e universit dhe çështjet e ekzistencës janë vetëm në duart e të Gjithëfuqishmit. Çdo gjë që do të shikojë do ta drejtojë për tek Krijuesi. Çdo element i universit do t'i drejtohet adhuruesit duke i thënë: “Merr dëshminë time për Atë i Cili krijoi çdo gjë në përsosmëri. Drita e diturisë, të vërtetës, singleritetit dhe dashurisë do të rrjedhin nga zemra e tij sikur drita që rrjedh nga dielli.

Nëse një mysliman dëshiron të ngjitet rrugës shpirtërore të adhuruesve të devotshëm gjatë rrugës së tyre transcendentale, drejt njohjes shpirtërore, frymëzuese dhe ndriçuese ai nuk do të gjejë mjet më të mirë se reflektimi i thellë meditues. Me kalimin e kohës aftësia e tyre soditëse gradualisht rritet nga perceptimi i thjeshtë shqisor në njohjen shpirtërore, ata kështu do të arrijnë fazën e bekuar në të cilën zemra dhe mendja mbulohe me dashuri dhe madhërim ndaj të Gjithëfuqishmit, në këtë mënyrë ata do të shohin me sytë e tyre fizikë dhe mendorë se gjithçka në këtë univers i nënshtrohet Zotit dhe vullnetit të Tij dhe ka nevojë për mëshirën dhe bamirësinë e Tij. Ata që arrijnë këtë nivel janë njerëzit më të lumtur, ata fitojnë kënaqësinë e Zotit, si dhe prehjen, sigurinë dhe lumturinë e plotë në këtë botë.





MUSHAMED IKBAL

JETA, PERSONALITETI DHE VEPRAT

PERSONALITETI

Si për nga natyra, ashtu edhe përgatitja, Ikbali ishte njeri me karakter serioz dhe përsiatës. Ai ishte rritur në një mjedis, ku fetaria dhe dituria çmoheshin shumë. Fëmija Ikbali ulej me durim gjatë sezoneve të mbajtura në shtëpinë e tij, ku klasikët e mistikës islame, asokohe matanë të kuptuarit të tij, lexoheshin nga individë të ditur. Ai kishte respekt të thellë për figurat e shquara fetare dhe mistike të historisë islame – të krejt historisë botërore madje – siç dëshmon poezia e tij.

Nuk ka asnjë dyshim rreth përkushtimit kryesor të Ikbalit në jetë. Si intelektualisht, ashtu dhe emocionalisht, ai ishte i paepur ndaj idealeve të Islamit, të cilat i ishin ngulitur nga mësimi i hershëm. Devocioni i tij veçse u rrit me kohën, gjersa mendimi i tij, siç e thotë dhe vetë, u “kuranizua” plotësisht. Por Ikbali nuk ishte assesi obskurantist fetar. Shumë autorë e kanë komentuar pranimin prej tij të njerëzimit në masë. Mes miqve të tij më të afërt kishte jo vetëm muslimanë, por edhe të krishterë,

hindu e sikhë; në poezinë e tij, ai u thuri lavde shumë jomuslimanëve të famshëm nga lashtësia dhe epoka moderne.

Një prej cilësive që Ikbali admironte ishte *fakr*-i. Në poezinë e Ikbalit, kjo fjalë, që në kuptimin burimor arab do të thotë varfëri e përshpirtshme, përfaqëson një qëndrim vetë-mjaftueshmërie e indiference ndaj kurtheve të pushtetit dhe famës (Ikbali përdor edhe fjalën *dervish* në thujtje të njëjtit kuptim). Ikbali jo vetëm që e predikonte, por edhe e ushtronte fakrin. Si avokat, ai nuk pranonte kurrë më shumë se dy-tre çështje përnjëherësh, duke synuar të nxirrte të ardhura vetëm sa për të shtyrë një muaj a dy. Kur Sër Akbar Hajderi, guvernator i Hajderabadit, i dërgoi një çek prej njëmijë rupishë, Ikbali e ndjeu se Sër Akbari kishte dashur t’i bënte nder, prandaj ia ktheu çekun dhe shkroi një poezi, duke cituar fakrin (pra ndjesinë e dinjitetit) e tij si arsye për mospranimin e ofertës.

Një tjetër cilësi që Ikbali admironte ishte guximi. Sigurisht, ai vetë e kishte guximin e bindjes. Kur u

bë Kalorës, njëri prej miqve i shkroi i shqetësuar se tani e tutje, i njohur nga qeveria britanike, Ikbali nuk do mund të fliste lirshëm mbi çështjet me rëndësi kombëtare. Në përgjigjen e tij, Ikbali i shkroi se nuk kishte fuqi në botë që ta ndalonte nga thënia e së vërtetës. Ngjarjet e mëvonshme e vërtetuan këtë.

Ikbali kishte karakter të dhembshur, të kultivuar nga marrëdhënia e tij e ndjeshme me besimin dhe estetikën. Sa herë që lexonte Kuran, ai qante aq shumë, sa që shpesh kopja e tij e Kuranit duhej nxjerrë në diell për t'u tharë nga lotët. Edhe vargjet e fuqishme e preknin po ashtu; një herë, ai u kaplua aq fort nga emocioni prej leximit të disa vargjeve, sa që gati i ra të fikët (RMI, 211). Një prej kulmeve të jetës së tij emocionale ishte vizita në Xhaminë e Kordovës në Spanjë, e cila, sipas fjalëve të tij, e ngriti “në lartësi që s’i kisha përjetuar kurrë” (RMI, 459). Poezia ‘Xhamia e Kordovës’ mbahet nga shumë njerëz si kryevepra e tij. Ikbali kishte sy të mprehtë për talent. Ai ftoi dhe inkurajoi një sërë individësh që të ndërmerrenin projekte të ndryshme, të cilat i konsideronte të rëndësishme. Ai e bindi Muhammed Ali Xhinnah-un (themeluesin e mëvonshëm të Pakistanit) që të kthehej nga Anglia në Pakistan e t’u printe politikisht muslimanëve të vendit. Ai e ftoi Ebu’l-A’la Mewdudiun (themeluesin e mëvonshëm të partisë politiko-fetare Xhema’at-i Islami) që të ndërmernte rindërtimin e mendimit juridik islam përgjatë linjave të caktuara (projekti nuk nisi, për shkak të vdekjes së Ikbalit pak kohë më pas.)

VEPRAT

Ikbali shkruante me lehtësi të madhe në tri gjuhë – urdisht, persisht e anglisht dhe prodhoi vepra në të trija. Ai shkroi prozë në anglisht, poezi në persisht dhe prozë e poezi në urdisht. Vijon një hyrje e shkurtër në librat e tij, sipas radhës së botimit:

Vepra Poetike

Asrar-i Khudi (“Sekretet e Vetes”; persisht; 1915). I mbështetur në burimet fetare, shpirtërore dhe letrare të Islamit, Ikbali ofron një pohim të detajuar të filozofisë së tij të vetes njerëzore, duke i ilustruar elementet kryesore të asaj filozofie me tregime dhe anekdota. Në këtë poemë, Ikbali është i ndërjegjshëm për rolin e tij si mbajtës i një mesazhi profetik për muslimanët e kohës. Thelbi i këtij mesazhi është kultivimi i një personaliteti njerëzor dinamik

nëpërmjet veprimit, përpjekjes dhe pranimit të sfidave të jetës. Në këtë poemë, Ikbali e pranon ndikimin e Rumiut, që u bë burim i vazhdueshëm frymëzimi e udhëzimi. Poema ilustron gjithashtu edhe bindjen e Ikbalit se funksioni i duhur i artit është fisnikërimi i jetës.

Rumuz-i Bikhudi (“Romuzet e Vetëmohimit”; persisht, 1918). Kjo vepër është vëllim shoqërues i *Asrar-i Khudi*. Nëse ky i fundit trajton zhvillimin e vetvetes dhe të individit, *Rumuz-i Bikhudi* merret me rolin dhe funksionin e individit në shoqëri. Sipas Ikbalit, individët mund t’i zhvillojnë plotësisht potencialet e tyre vetëm në shoqëri dhe vetëm kur të japin ndihmesën në objektivat e gjera të bashkësisë të cilës i përkasin. Në një kuptim shumë real, mund të flitet për veten bashkësore, ashtu siç flitet për veten individuale.

Pajam-i Mashrik (“Mesazhi i Lindjes”, persisht, 1923). Në parathënien e *Pajam-i Mashrik*, Ikbali thotë se ai u motivua ta thurte këtë vepër nga *West-Östlicher Divan* i Gëtes. Pas një citati të Hajnes, ku thuhet se *Divani* i Gëtes përbën një përpjekje të Përrëndimit shpirtërisht të dobët për të nxjerrë fuqi e gjallëri nga Lindja, Ikbali thotë se *Pajam-i Mashrik* synon të vërë në pah të vërtetat morale e fetare që ndikojnë në formimin e karakterit të individëve dhe kombeve. Kjo vepër ka gjithashtu një qëllim më të prekshëm e praktik, sepse Ikbali vëren që kush-tet e Indisë së atëhershme i ngjanin deridiku atyre të Gjermanisë së kohës së Gëtes. *Pajam-i Mashrik* shtjellon një larmi temash dhe motivesh filozofike, politike e letrare, duke përfaqësuar një ndër majat e veprës poetike të Ikbalit.

Bang-i Dara (“Zilja e Karvanit”, urdisht, 1924). I ndarë në dy pjesë, e para nga të cilat përfundoi më 1905 ndërsa e dyta më 1908, ky libër na ndihmon të kuptojmë, si asnjë libër tjetër i Ikbalit, aspekte të ndryshme të zhvillimit të mendimit dhe orientimit të tij. Pjesa I përfshin poezi të paharrueshme mbi natyrën, poezi për fëmijët – disa nga të cilat janë përkthime ose përshtatje poezish perëndimore – dhe poezi patriotike. Hyrja e Sër Abdul-Kadirit i siguron një sfond të dobishëm veprës.

Zebur-i ‘Axham (“Psallme Perse”, persisht, 1927). Në njërën prej letrave të tij, Ikbali e përmbledh përmbajtjen e këtij libri në katër pjesë: dy pjesët e para

përfaqësojnë njeriun në bisedë me Zotin dhe njeriun që komenton për botën e njeriut përkatësisht; pjesa e tretë ofron përgjigje ndaj një sërë pyetjesh filozofike të shtruara në vargje nga një mistik musliman i shekujve XIII-XIV; ndërsa pjesa e katërt diskuton ndikimin e skllavërisë mbi fenë dhe kulturën e një kombi. Megjithatë, në përdorimin e përgjithshëm, titulli *Zebur-i 'Axham* u referohet dy pjesëve të para, sepse dy të fundit kanë status thuajse të pavarur si poema. *Zebur-i 'Axham* zë vend të shquar në korpusin poetik të Ikbalit, si për nga thellësia e mendimit, ashtu dhe shkëlqyeshmëria e shprehjes dhe stilit.

Xhavid-Nameh ("Poema e Përjetësisë"; persisht, 1932). E krahasuar shpesh me *Komedinë Hyjnore* të Dantes, kjo vepër tregon udhëtimin shpirtëror të Ikbalit, nën udhëzimin e Rumiut, përmes sferave qiellore, duke përfunduar me arritjen e pranisë Hyjnore nga Ikbali dhe mbajtjen e një dialogu me Zotin. Të gjitha çështjet madhore filozofike e të tjera, që Ikbali i kishte shtjelluar me shkrim, trajtohen këtu nga një perspektivë e njësuar, duke formuar një skemë të puthitur mendimi. Në këtë vepër, Ikbali diskuton një sërë sistemesh ideore, lëvizjesh dhe personalitetesh të historisë së lashtë dhe moderne.

Musafir ("Udhëtari"; persisht, 1934). Kjo poemë përmban përsiatjet e Ikbalit rreth historisë së Afganistanit, gjatë vizitës së tij atje, me ftesën e Nadir Shahut. Ajo shpreh shpresën e tij se afganët trima e liridashës do ta ringjallin lavdinë e Islamit, duke u udhëzuar nga Kurani.

Bal-i Xhibril ("Krahu i Gabrielit"; urdisht, 1936). Ky libër e ripërkuftizon ghazalin – lirikën e zakonshme dashurore të poezisë perse dhe urdu – duke e përdorur si mjet për trajtimin e një sërë temash fetare e filozofike. Nga njëra anë, Ikbali komenton mbi ngjarjet nëpër botë, ndërsa nga ana tjetër flet për institucionet dhe shoqëritë muslimane, për t'i nxitur muslimanët që ta braktisin pasivitetin dhe kapjen e verbër pas traditës, në mënyrë që t'u japin përgjigje dinamike sfidave të jetës. Ghazalet përbëjnë një pjesë të madhe të *Bal-i Xhibril*, por libri përmban edhe *rubai* (strofa katërshe) dhe poezi të gjata, ku përfshihen 'Ode Sakiut', e cila lavdëron lëvizjen, ndryshimin dhe krijueshmërinë, si dhe e famshja 'Xhami e Kordovës'.

Pas Çih Bajad Kard Aj Akvam-i Shark? ("Ç'duhet bërë tani, o popuj të Lindjes?"; persisht, 1936). Kjo poemë synon t'i shkundë muslimanët e mbarë botës për realitetin e krijuar pas pushtimit italian të Abisinisë më 1936. Ndonëse fokusohet në çështjet politike të kohës, ajo shtjellon mjaft prej temave fetare e filozofike të gjendura në veprat e tjera të Ikbalit.

Zarb-i Kalim ("Goditja e Moisiut"; urdisht, 1936). E quajtur 'deklaratë lufte ndaj kohës së sotme' nga autori, *Zarb-i Kalim* qorton ashpër aspekte të caktuara të politikës, kulturës dhe stilit modern të jetesës. Ky libër shfryn kundër shoqërive muslimane dhe mbarë botës, për dështimin e tyre që t'u përmbahen parimeve të larta e fisnike; ai u bën thirrje lexuesve që të veprojnë për ta ndryshuar botën.

Armaghan-i Hixhaz ("Dhurata e Hixhazit"; persisht dhe urdisht, 1938). Kjo vepër e botuar pas vdekjes përmban dy pjesë: një në persisht e një në urdisht. Ajo përbëhet kryesisht nga ruba'i që përmbledhin pikëpamjet dhe idetë e Ikbalit mbi një sërë temash. Pjesa në urdisht përmban të famshmin 'Komitet Këshillues të Iblisit', në të cilin Ib-lisi (Shejtani), pasi i dëgjon këshilltarët e tij, që e pikasin shfaqjen e filozofive dhe lëvizjeve të reja në botë, u thotë atyre se kërcënimi i vetëm ndaj sundimit satanik është Islami.

VEPRA NË PROZË

Ilmu'l-'Iktisad ("Ekonomi Politike"; urdisht, 1903). Në parathënie, Ikbali thotë se kjo vepër bazohet në 'disa libra të mirënjohur dhe vërtetësorë' dhe se në vende të caktuara, përmban edhe 'opinione të tij personale' (f. 32). Pasi pohon natyrën dhe metodën e ekonomisë, libri trajton çështjen e prodhimit, shkëmbimit, shpërndarjes dhe përdorimit të pasurisë, me këtë renditje. Në këtë libër, Ikbali sajoi të barazvlefshmit urdu të një sërë termave ekonomikë në anglisht. Ikbali debaton se zhvillimi ekonomik i një kombi është i lidhur ngusht me arsimin e masave. Mjaft ide ekonomike të paraqitura në veprat e tij, kthehen pas, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, tek *Ilmu'l-'Iktisad. The Development of Metaphysics in Persia* ('Zhvillimi i Metafizikës në Persi'; anglisht, 1907 - botuar më 1908) ishte titulli i tezës së doktoraturës, që Ikbali paraqiti në Universitetin e Mynihut. Ndonëse e shkruar para një shekulli, ajo mbart akoma interes për studiuesit dhe pjesë të caktuara të saj janë të disponueshme për lexuesin e përgjithshëm.

PËRFAQËSIMI I VAZHDIMËSISË NË ART

Edison Çeraj

Çdo vepër arti na lidh si me magji me Vazhdimësinë e Jetës tej jetës së jetuar me sigurinë që na japin shqisat. Kjo Vazhdimësi, së pari ka një raport unik me autorin e veprës, e më pas – nëse është e mundur – i drejtohet edhe të tjerëve.

Së këndejmi “shpjegohet” edhe nevoja e brendshme e çdo artisti për të krijuar pa ndërprerje, ku pas çdo veprë – sepse asnjëra veçmas nuk i mjafton – vjen një tjetër. Kjo sepse çdo autor përjeton fuqishëm nevojën për t’i kujtuar vetes Vazhdimësinë, kujtesë e cila vlen edhe për tjetrin (shikuesin, dëgjuesin ose lexuesin e saj). Përgjithësisht artistët shfaqin një devotshmëri (në përkaj/“ekstreme”) të pavetëdijshme për Vazhdimësinë.

Duke qenë se burimi i veprës së artit është metafizik, – përderisa vepra në krye të herës shfaqet në botën e brendshme të krijuesit të saj, duke mos i mbetur tjetër vetëm se të manifestohet së jashtmi në botë – dhe si i tillë i pagjasshëm të shpërfaqet në botë ashtu siç është, e bën artistin të krijojë vazhdueshëm dhe të mos ndihet – vetëm në raste dobësie, që gjithsesi mbeten përjashtime – i mjaftueshëm apo i përmbushur.

E si mund të ndodhë ndryshe kur është pikërisht ky burim që na ka në dorë ne, e jo ne atë! Ne vetëm se i nënshtrohemi kur ai shpërthen papritur, pa na marrë leje, siç ngjau, fjala vjen, me Gauguin-in, i cili deri në moshën tridhjetë e ca vjeçare nuk qe gjë tjetër vetëm se një tregtar i zakonshëm, dhe një ditë prej ditësh i “shkrepet” të bëhet piktor, dhe u bë ai që u bë, sikurse e dimë fort mirë! E njëjta gjë ndodhi edhe me Van Gogh-un, që trazimet dhe pikëpyetjet për të qenurit gjeti shteg krejt beftë t’u jepte udhë në pikturë. E gjithë kjo nisi pasi i kishin kaluar tridhjetë vite nga jeta.

Përndryshe, nëse besojmë se jemi ne ata që e kemi në dorë burimin e veprës, apo ngjizjen e saj, atëherë kemi rënë në racionalizëm (pra, në akademizëm), duke vënë shenjën e barazisë ndërmjet krijimtarisë artistike dhe disiplinave racionale, të cilat i qasen botës vetëm në formë sasiore.

Pra, një vepër arti, që në një mënyrë apo në një tjetër na lidh me Vazhdimësinë (le të theksojmë tani: me Pafundësinë), mbi të gjitha është (për)kujtesë që na ndërmend se duhet të jetojmë për t’u thelluar te Vazhdimësia, e jo vetëm të gjallojmë, sepse kjo e fundit na privon nga thelbi i Vazhdimësisë.

Prandaj mbeten gjithherë të gjalla veprat e njëmendta të artit, bash ngaqë burimi i tyre nuk banon në kohë dhe hapësirë, por edhe sepse ato kanë si mision të pashpallur e të pashkruar të na lidhin me thelbin e Vazhdimësisë, që edhe ato e përfaqësojnë në mënyrën e tyre.

Përgjithësisht estetika nuk e ka marrë seriozisht këtë aspekt të veprës së artit, ose më saktë, si e tillë, nuk ia del të merret me këtë aspekt, pasi pushon së qenuri e tillë. Kështu ajo na ka larguar nga thelbi dhe na ka zhytur në botën e rrethanave/shumësisë, që përbën një rrethë vicioz *sui generis*, që e shumta na bën ta shijojmë veprën e artit, madje edhe ta “kuptojmë”, por asnjëherë ta përjetojmë atë.

Shpeshherë kjo na detyron që të biem në përfundimin sociologjik: një vepër arti na drejtohet ne, ose të gjithëve, dhe jo mua/ty.

Megjithatë, krijuesi dhe vepra mbeten të paprekur nga kjo dukuri. Ajo që del e cenuar apo e dëmtuar është qasja e publikut ndaj veprës së artit.



Sulbe të zgjedhura

Naim Drijaj

Misioni i myslimanit

(Disa nga objektivat që duhet të ketë myslimani)

TË JETOJË ISLAMIN NË TË GJITHA ASPEKTET E JETËS

Ebu Dherri (r.a.), e ka pyetur Pejgamberin(a.s.): “O i Dërguari i Allahut, më trego një vepër që nëse e bëj do të fitoj Xhenetin.” Profeti (a.s.), i është përgjigjur: “Besimi në Allahun.” Kur Ebu Dherri (r.a.), pyeti sërish: “A ka nevojë imani për vepra?” Pejgamberi (a.s.), i dha disa alternativa të veprave të imanit që përfshijnë aspekte të ndryshme të jetës së besimtarit:

Të japë nga pasuria që i ka dhënë Zoti. Ebu Dherri pyeti: “Po nëse është fukara?” Atëherë, Profeti (a.s.), i dha një alternativë tjetër:

Të flasë një gjë të mirë. Ebu Dherri pyeti: “Po nëse personi është memec?”

Të ndihmojë një person të cilit i është bërë zullum (padrejtsi). Ebu Dherri pyeti: “Por nëse personi është i dobët e nuk ka forcë të ndihmojë?”

Të ndihmojë të paaftin në punën e tij. Ebu Dherri pyeti: “Po nëse personi është i paaftë e nuk ka asnjërin prej këtyre mundësive?” Pastaj, Pejgamberi (a.s.), i tha Ebu Dherrit: “Ti nuk do të lësh asnjë mundësi, atëherë të mos u bëjë keq njerëzve.”¹ (Nëse myslimani nuk ka mundësi të bëjë të mira, të paktën të mos i bëjë keq kujt.)

TË PASQYROJË MËSIMET E ISLAMIT NË JETË

Zoti (xh.sh.), e ka dërguar Profetin (a.s.), me misionin e mëshirës. Ne si besimtarë sa e reflektojmë mëshirën në jetën tonë? Allahu (xh.sh.), thotë: “**Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të**

gjitha botët.”² Duke komentuar ajetin e lartpërmendur, Imam Razi në tefsirin e tij thekson: “Muhamedi (a.s.), ishte mëshirë në fe dhe mëshirë në këtë botë. Mëshirë në fe, sepse ai (a.s.), u dërgua, ndërkohë që njerëzit jetonin në injorancë dhe humbje...i ftoi në të vërtetën, u shpjegoi atyre rrugët e shpërblimit dhe u qartësoi atyre vendimet, duke bërë dallimin në mes hallallit dhe haramit. Mëshirë në këtë botë për faktin se ata shpëtuan për shkak të tij nga shumë poshtërime, luftëra dhe vrasje, si dhe triumfuan për shkak të fesë së tij”.

Në momentet më të rënda, në luftën e Uhudit, kur idhujtarët u munduan ta vrisnin Pejgamberin (a.s.) dhe e detyruan atë të drejtohej drejt një kurthi, një grope të hapur, i rrethuar nga të gjitha anët me armiq ai (a.s.), u plagos rëndë, aq sa u dëmtua në fytyrën e bekuar që ia mbuloi gjaku dhe iu thyen dy dhëmbët e përparmë. Sahabët u zemëruan dhe i thanë: “Lutu kundër tyre (idhujtarëve) o i Dërguar i Allahut”, ndërsa ai iu përgjigj: “Unë nuk jam dërguar për të mallkuar, por vetëm për mëshirë”.

Ai i ngriti duart nga qielli, dhe njerëzit që e panë duke vepruar ashtu menduan se Profeti do t'i mallkonte idhujtarët, ndërsa nga goja e tij e bekuar dolën fjalët: “Zoti im! Fale, udhëzoje popullin tim, sepse ata nuk e dinë se ç’po veprojnë”.

Allahu (xh.sh.), thotë: “**Elif Lam Ra. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t’i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd**”.³

Syri ynë duhet të jetë afrimi i njerëzve nga feja, jo nxerrja e tyre.

2. Enbija, 107.

3. Ibrahim, 1.

1. Bejhakui në Shu'bul iman 3053.

DIJETARI DHE HAJDUTI

Hyri një hajdut në shtëpinë e Malik bin Dinarit, por nuk gjeti në të asgjë për të vjedhur dhe kur Malik bin Dinari sapo mbaroi namazin e tij i tha: “Erdhe që të marrësh diçka të kësaj bote, po për botën tjetër çfarë ke marrë?”; Hajduti i çuditur nga fjalët e dijetarit ulet pranë Malik bin Dinarit i cili e këshillon, derisa përloten të dy së bashku. Në mëngjes shkojnë të dy në xhami dhe kur njerëzit i shohin, të habitur pyesin se si ka mundësi që dijetari më i madh është bashkë me hajdutin më të madh?! Malik bin Dinar u tha: “Ky njeri erdhi të na vjedhë ne, por ne ia vodhëm zemrën atij.”⁴

Njëherë, Profetin (a.s.), e pyetën: “Cila është ajo punë që i fut më shumë njerëzit në Xhenet?” Profeti (a.s.), iu përgjigj: “Frika nga Allahu dhe morali i lartë.”⁵

MISIONI YNË DUHET TË JETË MËSIMI DHE LEHTËSIMI I FESË SË ZOTIT PËR NJERËZIT

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Në të vërtetë, Allahu nuk më ka dërguar si dëmtues dhe vështirësues, por më ka dërguar mësues dhe lehtësues.”⁶

SHFRYTËZIMI I RASTIT PËR TË BËRË VEPRA TË MIRA

I Dërguari i Allahut ka thënë: “Ruajuni Zjarrit, qoftë edhe me gjysmë hurme, ose edhe me një fjalë të mirë”⁷ Allahu (xh.sh.), thotë:

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë”.⁸

Ebu Hurejra (r.a.), transmeton dhe thotë se i Dërguari (a.s.), ka thënë: “Një njeri, duke udhëtuar e kishte lodhur etja e madhe. Gjen një pus, zbret poshtë dhe shuan etjen. Kur del jashtë gjen një qen me gjuhë të nxjerrë jashtë, që hante dheun nga etja. Atëherë mendoi me vete: ‘Kjo krijesë ndihet e etur, ashtu siç ndihesha unë pak më parë.’ Zbret përsëri në pus,

4. Tarihu el islam’ i Dhehebiut, 2/144.

5. Tirmidhiu.

6. Muslimi.

7. Buhariu, Muslimi.

8. Zelzele, 7-8.

mbush këpucën e tij me ujë, ngjitet dhe ia jep qenit. Allahu për këtë e shpërbleu dhe ia fali gjynahet”.⁹ “Një grua u ndëshkua për shkak të një maceje. Ajo e mbylli atë derisa ngordhi nga uria. As nuk e ushqeu dhe as nuk e la të lirë të ushqehet vetë.”¹⁰

ADHURIMI I ZOTIT DHE PASIMI I PROFETIT (A.S.), DHE DASHURIA NDAJ TIJ

Misioni kryesor i myslimanit është adhurimi i Allahut dhe ndjekja e Sunetit të Profetit (a.s.). Allahu (xh.sh.), thotë: “**Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë**”¹¹ “**Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja**”¹² Enes ibn Maliku (r.a.), tregon se një njeri e ka pyetur Pejgamberin (a.s.), se kur do të ndodhë Dita e Gjykimit. Pejgamberi (a.s.), e pyeti se çfarë kishte përgatitur ai për Ditën e Gjykimit. Personi iu përgjigj: “Për Ditën e Gjykimit nuk kam përgatitur shumë gjëra me përjashtim të obligimeve, por e dua Allahun dhe Pejgamberin e Tij.” Pejgamberi (a.s.), i tha: “**Ti do të jesh në botën tjetër së bashku me atë që do.**”¹³

Një burrë prej ensarëve shkoi te Profeti (a.s.). She-njat e mërzitjes dukeshin qartë në fytyrën e tij. I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “**O filan, më dukesh mjaft i mërzitur, çfarë të shqetëson?**” Ai tha: “O i Dërguar i Allahut, u shqetësova kur mendova për diçka.” **E për çfarë mendove?** – i tha Profeti (a.s.). Ai tha: “Ne shkojmë e vijmë, dhe ti je pranë nesh. E shohim fytyrën tënde dhe bisedojmë me ty. Ndërsa nesër ti do të bashkohesh me Profetët. Ne nuk do të arrijmë dot ty dhe nuk do të të shohim më!” Profeti (a.s.), heshti, nuk tha asgjë. Pas pak zbriti Xhebraili (a.s.), me fjalën e Allahut: “**Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët. Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!**”¹⁴ Pastaj Profeti (a.s.), dërgoi një lajmëtar që ta përgëzonte ensariun me këtë ajet.

9. Buhariu dhe Muslimi.

10. Buhariu dhe Muslimi.

11. Dharijat, 56.

12. Hixhr, 99.

13. Buhariu.

14. Nisa, 69.

8 HAPAT E RËNDËSISHËM PËR TË DALLUAR MJALTIN E VËRTETË

Mjalti, ai i miri, organiku dhe natyrali është një produkt i kërkuar dhe i çmuar për të gjithë shqiptarët. Ky nektar i ëmbël shpesh është cilësuar si “ari i lëngshëm” dhe si rrjedhojë çmimet e tij mund të jenë të shtrenjta. Megjithatë, ndodh shpesh që çmimi i mjaltit në treg nuk reflekton cilësinë e mjaltit që njerëzit blejnë dhe konsumojnë. Një pjesë e mirë e mjaltit që shitet në mbarë vendin është i rremë. Nuk është as i vërtetë as organik, përkundrazi përmban gjithë lloj aditivësh, që do të thotë se njerëzit bien pre e mashtrimit dhe paguajnë një sasi të madhe lekësh duke menduar se po blejnë mjaltë cilësor. Problemi me mjaltin e falsifikuar - origjina e së cilit është e panjohur, është gjithëpërfshirës. Në formën e tij origjinale, mjalti përmban polen, dyllë bletësh dhe disa produkte të tjera. Çdo lloj poleni është i veçantë në aspektin gjeografik dhe tregon qartazi rrugëtimin e bletës dhe lulet e preferuara të saj. Kur mjalti përpunohet, prodhuesit e nënshtrojnë mjaltin në një proces filtrimi të hollë që heq të gjitha ‘papas-tërtitë’. Ky proces e bën mjaltin të pagjurmueshëm dhe jo të pastër në aspektin e cilësisë. Në shumicën e rasteve të mjaltit të importuar, prodhuesit përdorin edhe shije artificiale dhe përbërës të tjerë që largojnë të gjithë elementët unikë të mjaltit. Duke e bërë atë të “padukshëm”, prodhuesit ia heqin të gjitha vlerat shëndetësore mjaltit. Janë pikërisht ato ‘papas-tërti’ që e bëjnë mjaltin plot vlera për njeriun. Konsumatorët nuk janë plotësisht të informuar për nivelin alarmant të mjaltit jo cilësor që shitet në treg. Si mundet të dallojë konsumatorit mjaltin e vërtetë nga ai i manipuluar? Më poshtë do të gjeni këshillat që do e bëjnë më të lehtë dallimin e mjaltit cilësor nga ai falsi.

1. Mjalti i vërtetë ka grimëza të vogla brenda tij, që janë pjesë e polenit, hojeve ose bletëve dhe që janë të ngrënshme. Mjalti i rremë është tepër i kulluar për të qenë i vërtetë.

2. Mjalti i vërtetë është i dendur dhe i trashë, ndërsa ai i rremi është i hollë.

3. Mjalti i vërtetë ka një aromë të ëmbël dhe të kënaqshme, ndërsa mjalti i rremë nuk ka një aromë specifike ose ka një erë të thartë.

4. Mjalti i vërtetë nuk ngjit si zamkë kur e fërkon mes gishtave. Ai i rremi nga ana tjetër është plot me ëmbëltues të rremë që e bëjnë të ngjitshëm.

5. Shija e mjaltit të vërtetë është e lehtë dhe shuhet pas disa minutash. Shija e mjaltit të rremë është shumë e ëmbël dhe zgjat për shumë kohë.



6. Mjalti i vërtetë nuk formon bulëza kur ngrohet, por karamelizohet. Mjalti i rremë formon bulëza dhe nuk karamelizohet kurrë.

7. Mundohuni të blini mjaltë direkt nga një bletërritës i besueshëm. Tek ata keni mundësinë ta provoni mjaltin dhe të merrni përgjigje të sakta për çdo pyetje në lidhje me mjaltin në shitje.

8. Kujdes me etiketën. Mjalti i vërtetë duhet të përmbajë vetëm një përbërës - mjaltë! Disa prodhues ose kompani shtojnë përbërës të tjerë në listë, shije, ëmbëlsues, aditivë, dhe elementë artificialë. Ai nuk është mjaltë i vërtetë. Disa prej aditivëve të shtuar përfshijnë: shurup misri, niseshte, glukozë ose shurup sheqeri. Produktet që mbajnë emërtime jo fort të qarta në etiketë janë qartësisht shumë larg mjaltit. Legjislacioni në fuqi, jo domosdoshmërisht detyron shitësit e mjaltit të theksojnë nëse kanë shtuar aditivë tek mjalti, dhe fakti që në një etiketë ju nuk gjeni të shkruar informacione të mëtejshme, nuk do të thotë që po blini mjaltë të vërtetë.

Ja disa mënyra se si mund të përcaktoni vërtetësinë dhe origjinalitetin e mjaltit. Hidhni pak mjaltë në një fetë bukë. Nëse mjalti është i rremë, buka do të laget për shkak të lagështisë në lëng. Nëse mjalti është i vërtetë, buka nuk qulloset, përkundrazi bëhet e fortë për pak minuta. Hidhni mjaltë në një gotë me ujë. Mjalti i rremë shkrihet shpejt, ndërsa ai origjinali jo. Mjalti origjinal rri i mbledhur dhe zhytet në fund të gotës.



GJETHET MREKULLIBËRËSE TË ULLIRIT

Të gjithë biem dakord për vlerat mbresëlënëse të ullirit, por a dini që pema e këtij fruti është shumë bujare edhe falë gjetheve fantastike. Gjethet e ullirit janë përdorur për herë të parë në mjekësinë popullore në Egjiptin e lashtë. Që prej asaj kohe, ka marrë famë si një mjet shumë i fuqishëm kundër sëmundjeve. Një sërë studimesh shkencore kanë nxjerrë në pah që gjetnja e ullirit rrit energjinë në organizëm, mban tensionin e gjakut nën kontroll, mbron sistemin kardiovaskular dhe atë imunitar. Gjethet e ullirit nisën të përdreshin masivisht në vitet 1800, kryesisht për të ulur temperaturën. Aktualisht, Shqipëria numëron gjashtë mijë hektarë ullishte dhe dhjetë milion pemë ulliri. 1.3 milionë prej tyre janë qindra vjeçare ndërsa të tjerat kanë mbi 80 vjet mbi tokë. Këto pemë janë gjenetikiisht shumë të pasura. Shumë prej këtyre pemëve janë varietete të kultivuara, ndërsa 6 të tjera janë të një varieteti superior. Vlerat e verifikuara të përdorimit të gjetheve të ullirit janë:

1. Ul tensionin e gjakut Një studim i vitit 2011 tregoi që ekstraktet e gjetthes së ullirit kishin aftësinë të ulnin tensionin e gjakut. Pjesëmarrësit në studim konsumuan 500 miligramë ekstrakt gjethe ulliri, dy herë në ditë për tetë javë dhe ia dolën të ulnin tensionin pa pasur nevojën e medikamenteve. Për më tepër, këto suplemente ulnin nivelin e triglicerideve

2. Përmirëson shëndetin kardiovaskular Gjethet e ullirit janë përdorur prej mijëra vitesh si tonik bimor për të garantuar shëndetin kardiovaskular. Ato ulin nivelin e kolesterolit dhe mbajnë tensionin e gjakut në nivel normal. Disa substanca që gjenden tek këto gjethe kanë ndikim në uljen e rrezikut nga sëmundjet koronare dhe disa tumoreve.

3. Diabeti, Ekstraktet e gjetthes së ullirit kanë një efekt hiperglicemik, që do të thotë se ato ulin nivelin e sheqerit në gjak. Për më tepër, ky ekstrakt mban nën kontroll nivelin e glukozës në gjak dhe ngadalëson prodhimin e sheqerit që shkakton sëmundje inflamatore siç është diabeti.

4. Ul rrezikun e kancerit Gjethet e ullirit luajnë një rol të rëndësishëm në trajtimin natyral të kancerit. Ato përmbajnë antioksidantë dhe substance të tjera që kanë aftësinë të parandalojnë riprodhimin dhe migrimin e qelizave të avancuara të kancerit.

5. Përmirëson funksionet e trurit Studimet kanë

treguar që disa nga përbërësit e gjetheve të ullirit, ulin shanset e simptomave të çrregullimeve nervore që kanë lidhje me moshën si dementia dhe Alzheimer. Studimet sugjerojnë që radikalet e lira luajnë një rol në zhvillimin e këtyre sëmundjeve. Gjethja e ullirit është e pasur me antioksidantë që luftojnë këto radikale, dhe si rrjedhojë mbrojnë trurin nga humbja e kujtesës.

6. Artriti është një sëmundje inflamatore. Gjethet e ullirit luftojnë inflamacionin dhe si rrjedhojë shërbejnë si një kurë natyrale kundër artritit. Për më tepër, këto gjethe ndihmojnë në uljen e dhimbjeve që shkakton kjo sëmundje.

7. Shkatërron bakteret dhe mykun. Gjethet e ullirit kanë aftësinë të luftojnë infeksionet, si candida, meningjitin, pneunominë, lodhjen kronike, hepatitin B, malarien, gonorenë dhe tuberkulozin. Për më tepër, këto gjethe përbëjnë një kurë natyrale kundër infeksioneve të veshit, dhëmbëve dhe traktit urinar.

8. Përmirëson sistemin imunitar. Gjethet e ullirit parandalojnë të ftohtin, disa viruse të rrezikshme, sëmundje të shkaktuara nga mikrobet, virozat dhe infeksionet respiratore. Përbërësit e fuqishëm të këtyre gjetheve shkatërrojnë organizmat pushtues në trup dhe nuk lejojnë viruset të riprodhohen dhe të shkaktojnë infeksione të mëtejshme.

9. Mbron lëkurën. Gjethet e ullirit kanë aftësinë të kurojnë dëmet e shkaktuara në lëkurë dhe shenjat e plakjes. Parandalojnë disa dëme të ndryshme të qelizave sidomos ato të shkaktuara nga oksidimi. Ushqimet dhe barishtet e pasura me antioksidantë janë fantastikë për shëndetin e qelizave dhe lëkurës. Si të përdorni gjethet e ullirit Mënyra më e mirë për të përfituar këto vlera është të përdorni ekstrakte të gjetheve të ullirit. Blini produkte organike pa pesticide. Ekstraktet përdoren në kremërat e lëkurës dhe produkte të tjera kozmetike. Ndaj përdorni 5 deri në 10 pika të ekstraktit në larësin ose kremin tuaj të preferuar. Nëse keni mundësi të përdorni gjethe direkt nga pema mund të përgatishni çaj. Lajini mirë, piqini në furrë në një temperaturë prej 150 gradësh deri sa të jenë plotësisht të thata. Pastaj shtypini. Merrni një lugë çaji me gjethe të thata dhe zijini në ujë për 10 minuta. Pini një filxhan ose më shumë në ditë për të përfituar prej tyre. Nëse nuk ju pëlqen shija, shtoni pak limon ose mjaltë.

TOKA PO RROTULLOHET MË NGADALË. JA NJË NGA PASOJAT QË PO NDIHET

Ditët po bëhen më të gjata, teksa rrotullimi i Tokës po pëson ndryshime të vogla me kalimin e kohës. Por ka të ngjarë që ju të mos vëreni asgjë edhe për shumë kohë – një ditë merr një minutë shtesë në çdo 6.7 milionë vjet vlerëson një studim i ri. Çdo “ditë”, është sasia e kohës që i duhet planetit tonë për të kryer një rrotullim të plotë rreth boshtit të vet.

Kështu që çdo ndryshim në shpejtësinë e rrotullimit të Tokës, do të ketë një efekt të kundërt proporcional tek gjatësia e një dite – shpejtësia më e madhe e shkurton ditën, ndërsa rrotullimi më i ngadaltë do të thotë ditë më të gjata. Dhe rasti i fundit duket të jetë i vërtetë. Një ekip britanik vlerëson se dita mesatare ka fituar 1.8 milisekonda çdo shekull, gjatë 2700 viteve të fundit.

Shpejtësia që ata llogaritën, është “dukshëm më e vogël” se sa vlerësimet e mëparshme, të cilat vendosën një normë prej 2.3 milisekondash për një shekull – çka do të përkthehej në një minutë çdo 5.2 milionë vjet. Megjithatë, astronomi në pension i Observatorit Mbretëror Grinuiç dhe bashkautor i studimit Lezli Morrison, pranojnë se rrotullimi mbetet “një proces shumë i ngadaltë”.

“Këto vlerësime janë të përafërta, pasi forcat gjeofizike që veprojnë mbi rrotullimin e Tokës, nuk do të jenë domosdoshmërisht konstante për një periudhë kaq të gjatë kohore”- thekson ai. “Ndërhyrja e Epokës së Akullnajave, do të ndërpriste këto përlllogaritje të thjeshta. Shifra e mëparshme e 2.3 milisekondave u vlerësua nga llogaritjet e efektit të Hënës mbi ‘frenimin e Tokës’ – forca e saj tërheqëse gravitacionale mbi ujin dhe tokën, që efektivisht shkon në drejtimin e kundërt me forcën e rrotullimit.

Por Morrison dhe ekipi i tij, përdorën teorinë gravitacionale mbi lëvizjet e Tokës rreth Diellit, si dhe

ndërveprimet Hënë-Tokë, për të llogaritur kohën e eklipseve diellore me kalimin e kohës, siç shihen nga planeti ynë. Ata pastaj llogaritën se në çfarë vendi në tokë do të jenë më të dukshme, dhe i krahasuan me rezultatet e të dhënave të lashta mbi eklipset nga babilonasit, kinezët, grekët, arabët dhe evropianët mesjetarë.

“Ne kemi marrë të dhënat historike të rëndësishme nga historianët dhe përkthyesit e teksteve të lashta”- shpjegon Morrison. “Për shembull, pllakat babilonase në shkrimin kuneiform, ruhen në Muzeun Britanik, dhe janë deshifruar nga ekspertët”. Ata gjetën një mospërputhje ndërmjet mes pikave ku eklipseve duhet të ishin të dukshme, në raport me atje ku faktikisht u panë.

Kjo mospërputhje mund të shkaktohet vetëm nga shpejtësia e ndryshme rrotulluese e Tokës, nga ajo që përdori ekipi i studiuesve në modelin e tij (atë aktualin). “Kjo mospërputhje është një masë se si rrotullimi i Tokës ka qenë i ndryshëm që në vitin 720 P.E.S, kur qytetërimet e lashta filluan mbajtjen e shënimeve mbi eklipset.

Shpejtësia e rrotullimit të Tokës, mund të ndikohet nga efekti frenues i Hënës, ndërveprimi elektromagnetik brenda planetit (ndërmjet pjesëve të ngurta dhe mantelit që gjendet nën të), si dhe ndryshimeve masive në planet – në nivelin e detit, pakësimin e mantelit të akullit polar që nga Epoka e fundit Akulljanore, rezervuaret e mëdha dhe kështu me radhë.

Dhe ndërsa shumica prej nesh ndoshta nuk do ta vënë re kurrë këtë rritje, është e domosdoshme që shkencëtarët të jenë në dijeni të saj. Për shembull, ky informacion mund të përdoret në rregullimin e orëve më saktësi të lartë, të cilat përforcojnë sistemin tonë të lundrimit.



ÇFARË PO NDODH ME OKSIGJENIN NË TOKË?

Ky vit ka qenë shumë i rëndësishëm, ndërsa disa të tjerë do të thoshin se ka qenë i tmerrshëm në lidhje me ndryshimet e fundit klimaterike. Korrikushti i 2016-s ka rezultuar si më i nxehti në 136 vitet e fundit.

Ne po jetojmë në një realitet klimaterik që është në ndryshim të vazhdueshëm, ku niveli i dioksidit të karbonit në atmosferë është rritur në nivele alarmante. Më poshtë do të shikoni ndryshimin e nivelit të CO₂ nga vitit 2011 deri në 2016.

Edhe për Arktikun ky vit ka shënuar të dhëna ku temperatura ka shënuar rritje, dhe shtresat e akullit po shkrihen më shpejt seç ishte parashikuar të ndodhte dhe kjo është një gjë tejet alarmante, sepse ne jetojmë në një botë ku çdo gjë ka lidhje me një tjetër dhe ajo çka ndodh në Arktik nuk mbetet në Arktik. Shoqëria dhe ekonomia janë gjithashtu në rrezik. Edhe për oqeanet situata nuk është aspak e mirë. Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga raporti i WWF, parashikohet se në 2050 në oqeanet tona do të ketë më shumë mbetje plastike sesa peshq dhe niveli i specieve të botës nënujore do të zvogëlohet me 50 për qind.

Ndërkohë ndotja e ajrit po vret 18,000 njerëz çdo

ditë. Sipas të dhënave të publikuara nga WHO, 6.5 milionë njerëz vdesin në vit nga ajri i ndotur më shumë se numri i njerëzve që vdesin nga HIV/AIDS, tuberkulozi, etj, duke u shndërruar në njërin prej 4 kërcënimeve më të mëdha të njerëzimit.

Kudo ku hedhim vështrimin, mesazhi është më se i qartë duhet të veprojmë menjëherë që të shmangim këtë katastrofë mjedisore. Marrëveshja historike e vitit të kaluar në Paris dhe miratimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm tregoi se vullneti politik është i gatshëm për të trajtuar një nga sfidat globale më alarmante të kohës sonë.

Por duhet shumë më shumë sesa thjesht mbështetja e qeverisë për të kapërcyer këtë situatë. Ide të reja radikale dhe modele të reja të biznesit të gjelbër janë shumë të nevojshme, nëse duam që ajri të pastrohet, oqeanet të shpëtojnë nga tmerrri i materialeve plastike dhe të ndalohet ngrohja globale.

Seria e zgjidhjeve për t'i bërë ballë të luftës kundër ndryshimeve klimatike është e shumë e gjatë por më poshtë do të lexoni disa prej tyre, që nga ulja e nivelit të emetimit të CO₂, në riciklimin e çdo mbetjeje, zëvendësimi i konsumit të mishit të kuq, etj.



O besimtarë!
Pranojeni
të gjithë Islamin
dhe mos ndiqni
gjurmët e djallit,
se ai është armiku
juaj i përbetuar.

(Bekare, 208)